

Parlament
VMRO kthehet
me votëbesim
ndaj Zaevit

Fq.3




**KATIMERINI
PËR EMRIN**
Dy skenarët
për anëtarësimin
në NATO

Fq.3



Dikur ishin
e ardhmja,
ja ku janë
sot disa nga
talentët
kuqezi

Fq.19



Koha

www.koha.mk

Ishim dhe
mbetëm
të uritur

Fq.12-13



E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3334 · e mërkurë 4 prill, 2018

8°C | 21°C

15 DEN

FORUM

**Asocialiteti
i rrjeteve
sociale**



Historia e komunikimit, mund të ndahet në kohën: para dhe pas Bill Cejtsit. Deri vonë, mendnim se ndarja ishte: para dhe pas Guttenbergut.

Por, mbi gjashtë shekuj nga shtypshkronja e ideatorit të "Printing Revolution", bota po sfidohet, sot, nga "Virtual Revolution". Krijuesi i botës virtuale, revolucionarizoi jetën, mundësoi tregtinë elektronike (e-shopping), votimin elektronik (e-voting), qeverisjen elektronike (e-governance), por edhe de-monopolizoi diskursin tradicional mediatiak.

Fq.10

RAJON

**Politika
nën hijen
e biznesit**

Fq.14

FORUM

**TATIMI
PROGRESIV:
A është ajo që
na duhet tani?**

Fq.11



EDHE SHKOLLIM I DETYRUESHËM, EDHE PROVIM PËR REGJISTRIM

MUNGON ORIENTIMI I HERSHËM I NXËNËSVE



Tani që arsimiti i mesëm është i obligueshëm, ata që kryejnë arsimin nëntëvjeçar duhet të ndjekin të njëjtat rregullat që vlenin para 2007-ës. Pra, duhet të parashtrajnë lutje për regjistrim në shkollë, të shpejtojnë të zënë vendet që në aftin e parë dhe t'u nënshtrohen testeve apo provimeve pranuese në shkollat ku janë paraqitur më tepër kandidatë

Fq.6

Nafta, shteti subvencionon me 50 për qind

Shkup, 3 prill - Bujqit në Maqedoni në muajin qershor do të fitojnë naftë për 50 për qind më të lirë seç e paguajnë tani. Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim rural që pritet të votohen në Kuvend këtë muaj, shteti do të mbulojë 50 për qind të harxhimeve të naftës në bujqësi. Me ndryshimet ligjore, "naftë të gjelbër", apo naftë për mekanizimin bujqësor do të fitoj çdo bujk apo ekonomi buj-

qësore e regjistruar, ndërsa nga arka shtetërore për këtë dedikim për sivjet janë ndarë afër pesë milion euro. Njëherësh, nafta më e lirë për bujqit do të zbusë edhe shtrenjtimit prej 3 denarë të naftës me vendosjen e akcizës shtesë në nëntor të vitit 2017. Vlerësohet se kostoja e naftës ndikon mjaft në prodhimtarinë bujqësore, si për shkak të rritjes së madhe të çmimeve të derivateve të naftës në...

Fq.7



EDITORIAL

KOSTOT E TAKSAVE
GJITHËKOMBËTARE

Emin AZEMI

Këto ditë u bë problem taksa rrugore në Shqipëri, shoqëruar me akte të dhunshme që tejkalonin kornizat e protestës normale, ndërkohë që jo pak ngjarje po kanë koston e vet në nivel kombëtar për gjithë shqiptarët. Në Kosovë vazhdon të jetë aktuale çështja e dëbimit të 6 "gylenistëve", kurse në Maqedoni, këto ditë po bisedohet (hapur e tinëz) se kush nga partitë shqiptare do të ndajë kulaçin qeveritar, për t'u bërë bashkë me ata që deri dje ishin "bukëshkalë".

Gjeografia shqiptare, e penalizuar nga historia të jetë e ndarë me mure administrative, sikur ka diçka të përbashkët, brenda hartës së saj të mendësisë dhe kapriçiozitetëve. Përderisa në Kalimash kuksianët refuzojnë të paguajnë taksën rrugore të Edi Ramës, në Kosovë ende po i numërojnë politikanët dhe zyrat të cilët ditëve të fundit kanë qenë "jashtë orarit të punës" në kohën kur gjashtë shtetas turq u morën nga "ufot" dhe u dërguan me një avion misterioz në Turqi.

Taksa rrugore e Ramës dhe dëbimi "gylenistëve" e gjeti shqiptarinë të kacafytur me kurthet që vetë ajo ia ngre vetvetes, sa herë që nuk është e gatshme të gjejë një përgjigje të saktë për naivitete dhe budallallëqet që asaj i ndodhin herë pas here.

Çka i ka kushtuar Edi Ramës të mbledhë autoritet lokale të Kukësit dhe komunave tjera përreth, bashkë me komunitetin e zonës, në një takim sqarues e informues për të gjitha masat dhe tarifatat që do të ndërmerren, duke shmangur çfarëdo lloj mundësie për keqinterpretim të nevojës së vendosjes së taksës rrugore.

Në Kosovë, gjithashtu ka mundur të zhvillohet një komunikim më institucional sa i përket çështjes së gjashtë shtetasve turq, duke i koordinuar masat dhe veprimet, në harmoni me interesat shtetërore dhe politikat e jashtme. Zhurma që është bërë nëpër media, më mirë ka qenë dashur të "prapakthehet" në përplasje brendainstitucionale, se sa që kjo kacafytje të bëhet tani publike, duke shkaktuar jo pak huti e lajthitje. Si duket kanë filluar të habiten edhe vetë ata që kanë dhënë urdhra, se në çfarë aventure ishin nisur kur kishin vendosur të bëhen "pionierë" të parë të ekstradimeve në Europën moderne. Sikur vendimi të ishte "hekurosor" paraprakisht, pa patur nevojë madje të acarohen marrëdhëniet me Ankarën dhe sikur publiku të ishte kursyer nga kjo furtunë mediatike që u prodhuan pasi dolën pamjet e avionit që po priste në aeroportin e Prishtinës gjashtë mysafirët e "skaduar" duarlidhur, efektet e kësaj ngjarjeje sigurisht do të kishin dinamike dhe artikulum tjetër.

Kur jemi te mediat nuk mund të mos përmendet edhe (pa)mundësia, në ndonjë rrethanë në të kaluar, për të patur nervin e duhur të reagimit, siç po vepohet aktualisht. Sikundër dihet autoritetet e Prishtinës herë pas herë kishin zbatuar në të kaluarën kërkesat e homologëve të tyre në Shkup për të ekstraduar ndonjë shqiptar që supozohet se kishte bërë sherre në Maqedoni. Ndonëse teknikisht dhe përmbajtësisht mund të ketë shumë përrjashtime, por megjithatë, reagimi publik në Kosovë ka qenë i pavërejtshëm dhe tepër i "qullur" atëherë kur në Bllacë policia kosovare i dorëzonte duarlidhur disa persona shqiptarë, të cilët gjykatat maqedonase i kërkonin për vepra të diskutueshme, shumica prej të cilave rezultonin të montuara.

Shqiptarët nuk do të ishin këta që aktualisht prezantohen para botës me punët e tyre, sikur të mos kishin një licencë të përbashkët që i bën krejt të dallueshëm, me të cilën janë në gjendje madje të prodhojnë edhe kosto gjithëkombëtare.

KU ISHIT JU VAJTOCA
ATËHERË...

"Me gjithë forcën e dënove deportimin e 6 shtetasve turq nga Kosova, por kam edhe një të vetme vërejtje për vajtocat e fejsbukit dhe tjeret se kreret institucional deputetë e deputete nuk lexojnë prandaj atyne as që i dedikohet.

Ku ishit ju atëherë kur "Kosova" gjithashtu i KIDNAPOJ dhe ua dorëzoi Maqedonisë luftetarët e UÇK-së që atje akuzoheshin për krime lufte dhe që dihej se do të denoheshin ose vriteshin pa gjyq, a menduat për ata dhe familjet e tyre, kurrë asnjë shkrim e as ma i vogli reagim. Asnjë reagim kur Zvicra dhe shtete tjera deportonin pjestaret e UÇK-së drejt Serbise.

Ku ishit e ku jeni ju vajtocat e Kosoves, diasporës, OJQ e deputetë e deputete kur lexojshi se me shume se 50 luftëtarë të UÇK-së bënë vetvrasje, se fundi ku ishit ju gjithë kur morët vesh lajmin se Ish-luftëtari Nijazi Bytyçi nga Marashi i Ferizajit, vrau veten i lodhur nga shëndeti dhe pamundësia për ta ndihmu familjen. Ai la Gjermaninë dhe erdhi e luftoi si burrat.

Marrja e turpi raftë mbi të gjithë ju dhe ju që tash vajtoni dhe krekoseni gjithë ditën. Ja disa nga luftëtarët e UÇK-së që shteti i Kosovës i kishte dorëzuar organeve të shtetit të Maqedonisë.

Askush nuk protestoi e as reagoi në Kosovë.

1. Kom. Çakalla, 17 vjet burg
2. Metin Ismaili, burg të përjetshëm
3. Almir Drpljani, burg të përjetshëm
4. Shukri Aliu, 7 vjet burg
5. Fata i Hanit Elezit, 19 vjet burg
6. Xhemaj Hyseni, me 15 vjet burg
7. Kom. Harun Aliu, U VRA
8. Ridvan Rida Rashiti - 6 vjet", ka komentuar përmes një statusi në Facebook, zhvillimet e fundit gazetari Llukman Halili.

KUR PLAGJIATORI TË SHET
PATRIOTIZËM

"Ka ndodhë ka '96 në Tiranë. Banoja me nja dy shokë në një banesë në Ali Demi kur do na vij një mysafir nga Tetova, edhe ai student në Tiranë por edhe punonte në një ëmbëltore- biçim tatlixhie... Kish sjell një libër me poezi që sapo e kish botuar. Ma dhuroi një ekzemplar me kushtim dhe më kerkoi ta lexoja dhe të jepja një mendim, si student i letërsisë që isha. Fillova ta lexoj menjëherë kur pa kaluar 10 faqe has një poezi të lexuar tjetërkund.

Librin me poezinë e njëjtë e kisha aty dhe ia tregojë poetit. Ai u vu në siklet të madh...u krijua një gjendje e nderë.. Të nesërmen Poeti tatlixhi iku bashkë me librin që ma kish dhuruar... Dy-tre vjet më vonë kur po hulumtoja për Antologjinë e lirikës shqipe- Poetët shqiptarë, do të zbërthej enigmën: As ai e kish kopjuar poeten as Poetja atë por të dy një të tretë: poetin Faruk Myrtaj. Madje, poetja me poezitë e Faruk Myrtaj bën dy libra: njërin nga to ia financon Sorosi në Shkup.

PS. S'munda të rri pa e tregu kë të vaki se "poeti - tatlixhi" aq shumë pambrëmë shiti patriotizëm shqiptaromadha sa mu duk vetja shka...", ka shkruar në profilin e tij në Facebook profesori dhe botuesi Hashim Baftiari.

ÇFARË ËSHTË MOZAIKU I TIRANËS?

Mozaiku i Tiranës është i vetmi monument arkeologjik brenda territorit të qytetit të Tiranës. Në vitin 1972, gjatë punës për ndërtimin e pallateve të bllokut "Partizani" në lagjen nr. 9 të qytetit të Tiranës, u zbuluan rrënojat e një ndërtese antike, njëri nga ambientet e të cilit ishte i shtruar me mozaik. Sipas autorëve, kemi të bëjmë me një qendër fshatare të shekujve të parë pas Krishtit që në

fillim të shek. III u zëvendësua me një vilë fshatare (rustica).

Salla me mozaik e pajisur dhe me një absidë ishte ambjenti kryesor i saj.

Autorët mendojnë edhe që në shek. V-VI vendin e vilës e zuri një bazilikë paleokristiane. Pjesa e gërmuar e monumentit u rrethua dhe u vu në mbrojtje nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK).

MEDIACitate

Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës Kosova e Re, Vesel Makolli ka bërë të ditur se gjatë ditës së sotme nuk do të ketë takim kryesia e kësaj partie, pasi që mbledhje kanë mbajtur gjatë ditës së djeshme. Makolli, në një bisedë për Kosovapress, ka thënë se vendimin për largimin ose jo të ministrit të Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, do ta marrë kryetari i AKR-së, Behgjet Pacolli. Ndërsa, nuk ka bërë të ditur se kur pritet të bëhet publik vendimin rreth ministrit Sefaj. "Vendimin rreth çështjes së ministrit Sefaj do ta marrë presidenti, i cili njëherësh është edhe zëvendëskryeministër. Sa i përket asaj se kur bëhet publik vendimi unë nuk kam informata zyrtare as prej presidentit. Por, normalisht që kjo çështje duhet zgjidhur në të mirën e të gjithëve, duhet me gjet një solucion një zgjidhje, e cila kishte me i kënaq të gjithë. Pasi kemi ardhur në një situatë që nuk kish dashur me ardhur, se ministri Sefaj ka qenë ndër ministrat më të mirë, por është krijuar situata që është krijuar dhe tash duhet të kemi parasysh të gjitha edhe interesin e Qeverisë, interesin e shtetit. Para së gjithash edhe interesin e Flamurit", tha ai. Makolli ka thënë se mbledhjen e djeshme nuk kanë diskutuar lidhur me ministrin Sefaj, por që tha se kanë mbajtur një takim me anëtarët, të cilët janë pjesë e Qeverisë dhe që kanë vendosur që vendimin ta marrë kryetari i AKR-së, Behgjet Pacolli. Ndërsa, sa i përket asaj se nëse shkarkohet ministri i Punëve të Brendshme, AKR do të dalë nga koalicioni qeverisës, Makolli thotë se nuk është shumë e lehtë dalja nga qeveria. Për më tepër ai thotë se nuk janë parti që do ta sjellin shtetin në krizë. "Ne kemi biseduar dje rreth kësaj teme, nuk ka pasur deklarata ekstreme, qëndrime ekstreme që të dalim nga Qeveria. Këtu po merret shumë lehtë dalja nga qeveria. Ne tre muaj ditë kemi pasur një vakum institucional dhe ne jemi ajo partia e cila e kemi nxjerrë shtetin prej krizës një farë forme. Jemi ajo partia që nuk do ta biem shtetin në krizë për ma të madhin zor si të them, mirëpo duhet me tolerancë, me biseda do të zgjidhet situata", tha ai.

(KosovaPress, 3 prill)

NËSE NUK
E KENI DITUR...



OPOZITA MAQEDONASE SHPËRFILL LIGJET REFORMUESE

VMRO KTHEHET ME VOTËBESIM NDAJ ZAEVIT

VMRO me të gjitha pritjet e partive në pushtet se do të kthehet në Parlament kur dhe duhet të votohet për ligjet reformuese për të cilat kërkohet 2/3 e votave, ajo kthehet në Parlament më iniciativën për votëbesim të Qeverisë

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 3 prill - Në kohën kur me të madhe po flitet për rikonstruim të Qeverisë, partia më e madhe opozitare VMRO-DPMNE e Hristijan Mickovskit ka vendosur në kthehet në Parlament edhe atë përmes iniciativës për votëbesim të Qeverisë të kryeministrit Zoran Zaev. VMRO ka vendosur kështu në dy organet më të larta - Komiteti qendror dhe Komiteti Ekzekutiv në fillim të kësaj jave. Shefi i grupit parlamentar të VMRO-së, Dragan Danev, tha se votëbesimi lidhet me atë se Qeveria e Zaevit ka shumë ngecje në ekonomi dhe ka rritur në masë korrupsionin dhe kriminalitetin.

Ndërkaq, iniciativa për votëbesimin e Qeverisë do të jetë prova e parë e kësaj partie për ta verifikuar fuqinë reale në Parlament. Kjo, megjë kohëve të fundit, kryeministri Zaev flet me vetëbesim se përveç partive shqiptare, ka përkrahjen e më së paku 6 deputetëve të VMRO-së në Parlament, duke aluduar kështu në deputetë turq dhe serb nga radhët e saj. Sipas asaj që tha shefi i grupit parlamentar të VMRO-së, Dragan Danev, pritjet e partisë së tij janë se iniciativa për votëbesim do të merr përkrahje të gjerë në Parlament. "VMRO ka sjellë vendim në Komitetin Qendror dhe në atë ekzekutiv që deputetët të kthehen në Parlamentin e Maqedonisë dhe koha kur do të kthehemi vërtetë do të jetë pika për votëbesimin e Qeverisë. Në bazë të dokumentacionit që do të dorëzohet dhe do të vepohet, pra mendojmë se dokumenti në kohë sa më të shpejtë të përcillet tek shërbimet parlamentare. Presim që sipas Rregullores, Talat Xhaferi të procedojë votëbesimin", tha Danev, pamos e precizuar ditën se kur do të dorëzohemi iniciativa për votëbesimin e Qeverisë. "Absolutisht ende nuk kemi ndonjë marrëveshje për ato ligje reformuese. Unë nuk jam pjesë e grupeve punuese, por sipas njohurive që kam, për shumicën e atyre ligjeve ka dakordim. Se kur do të ketë marrëveshje - do të tre-

gojmë të vijë koha", tha Danev. Në pyetjen e gazetarëve se pse kur ka dakordim për ligjet reformuese kur edhe duhet vota e saj, VMRO nuk kthehet në Parlament, Danev tha prerë se "qëndrimi është i qartë, vendimi i VMRO-së është pika e rendit të ditës kur ne do të kthehemi në Parlament është vetëm votëbesimi për Qeverinë".

Në pyetjen tjetër nëse iniciativa do të merret parasysh nga kryetari Talat Xhaferi, Danev tha se në këtë pyetje aludohet "në shkelje të vazhdueshme të Rregullores së punës nga Xhaferi". Sipas afatit kur do të shtrohet votëbesimi, tha Danev, ne dhe do të marrim pjesë. Në pyetjen e gazetarëve nëse kjo do të thotë se

VMRO e pranon Xhaferin për kryetar të Parlamentit, megjë iniciativa për votëbesim do të dorëzohet tek ai, Danev tha se pyetjet mund të kalkulohe në shumë mënyra, por siç shtoi ai, VMRO me këtë rast nuk e pranon Xhaferin për kryetar të Parlamentit. Në pyetjen e gazetës KOHA nëse iniciativa për votëbesimin e Qeverisë ka ndonjë lidhje me rikonstruimin e qeverisë që pritet të ndodhë shumë shpejtë, kur Zaevi tashmë ka paralajmëruar se do të rrit shumicën parlamentare, Danev mohoi një gjë të tillë. "Absolutisht jo. Në Parlament ende nuk ka ndonjë kërkesë për rikonstruim të Qeverisë", tha shkurt deputeti i VMRO-së.

Në tekstin e fundit me titull "Plan B që të zhblllokohet çështja e Shkupit", gazeta greke shkruan se pala greke shqyrton dy opsione, njëra të ketë ndryshim kushtetues para Samitit të NATO-s në korrik, ndërsa sipas tjetrit, bëhet fjalë për plan alternativ në qoftë se nuk është tërheqëse menjëherë të bëhen ndryshime kushtetuese

Athinë, 3 prill - Marrëveshje ndërkombëtare që do ta firmosë IRJM dhe do të dorëzohet deri të të gjithë organizatat ndërkombëtare (NATO, BE dhe KB) është plani alternativ që ndodhet në tryezën e negociatave, në qoftë se nuk është e mundur menjëherë të bëhen ndryshime kushtetuese, gjegjësisht para Samitit të NATO-s në korrik, shkruan gazeta greke "Katimerini". Siç njoftoi korrespondentja e MIA-s nga Athina, gjatë 24 orëve të kaluara - gazeta greke në dy tekste të ndryshme, të nënshkruara nga

"KATIMERINI" PËR INTEGRIMIN EUROATLANTIK TË MAQEDONISË

DY SKENARËT PËR ANËTARËSIMIN NË NATO



MË 12 PRILL TAKIM KOXIAS-DIMITROV

Informatat në mediat greke për takim të ri të shefave të diplomacive të Maqedonisë dhe Greqisë, Nikolla Dimitrov dhe Nikos Koxias më 12 prill, i konfirmon lideri i partisë Potami, i cili mbajti takim me shefin e diplomacisë greke. Stavros Teodorakis në intervistë për televizionin shtetëror TV ERT, duke iu referuar asaj që e ka dëgjuar nga Nikos Koxias, tha se të enjten e ardhshme do të ketë takim të ri, ndërsa në qoftë është gjithçka në rregull, atëherë rasti do të kalojë në duart e dy kryeministrave. "Kam thënë se, që prilli është shumë e sigurt që ta japë zgjidhjen. Në datën 12 të këtij muaji, siç më njoftoi zotëri Koxias do ta ketë takimin e rëndësishëm të radhës me ministrin e Punëve të Jashtme të IRJM-së dhe nëse kalon mirë ky takim, kuptoj se rasti do të kalojë në duart e dy kryeministrave", thotë lideri i partisë Potami, në intervistë për televizionin shtetëror TV ERT. Lidhur me pozicionet e partisë në bisedimet për emrin, Teodorakis edhe një herë përsëriti se Potami angazhohet për zgjidhje e cila paralelisht do të sjellë edhe obligime juridike për largim të irredentizmit.

dy gazetarë të ndryshëm, publikoi dy skenarë të ndryshëm në qoftë se deri te Samiti i NATO-s, Maqedonia nuk arrin të përfundojë me ndryshimet kushtetuese që i kërkon Athina.

Në tekstin e fundit me titull "Plan B që të zhblllokohet çështja e Shkupit", gazeta greke shkruan se pala greke shqyrton dy opsione, njëra të ketë ndryshim kushtetues para Samitit të NATO-s në korrik, ndërsa sipas tjetrit, bëhet fjalë për plan alternativ në qoftë se nuk është tërheqëse menjëherë të bëhen ndryshime kushtetuese.

"Skenari i dytë është ai me Marrëveshjen ndërkombëtare që do ta firmosë IRJM dhe do të dorëzohet deri të të gjithë organizatat ndërkombëtare (NATO, BE dhe gjithsesi KB). Përmes këtij teksti juridik, vendi fqinj, në esencë obligohet t'i bëjë këto ndryshime që janë të domosdoshme që të plotësohen kushtet e marrëveshjes përfundimtare midis Greqisë dhe IRJM-së midis të cilëve gjithsesi se është inkuadruar edhe kushti erga omnes, përdorim gjithëpërfshirës edhe brenda edhe jashtë", shkruan gazeta greke. Madje, "Katimerini"

doli me tjetër skenar - Maqedonia të marrë raport "të sendërtuar" me Aleancën dhe integrim të kompletuar pas përfundimit të ndryshimeve kushtetuese.

"Në thelbin e negociatave ndodhet propozimi sipas të cilit në marrëveshjen ndërkombëtare të së dy vendeve do të ndërmerret obligimi për ndryshim të Kushte-

tutës së IRJM-së, si dhe për rregullim të procedurave adekuate.

Në bazë të marrëveshjes, në Samitin e NATO-s në korrik, IRJM-së do t'i jepet raport 'i sendërtuar' me Aleancën Veri-atlantike, por edhe obligim i qartë për integrim të plotë sapo të përfundohet me revizionin kushtetues", shkroi "Katimerini".

Ligji i ri për energjetikë që pritet të miratohet nga Parlamenti i Maqedonisë, ka ndikim pozitiv ekonomik, sepse shënon fundin e monopolit dhe dhënien e të drejtës së zgjedhjes konsumatorëve

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 3 mars - Nga 1 janari i vitit 2019 ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si dhe amvisëritë do të mund të bëjnë përzgjedhjen e operatorit energjetik. Kështu deklaroi Ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, pasi Qeveria e Maqedonisë miratoi projekt-ligjin për energjetikë. "Me draft-ligjin e ri për energjetikë më në fund në interes të qytetarëve, ju ofrojmë zgjedhje evropiane, me qëllim që të kemi furnizim cilësor, të besueshëm dhe të sigurt energjetik", tha Bekteshi. Edhe pse se Ligji i ri për energjetikë, sipas Bekteshit, duhet të miratohet që në vitin 2014, por për shkak të anulimeve më në fund ky ligj u miratua dhe do të hyn në fuqi pasi ta miraton Parlamenti i Maqedonisë. "Vlerësimet e Komisionit Evropian pas miratimit të projekt-ligjit nga qeveria brenda afatit të caktuar, janë pozitive, duke pasur parasysh faktin se ky ligj është harmonizuar plotësisht me atë të legjislacionit të BE-së në sektorin energjetik", thotë ministri Bekteshi.

Duke folur për përparësitë e këtij ligji ministri u shpreh se miratimi i këtij ligji kryesisht ka ndikim ekonomik, sepse shënon fundin e monopolit dhe dhënien e të drejtës së zgjedhjes konsumatorëve,

LIGJI I RI PËR ENERGJETIKË

FUNDI I MONOPOLIT



torëve, që do të thotë se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe familjet mund të zgjedhin furnizuesin e tyre me energji dhe gaz natyror sipas dëshirës së tyre. "Për të mbrojtur në vazhdimësi qytetarët me projektligjin e ri për Energjetikë do të kemi të ashtuquajturin furnizues universal, i cili do të duhet për çmime të ulëta të ofrojë shërbim cilësor për konsumatorët. Ky Projektligj do të ofrojë rritje të konkurrencës gjatë ndarjes së premive feed në procedurë transparente që përfshin ankand", tha ministri Bekteshi. Përveç që ligji i ri për energjetikë do të ketë ndikim pozitiv në ekonominë në mënyrë të ngjashme do të ketë edhe ndikime sociale. "Është propozuar të miratohet Plan Vjetor për zvogëlimin e varfërisë energjetike, sepse zgjidhjet ekzi-

stuese që ofrojnë mbrojtje për familjet ekonomikisht të dobëta nuk përfshijnë kategori të caktuara të konsumatorëve të cilët kanë nevojë tu jepet ndihmë për të plotësuar nevojat për energji si punëtorëve të falimentuar, pensionistët me paga të ulëta dhe kategoritë e tjera. Ky plan do të përfshijë masat që duhen ndërmerren për të reduktuar varfërinë energjetike, duke përfshirë subvencionet për energjinë e shpenzuar dedikuar familjeve ekonomikisht të rënduara", tha ministri Bekteshi. Në të njëjtën kohë thotë ministri Bekteshi me qëllim të përdorimit sa më masiv të burimeve të ripërtirshme të energjisë dhe nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit, parashikohet që prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtirshme të energjisë de-

dikuar për konsumim individual, energjia e tepert e prodhuar të transferohet në rrjetin shpërndarës elektrik nën kushte dhe në përputhje me këtë ligj. "Do të aplikohet procedurë e certifikimit, e cila do të dëshmojë se ndarja e operatorëve të sistemit transmetues të energjisë elektrike dhe gazit natyror janë të ndara ligjërisht, në mënyrë funksionale dhe llogaridhënëse nga ndërmarrjet që kryejnë aktivitete për prodhimin e energjisë elektrike, përkatë-

sisht furnizimin me gaz natyror, me çka garantohet qasje në rrjete sipas rregullave evropiane", tha Bekteshi. Pas miratimit të ligjit të ri për energjetikë në afat prej 90 ditësh është parashikuar të bëhet rotacion i komisarëve në Komisionet Rregullatore për Energjetikë, përkatësisht të zgjidhet kryetar i ri dhe dy anëtarë të rinj që të sigurohet pavarësi e trupave rregullator. "Përveç kësaj, duhet të zgjidhet edhe furnizues universal i tregut të energjisë elektrike, i cili do ta garantojë çmimin e energjisë elektrike për amvisëritë dhe të cilin ELEM do t'i detyrohet që në vitin 2019 t'i dorëzojë 80 për qind të prodhimtarisë, ndërsa në vitet e ardhshme përqindja të zvogëlohet dhe në vitin 2025 të arrijë 30 për qind të prodhimtarisë", tha ministri Bekteshi. Ndërkohë zëvendëskryeministri për Çështje ekonomike, Koço Angjushev, thotë se pas liberalizimit të tërësishtëm nuk do të rritet çmimi i energjisë elektrike për qytetarët, ndërsa garanci për këtë, është furnizuesi universal, si dhe dispozita në Ligjin të subvencionohet varfëria energjetike.

"Ligji për energjetikë, është harmonizuar me pesë direktiva evropiane dhe tri rregullatore dhe mundëson liberalizim të tërësishtëm të sektorit energjetik, përkatësisht çdo konsumator sipas zgjedhjes personale dhe me dakordim personal të mund të zgjedh furnizues me energji elektrike dhe gaz", tha Angjushev.

IRFAN BUÇI, ZËVENDËSDREJTOR I RI I DOGANAVE

Posti i numrit dy në Doganë do t'i takojë Degës së BDI-së së Shkupit dhe ky vendim ka marrë veçmë dritën e gjelbër. Kështu, në mbledhjen e djeshme të Qeverisë ka kaluar vendimi që Irfan Buçi të emërohet zëvendësdrejtor i Doganave. Buçi vjen në vend të zëvendësdrejtorit të deritanishëm Lavdrim Veliu. Buçi me profesion është jurist i diplomuar, ndërsa në doganë punon gjatë kohë.

TAKIM PUNE I MINISTRAVE TË BUJQËSISË TË MAQEDONISË DHE TË SHQIPËRISË

FONDE EVROPIANE BASHKË ME SHQIPËRINË

Ohër, 3 prill - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Lupço Nikollovski, dje në Ohër realizoi takim pune me homologun e tij nga Republika e Shqipërisë, Niko Peleshi. "Në takim u diskutuan shumë tema me interes të përbashkët, para së gjithash këmbimi tregtar dhe potenciali që ekziston për avancimin e zhvillimit të bujqësisë, prodhimtarisë së ushqimit dhe shfrytëzimi maksimal i mundësive për bashkëpunim bilateral shtesë. Në frymën edhe të Procesit të Berlinit, biseduam për nevojën e tejkalimit të të gjitha barrierave jodoganore ose jotarifore në interes të rrjedhës së lirë të mallrave, siç parashihet anëtarësimi në CEFTA", theksoi Nikollovski. Një pjesë e takimit të djeshëm u shfrytëzua për diskutime në lidhje me mundësitë për shfrytëzimin e mjeteve të parapara përmes IPARD



programeve të BE-së.

"Ne jemi tërësisht të fokusuar në shfrytëzimin maksimal të mjeteve të programit IPARD 2, si në pjesën e akreditimit të masave të reja, përmes fondeve të reja garantuara e deri në rritjen e kapacitete-

ve të Agjencisë pagesore, natyrisht edhe për mundësitë për financimin e projekteve për bashkëpunim tejkufitar, përmes rrjetëzimit të komunave më të vogla në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës në mjediset rurale", shtoi Nikollovski.

Temë e bisedës në takimin në Ohër dhe për të cilën do të diskutohet edhe në takimin e tyre të ardhshëm të caktuar për një muaj në Shqipëri, ishte edhe çështja rreth peshkatarisë, para së gjithash në drejtim të mbrojtjes së fondit për peshkim në Liqenin e Ohrit.

Ministri Peleshi theksoi se kundesit për fondin për peshkim në Liqenin e Ohrit është përgjegjësi e dy shteteve. Ai e theksoi nevojën nga bashkëpunimi intensiv bilateral, si përmes kontrollit sistematik në vetë menaxhimin me fondin e peshkimit, ashtu edhe përmes kontrolleve të drejtpërdrejta të përforcuara në peshkim, gjegjësisht mbrojtjes së tij fizike në dy anët e liqenit. Republika e Maqedonisë ka procedurë të hapur për revizion në bazë të peshkimit për Liqenin e Ohrit, me qëllim të mbrojtjes së fondit të peshkimit në liqen, para së

gjithash të llojeve endemike si trofta dhe belvica. "Me ministrin shqiptar biseduam për nevojën nga kontrollat e përforcuara të peshkimit nga dy anët e liqenit. Ai informoi se tani më ka ndërmarrë masa dhe aktivitete me kooperativën që drejton me fondin e peshkimit nga pala shqiptare.

Në takimin e ardhshëm ministri do të shqyrtohen edhe informacionet e grupeve formale të punës, e gjithë kjo si konfirmim i fokusimit të Ministrisë për mbrojtjen e fondit të peshkimit në Liqenin e Ohrit", tha Nikollovski.

Në kuadër të Ministrisë resore, paralelisht rrjedh procedura për shpalljen e konkursit për ndarjen e koncesionit për ekonomizim me fondin e peshqve në Liqenin e Ohrit, duke e pasur parasysh që sivjet skadon marrëveshja me koncesionarin e tanishëm.

DEBAT "DREJTËSI PËR TË GJITHË"

NJË LIGJ PËR ZBARDHJEN E RASTEVE TË MONTUARA

Ndryshe nga ekspertët që kërkojnë një Ligj të posaçëm, zyrtarët qeveritarë thonë se zgjidhja e rasteve të montuara politike duhet të bëhet përmes kornizës aktuale ligjore, ndërsa për këtë thirren në rekomandimin e Komisionit Evropian



NASER RAUFI

Në të tre proceset gjyqësore - në "Sopoti", "Monstra" dhe "Lagja e Trimave" është shkelur parimi i gjyqimit të drejtë, pala mbrojtëse çdoherë ka qenë në plan të dytë, refuzimi i dëshmitë po ashtu është element i përbashkët. Të tre këto lëndë janë pjesë e 'bombave' të publikuara, për të cilat kompetenca ligjore për hetim bien mbi Prokurorisë Speciale Publike. Të tre këto raste ku unë i mbroj të akuzuarit, i ka montuar Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim, respektivisht aktakuzat janë të njëjtat për "terrorizëm"

mbështeten dhe do ta vërtetojnë pafajësinë e tyre. Arsye të Qeverisë, siç thanë ata, se Komisioni Evropian nuk e lejon një gjë të tillë, nuk janë të vërteta dhe se po ky Komision në raportet e fundit për Maqedoninë, ka nënvizuar se në këtë shtet ekziston drejtësia selektive dhe përndjekja politike.

Zëvendësiministri i Drejtësisë, Oliver Ristovski, me këtë rast njoftoi se me përfaqësuesit e Komiteti për mbrojtjen e të drejtave, ka zhvilluar disa takime dhe se janë përfunduar qëndrimet, mirëpo ai edhe tutje e konfirmoi qëndrimin se

zgjidhja e rasteve të montuara politike duhet të bëhet përmes kornizës aktuale ligjore.

"Qeveria do të bëjë përpjekje që qytetarët e prekur nga proceset e montuara politike të kenë qasje deri te të gjitha provat dhe dëshmitë të cilat do t'i shfrytëzojnë në procedurat e mëtutjeshme gjyqësore, në bazë të dispozitave aktuale ligjore. Shpresoj se kjo do të ndodhë në afat sa më të shkurtër. Të gjitha vërejtjet, rekomandimet dhe kërkesat e juaja do t'ia adresoj Qeverisë, më konkretisht Këshillit për implementimin e Strategjisë

për reforma", tha Ristovski.

Prezantimin e tij para profesorëve, kolegëve dhe ish të burgosurve politike, të martën e pati edhe avokati Naser Raufi, i cili fjalimin e tij e mbështeti në një analizë të rasteve "Sopoti", "Monstra" dhe "Lagja e Trimave". Sipas avokatit Raufi, të tre këto lëndë gjyqësore kanë prapëvijë politike dhe rastësisht ose jo - të njëjtit kanë një varg elementesh të përbashkëta, të cilët e vërtetojnë montimin e tyre. "Në të tre proceset gjyqësore për lëndët e apostrofuara është shkelur parimi i gjyqimit të drejtë, pala mbrojtëse çdoherë ka qenë në plan të dytë, refuzimi i dëshmitë po ashtu është element i përbashkët, respektivisht në gjykimin për 'Lagjen e Trimave', na janë refuzuar të gjitha 200 dëshmitë e prezantuara. Maltretimet fizike dhe psikike janë njëkohësisht prezent në të këto raste. Të tre këto lëndë janë pjesë e 'bombave' të publikuara, për të cilat kompetenca ligjore për hetim bien mbi Prokurorisë Speciale Publike. Të tre këto raste ku unë i mbroj të akuzuarit, i ka montuar Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim, respektivisht aktakuzat janë të njëjtat për 'terrorizëm' dhe se motivi i kryerjes së veprës dhe zbulimi i autorëve të vërtet (organizatorëve), çdoherë ka mbetur enigmë", tha avokati Raufi.

Ndryshe, pjesëmarrësit në këtë debat, shtuan se masat e paraburgimit të shqiptuara në kohën e ish-Qeverisë së kaluar, aspak nuk janë argumentuar dhe arsyetuar, gjegjësisht faktet për mos shqiptimin e këtyre masave fare nuk janë marrë parasysh.

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 3 prill - Rigjykimi i rasteve të montuara politike gjithsesi se duhet të ndodhë. Proceset gjyqësore ku janë shkelur liritë dhe të drejtat e njeriut gjatë kohës së qeverisjes së Nikolla Gruevskit, doemos të rishqyrtohen. Kështu është shprehur kryetari i Partisë Liberale, Pavle Trajanov, i cili në konferencën e radhës "Drejtësi për të gjithë", të organizuar nga Komiteti për mbrojtjen e të drejtave, theksoi se rigjykimi i rasteve të montuara duhet të nis nga shkeljet e parimit të prezumimit të pafajësisë e deri te identiteti i dëshmitarëve të koduar.

"Shpallja për fajtor e personave të arrestuar nga pushteti i kaluar ishte sinjal, të cilin e jepte MPB-ja drejtuar Prokurorisë Publike dhe Gjykatave se personi në fjalë doemos duhet të dënohet. Tutje, raste tjera të cilat duhet të rigjyken janë ato lëndë ku janë shfrytëzuar

Masat e Posaçme Hetuese, prezantimi i të cilëve është bërë në mënyrë selektive. Besoj se kjo duhet të jetë bazë shtesë për rigjykimin e lëndëve të montuara politike. Po ashtu, rastet me dëshmitarë të mbrojtur, respektivisht dëshmitarë të imagjinuar, duhet të rigjyken. Sipas meje, këto janë tre elemente kyçe përmes të cilave duhet të ripërsëritet një procedurë gjyqësore e realizuar gjatë pushtetit të kaluar", tha Pavle Trajanov.

Konsensusi politik dhe vullneti para zgjedhjeve të kaluar, se kjo çështje duhet të zgjidhet me miratimin e një Ligji të veçantë për këtë kategori të të burgosurve, siç tha Trajanov, nuk duhet të zbehet tash kur ekziston një qeveri e re. Panelistët, të cilat diskutuan në temën "Drejtësi për të gjithë" dhe mënyrën se si duhet të zbardhen rastet e montuara politike gjatë kohës së Gruevskit, theksuan se e patjetërsueshme është miratimi i një përmbytje të re ligjore, përmes të cilës viktimat e regjimit të kaluar do të

"SHUPLAKAT" VAZHDOJNË MË 19 PRILL

PSP KËRKON PARABURGIM PËR ANDONOVSKIN

Shkup, 3 prill - Prokuroria Speciale Publike kërkon shqiptimin e masës së paraburgimit për të akuzuarin Millan Andonovski, i dyshuar në rastin "Shuplakat". Prokurorja e rastit, Fatime Fetaj, të martën para Gjykatës Penale të Shkupit njoftoi se PSP, ka kërkuar nga Inspektorati shtetëror sanitar dhe shëndetësor të kryejnë kontroll të jashtëzakonshëm në një klinikë private, me të vetmin qëllim vërtetimin e fakteve se vallë i akuzuari Andonovski, me të vërtet është i sëmurë ose bëhet fjalë për dokument, i cili është dhënë nga klinika me të vetmin qëllim mënjanimin e procesit gjyqësor nga i akuzuari. "Për shkak të mungesave reale, është iniciuar mbikëqyrje e jashtëzakonshme profesionale, përmes Odës së mjekëve dhe shërbimet që i kontrollojnë pushimet mjekësore në Fondin për Sigurim Shëndetësor. Kësisoj, klinika private nga ku Andonovski ka nxjerrë arsyetimit (vërtetimet) për pushim mjekësor, është vërtetuar se ka bërë shkelje, respektivisht gjatë nxjerrjes së raportit, ata nuk i kanë



zbatuar analizat standarde laboratorike për arsyetimin e sëmundjes", tha Fetaj. Për këtë arsye, ajo shtoi se vërtetimet për pushime mjekësore janë nxjerrë me qëllim para seancave gjyqësore dhe në këtë drejtim - Fetaj paralajmëroi se do të iniciojnë procedurë kundër mjekëve. Paralelisht me këtë njoftim, Fetaj kërkoi nga Gjykatat shqiptimin e masës së paraburgimit ndaj An-

donovskit, me qëllim sigurimin e prezencës në seancat e radhës gjyqësore. I akuzuari Mile Andonovski, gjatë periudhës së kaluar ka munguar tre herë në seancë gjyqësore për rastin "Shuplakat", ndërsa si pasojë u imponua nevoja e prolongimit të procesit gjyqësor për dhunën në Komunën Qendër. Seanca e radhës për "Shuplakat", vazhdon me 19 prill. (O.Xh)

Jane Çento rikthehet në Shutkë

Shkup, 3 prill - Jane Çento, njëri nga të akuzuarit për ngjarjet e dhunshme në Parlamentin e Maqedonisë më 27 prill të vitit 2017, masa e paraburgimit shtëpiak i

është ndërruar me paraburgim, konfirmuan nga Gjykatat Penale. "Këshilli Penal pranë Gjykatës Themelore Shkupi 1 nga MPB-ja është njoftuar se personi për të cilin me vendim të Këshillit është përcaktuar masë paraburgim shtëpiak, nuk e ka respektuar masën e caktuar dhe për atë arsye Këshilli ka ndërruar masën paraburgim shtëpiak me paraburgim", thonë nga Gjykatat. Në mëngjesin e djeshëm rreth orës 8:30, policia në Prilep ka arrestuar Jane Çento, njërin nga të dyshuarit për ngjarjet në Parlament, i cili ishte në paraburgim shtëpiak në shtëpinë e tij në rrugën "Cane Konjarec".



Tani që arsimit i mesëm është i obligueshëm, ata që kryejnë arsimin nëntëvjeçar duhet të ndjekin të njëjtat rregullat që vlenin para 2007-ës. Pra, duhet të parashtrijnë lutje për regjistrim në shkollë, të shpejtojnë të zënë vendet që në aftin e parë dhe t'u nënshtrohen testeve apo provimeve pranuese në shkollat ku janë paraqitur më tepër kandidatë

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 3 prill - Nuk ka mjaftuar një dekadë nga koha kur në Maqedoni është bërë i detyrueshëm arsimi i mesëm e që Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) të ndryshojë qasjet në krijimin e politikave arsimore, respektivisht të mekanizmave për kalimin e nxënësve nga niveli fillor në nivelin e mesëm arsimor. Në përjashtim të shtimit të numrit të vendeve të lira për regjistrim, gjithçka tjetër që ka të bëjë me regjistrimin në shkollat të mesme vazhdon të jetë e njëjtë me kohën kur për t'u regjistruar në ndonjë shkollë të mesme, kandidatët duhej ti nënshtroheshin testimit dhe të gjitha kriteret tjetra për regjistrim, sepse shkollimi mesëm nuk ishte i detyruar. Madje, për nxënësit shqiptarë ishte privilegj, pasi deri vitin 2002 - gjysma e gjysmëmaturantëve shqiptarë mbeteshin jashtë sistemit arsimor. Për paralelet me mësim në gjuhën shqipe kishte vend vetëm për gjysmën e nxënësve që kryenin arsimin e lartë.

MUNGON ORIENTIMI I HERSHËM I NXËNËSVE

EDHE SHKOLLIM I DETYRUESHËM, EDHE PROVIM PËR REGJISTRIM



Edhe tani që arsimit i mesëm është i obligueshëm, të gjithë 15 dhe 16 vjeçarët duhet të ndjekin të njëjtat procedura. Pra, duhet të parashtrijnë lutje për regjistrim, të shpejtojnë të zënë vendet nëpër shkollat e preferuara, tu nënshtrohen testeve pranuese nëse në shkollën ku ata dëshirojnë të regjistrohen janë paraqitur më tepër kandidatë se sa MASH-i ka planifikuar të regjistrohen në atë shkollë... Këto janë arsyt që në shumicë shkollat nuk mund të eliminohet praktika e krijimit të paraleleve ar-

tificiale, respektivisht të formimit të paraleleve maqedonase me nxënës shqiptarë. Për po këto arsye, nëpër gjimnaze, shkollat e mesme të medicinës dhe ekonomisë - numri i nxënësve nëpër paralele është dukshëm më i madh se sa në shkollat profesionale në perspektivë, si ato të elektroteknikës, agromexhimit, veterinarisë, teknikës apo makinerisë. Në shkollat artistike është gjithashtu e pa rregulluar sa duhet çështja e regjistrimit të nxënësve. Jehona e regjistrimit është shpeshherë stihike, herë shumë e herë pak kandidatë.

MASH-i, gjithë këto vite ka dështuar të vendosë që në shkollat fillore mekanizimin e orientimit të hershëm të fëmijëve për nivelin pasardhës të shkollim për në shkollat e mesme dhe në të njëjtën kohë - të rregullojë ndarjen e paraleleve sipas gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi.

Orientimi i nxënësve është lënë në duart e fushatave propaganduese të shkollave, pasi cila shkollë punon më shumë në këtë drejtim, ajo do të tërheq nga vetja edhe numrin më të madh të nxënësve. Ndërkaq, askush në shkollat fillore (të paktën

në cikin e lartë të arsimit nëntëvjeçar) nuk merret me zbulimin e aftësive dhe dhuntive të nxënësve për fusha të veçanta dhe paralelisht kësaj - orientimin e nxënësve drejt shkollave të drejtimeve përkatëse. Bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin është një dobësi tjetër karakteristike, sidomos për shqiptarët.

Deri në 2007-ën, Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë "Naim Frashëri" në Shkup organizonte takime të përbashkëta mes përfaqësuesve të shkollave fillore dhe të mesme. Qëllimi i këtyre takimeve ishte gjetja dhe shfrytëzimi maksimal i ofertës që jepej për nxënësit shqiptarë me Konkursin për regjistrim të MASH-it. Mirëpo, pasi nga viti 2007, arsimit i mesëm u bë i obligueshëm për të gjithë, këto praktika të cilat ishin treguar pozitive dhe kishin dhënë rezultate të lakmueshme, në vend që të zgjerohen - u ndërprejnë krejtësisht. Problemi është se nuk u zëvendësuan me të tjera më të sofistikuar dhe më institucionale. Për pasojë, regjistrimi i nxënësve në shkollat e mesme është lënë në mëshirën e shkollave dhe Konkurseve të MASH-it, të cilat jo çdoherë mundësojnë qasje të barabarta për shkollim të mesëm për të gjithë nxënësit dhe jo çdoherë janë të çliaruara nga mendësia e dominimit të shumicës në dëm të pakicës.

ARTET PAMORE 2017

PROJEKTET LOKALE MË TË PAGUARA SESA NACIONALLET

Sipas një përlllogaritje mes fondit që kanë pasur në dispozicion dhe numrit të projekteve të realizuara, i bie që mesatarisht një projekt i një muzeu nationale të arrijë vlerën 50 mijë denarë, për dallim nga ato të institucioneve lokale që arrijnë deri në 54 mijë denarë

Koha Evis HALILI

Shkup, 3 prill - Projektet e institucioneve nationale të arteve vizuale, muzetë, galeritë..., kanë qenë më keq të paguara sesa ato që janë realizuar nëpër institucionet e tjera lokale. Sipas një përlllogaritje mes

fondit që kanë pasur në dispozicion dhe numrit të projekteve të realizuara, i bie që mesatarisht një projekt i një muzeu nationale të arrijë vlerën 50 mijë denarë, për dallim nga ato të institucioneve lokale që arrijnë deri në 54 mijë denarë. Ministria e Kulturës në raportin më të fundit të punës së saj gjatë vitit të kaluar, konstaton disnivelet e krijuara të financimit që shkojnë në favor të projekteve që realizohen në institucionet lokale, por nuk jep sqarime se për cilat projekte bëhet fjalë dhe në cila qendra kulture.

"Këto tregues flasin për një vlerë mesatare prej 50 mijë denarësh për një projekt tek institucionet nationale, që nuk është adekuate për këto lloj projektesh tek institucionet nationale. Nga ana tjetër vlera mesatare e një projekti të realizuar në institucion lokal është 54 mijë denarë, që është në mënyrë disproporcionale në raport me ato nacio-

nalet. Intenca është që në të ardhmen të reduktohet numri i projekteve, por të rritet mbështetja financiare për to, me qëllim që të sigurohet financim më cilësor dhe realizim adekuat i projekteve", bëhet me dije në raport.

Në sferën e arteve pamore gjatë vitit 2017 janë miratuar 310 projekte (të financuara me mbi 16 milionë denarë), 172 në institucionet nationale dhe 54 në institucionet lokale. Paralelisht janë financuar edhe 52 projekte jashtëinstitucionale (të financuara me mbi 3 milionë denarë) nëntë koloni artistike (560 mijë denarë) dhe 23 projekte të pavarura (të financuara me mbi një milion denarë). Në Raport bëhet me dije se gjatë këtij viti do të ndërpriten të gjitha konkursin për blerjen e veprave artistike.

"Duke u nisur nga konstatimet e përgjithshme se një formë e tillë stimulon klientelizëm në art, Mini-

stria e Kulturës nuk do të vazhdojë këto mënyrë financimi dhe blerjen e vlerave artistike", thuhet në raport. Gjatë vitit të kaluar në ministri ka pasur 26 oferta prej të cilave janë blerë në total 34 piktura në një vlerë mbi 4.500.000 denarë, si edhe pesë skulptura (680 mijë denarë). Artisti Reshat Ameti, prej disa kohësh edhe anëtar i Këshillit të Kulturës në ministri thotë se reduktimet nuk janë zgjidhje, qoftë të projekteve, shumave, apo masave stimuluese.

"Disproporcioni mes projekteve në institucionet lokale dhe nationale është befas, pasi dihet se janë institucionet nationale ato që marrin më shumë, ndërsa ato lokale, shtëpitë e kulturës, muze e të tjera realizojnë projekte më të vogla dhe më pak të paguara. Përpara se të ulim numrin e projekteve, apo të rrisim mbështetjen financiare, apo edhe në rastin më të keq

të pezullojmë masa stimuluese, siç është blerja e veprave të artit mbetet pyetja - Çfarë pastaj? Ajo që duhet të rregullohet në art dhe kulturë dhe për të cilën flasim 25 vjet vazhdon të mbetet cilësia, cili është sistemi i vlerave dhe si dhe kush janë ata nëpër komisionet që vlerësojnë me sa dhe si do të mbështet një projekt. Pasi nëpër komisionet për fat të keq qëndrojnë njerëz që nuk janë adekuat për të vlerësuar", thotë artisti Ameti. Në raport po ashtu ka vërejtje edhe lidhur me disproporcionin e krijuar edhe në financimin e projekteve të cilësuar si reprezentative në sferën e arkitekturës dhe dizajnit. Për këtë arsye një prej masave që do të marrë Ministria e Kulturës për të ndryshuar raportet e pabarabarta që janë krijuar pritet të jetë revidimi dhe numri i kolonive artistike, që financohen me buxhetin e këtij institucioni.

Sipas ndryshimeve ligjore - "naftë të gjelbër", apo naftë për mekanizimin bujqësor, do të fitojë çdo bujk apo ekonomi bujqësore e regjistruar, ndërsa për këtë dedikim për sivjet nga arka shtetërore janë ndarë afër pesë milionë euro

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 3 prill - Bujqit në Maqedoni në muajin qershor do të fitojnë naftë për 50 për qind më të lirë seç e paguajnë tani. Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim rural që pritet të votohen në Kuvend këtë muaj, shteti do të mbulojë 50 për qind të harxhimeve të naftës në bujqësi. Me ndryshimet ligjore, "naftë të gjelbër", apo naftë për mekanizimin bujqësor do të fitoj çdo bujk apo ekonomi bujqësore e regjistruar, ndërsa nga arka shtetërore për këtë dedikim për sivjet janë ndarë afër pesë milion euro. Njëherësh, nafta më e lirë për bujqit do të zbusë edhe shtrenjtimin prej 3 denarë të naftës me vendosjen e akcizës shtesë në nëntor të vitit 2017. Vlerësohet se kostoja e naftës ndikon mjaft në prodhimtarinë bujqësore, si për shkak të rritjes së madhe të çmimeve të derivateve të naftës në vitet e fundit, ashtu edhe për shkak të harxhimeve për 30 për qind më të mëdha të bujqve për shkak të posedimit të mekanizimit bujqësor të vjetër.

ÇDO BUJK DO TË KETË KARTELË ELEKTRONIKE

Vendosja e naftës së lirë në bujqësi paraqet realizimin e kërkesës së vjetër disavjeçare të bujqve për

VENDOSJA E NAFTËS SË LIRË NË BUJQËSI

SHTETI

SUBVENCIONON

ME 50 PËR QIND

vendosjen e regresit të naftës prej së paku 10 denarë apo vendosjen e subvencionit prej 30 denarë litër naftë për çdo hektarë të tokës së përpunuar. Parashikohet që çdo bujk të fitojë kartelë elektronike me të cilën do të blejë naftë për 50 për qind më të lirë, ndërsa do të përgatitet edhe një rregullore për shpërndarjen e saktë të saj.

Bujqit thonë se nafta për çdo vit paraqet një nga harxhimet kryesore të bujqve gjatë sezonit të mbjellave dhe korrjeve. Llogaritet se vetëm gjatë sezonit të mbjelljeve nevojiten 40 litra naftë për kulturat e drithit, 50 litra naftë për kulturat foragjere, apo 120 litra për një hektarë të perimeve të mbjella duke llogaritur vetëm sezonin e mbjelljeve.

Në ndërkohë, pas kalimit të procedurave qeveritare në javën e kaluar, edhe Komisioni Parlamentar për Bujqësi në mbledhjen e ditës së martë në leximin e parë dha dritë jeshile për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim rural që parashikon subvencionimin e 50 për qind të harxhimeve për blerjen e karburantit për meka-



Vendosja e naftës së lirë në bujqësi paraqet realizimin e kërkesës së vjetër disavjeçare të bujqve për vendosjen e regresit të naftës prej së paku 10 denarë apo vendosjen e subvencionit prej 30 denarë litër naftë për çdo hektarë të tokës së përpunuar. Parashikohet që çdo bujk të fitojë kartelë elektronike me të cilën do të blejë naftë për 50 për qind më të lirë, ndërsa do të përgatitet edhe një rregullore për shpërndarjen e saktë të saj

zim bujqësor. Me ndryshimet e propozuara ligjore parashikohet që bujqve dhe ekonomive bujqësore tu subvencionohet 50 për qind e mjeteve për blerjen e naftës, por jo më shumë se 100 mijë denarë për ekonomi bujqësore. Për blerjen e karburantit do të ndahen kartela pageso-

re me shuma të caktuara. Për këtë dedikim në buxhetin e shtetit për vitin 2018 janë parashikuar mjete në vlerë prej 310 milion denarë apo afër pesë milion euro.

Nga Ministria e Bujqësisë thonë se nafta e gjelbër vendoset me qëllim të uljes së harxhimeve prodhuese dhe rritjes së konkurrencës së sektorit bujqësor. Bujqit e përhëndesin vendosjen e kësaj mase në favor mase që do të sjellë prodhimtari më të lirë. "Nafta e gjelbër do të zbusë edhe goditjen e rritjes së akcizës për dizelin. Në të vërtetë do të blejmë naftë me çmim dyfish më të lirë seç është në shitje. Nëse një litër kushton 60 denarë, për ne do të jetë 30 denarë", thonë nga Shoqata e bujqve të Maqedonisë.

MASA QË PRAKTIKOHEN NË SHTETE TË TJERA

Një masë e tillë zbatohet në më shumë shtete të rajonit si Kroacia, Hungaria, Rumania etj, por edhe të Bashkimit Evropian. Në Kroaci prej vitit 2000, bujqit kanë të drejtë për naftë më të lirë për të gjitha hapësirat e mbjella bujqësore dhe për kul-

turat e mbjella për çka nga arka e shtetit ndahem me dhjetëra miliona euro. Vetëm në vitin 2015, Agjencia kroate e subvencioneve ka ndarë 171 milionë litra naftë më të lirë për 85 mijë ekonomi bujqësore. Prej vitit 2018 në Kroaci, me vendimin e Ministrisë së Bujqësisë, në sistemin e harxhimit të kuotave të gazit, dhe dizelit të kaltër për bujqit, janë shtuar edhe bletaria, rritja e derrave, rritja e kuajve dhe gomarëve dhe shpendaria. Kjo masë, sipas kompetentëve në Kroaci, i barazon bletarët me prodhuesit e tjerë për shkak se ato nuk kanë tokë, por megjithatë ju nevojitet karburant në punën e tyre të përditshme. Bletarët në Kroaci kanë pasur të drejtë për shfrytëzimin e karburantit më të lirë si kusht për uljen e harxhimeve të bletarisë lëvizëse apo mobile. Këtë të drejtë e kanë humbur për shkak se program kombëtar bletar nuk është llogaritur si pagesë direkte apo subvencion. Me ndryshimet e fundit, bletarët me kamionët e regjistruar për nevojat e bletarisë do të përdorin naftë më të lirë për të ulur harxhimet e transportit.

Liqeni i Ohrit 26 centimetra mbi nivelin e lejuar të ujit

Shkup, 3 prill - Niveli i Liqenit të Ohrit është 26 centimetra mbi nivelin e lejuar maksimal të ujit. Janë rritur nivelet edhe të lumënave nëpër shtet, përveç të Cërnares tek Novaci. Liqeni i Dojranit, madje, është pesë centimetra nën maksimumin e lejuar.



"#RACIONPËRTËGJITHË" PARA NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Ushqim të shpejtë për të varfrit

Shkup, 3 prill - Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dje para ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, start-up bashkësisë dhe organizatave qytetare e promovuan thirrjen publike "#RacionPërTëGjithë" për ndarjen e mjeteve financiare dhe krijimin e zgjidhjes së përmbytur dhe sistematike inovative për sigurimin e ushqimit për personat ose familjet me nevojë reale për përkrahje të bashkësisë. "Racion për të gjithë është sfidë me të cilën këmbëngulim të sigurojmë zgjidhje reale për racion nga tepricat e tregut për të gjithë ata të cilët kanë nevojë për përkrahje të tillë, e të tillë në vendin tonë janë shumë", tha drejtori i Fondit për inovacione dhe zhvillim teknologjik, Jovan Despotovski. Zgjidhja, tha ai, duhet t'i integrojë në vete edhe kompanitë e mëdha prodhuese, marketet, faktikisht të gjithë të cilët kanë teprica të tregut



që realisht përfundojnë në deponi, ndërsa, siç potencon, ne duam të përfundojnë te ata të cilëve u nevojiten.

"Sot biseduam me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, organizatat qytetare, start-up kompanitë, të mendojnë model që mund të japë efekt për distribuim të shpejtë të ushqimit të tepërt deri te shfrytëzuesit përfundimtar. Për dikë, ky

ushqim konsiderohet mbeturinë, për dikë do të mundësojë rritje të vlerave nutritive të racioneve, sepse për momentin nuk mund të lejohet ushqim më cilësor", tha ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carovska. Ajo tha se për momentin funksionojnë kuzhinat popullore, por potencon, ato nuk i japin efektet e dëshiruara, shtrenjtë paguhen dhe kanë përqindje të madhe të

mosshfrytëzimit. Thirrja ishte publikuar më 23 mars. Të gjitha ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe organizatat qytetare mund të paraqiten në thirrjen publike të Fondit për inovacione dhe zhvillim teknologjik dhe Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale "#RacionPërTëGjithë", të cilët me mjete financiare do të ndihmojnë të realizohet zgjidhja më inovative për sigurimin e ushqimit për qytetarët e varfër, të ofruar në thirrje. Thirrja publike është e hapur deri më 21 maj. Ajo ka të bëjë me të gjitha ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme dhe organizatat qytetare që punojnë në fushën e sipërmarrjes sociale, ose kanë për qëllim veprimtarinë e tyre ta zgjerojnë në këtë fushë. Buxheti i tërësishëm për këtë thirrje është dy milionë denarë. Do të financohen 90 për qind nga vlera e projektit, ndërsa 10 për qind do të duhet të mbulojë vetë aplikuesi.

THIRRJE PËR SHFRYTËZIMIN E INTERESIT për projektin Zhvillimi i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe ekskluziv - I fazën e zbatimit

Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, në bazë të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së konfederatës zvicerane, përfaqësuar nga Departamenti Federal punon duke vepruar përmes ambasada të Zvicrës në Republikën e Maqedonisë, përmes agjencisë Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë përfaqësuar nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, zbatojë Projekt për zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës në Maqedoni - faza e parë.

Projekti kërkon angazhimin e ekspertëve (koordinatorët) të cilët janë të interesuar të jenë pjesë e Projektit nënsheshtë të zbatimit të projektit (PESP), i cili pritet të fillojë me punë në mars të vitit 2018 dhe do të zgjasë deri në dhjetor 2020. Ministria e Vetëqeverisjes Lokale shpall thirrje për shprehje të interesit për ekspertë në poste kyçe në PESP të cilët do të jenë të angazhuar sapo të përfundojë procedura për zgjedhjen e anëtarëve të PESP dhe për të krijuar kushtet e duhura teknike për punë.

Kandidatët pritet të kenë njohuri dhe duhura dhe të plotësojnë kriteret e treguara më poshtë për çdo pozitë. PESP-i e që do të përbëhet nga ekspertë vendorë afatgjatë të cilët do të jenë përgjegjës ndaj Ministrisë të Vetëqeverisjes Lokale.

Për angazhim të përkohshëm në pozitë dhe mëposhtme:

1. Një (1) - Koordinator - Ekspertë 1 përgjegjës për zbatimin e Komponentit 2 dhe pjesërisht Komponentit 1 (70% angazhim)

2. Një (1) - Koordinator - Ekspertë 2 - përgjegjës për zbatimin e Komponentit 3 dhe pjesërisht Komponentit 1 (70% angazhim në punë)

Angazhimi nga pozicionet e mësipërme është për funksionalizimin e Programit për zhvillim të qëndrueshëm rajonal dhe përfshirjes së barabartë rajonal që përfshin zbatimin e aktivitetëve për të cilat përgjegjësi është Ministria e Vetëqeverisjes Lokale dhe të përcaktuar nga:

Komponenti 1: Qeveria ndan dhe zbaton fonde për zhvillimin e balancuar rajonal në mënyrë transparente dhe të parashikueshme, në përputhje me shkallën e zhvillimit të rajoneve planifikuese. "

Komponenti 2: Nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, duke përfshirë kategoritë e cenushme të qytetarëve, përfshihen në mënyrë sistematike nga Këshillat e Rajonal në procesin e planifikimit të zhvillimit rajonal. "

Komponenti 3: Qendrat e zhvillimit në të tëra rajonet planifikuese, veçanërisht në ato me pak të zhvilluara, përmirësojnë efektivitetin dhe efikasitetin e tyre. "

1. Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësi:

1. Aktivitetet: Koordinator 1 - përgjegjës për zbatimin e Komponentit 2 dhe pjesërisht Komponentit 1 (70% angazhim në punë)

- Bashkëpunimi dhe koordinimi me personat përgjegjës nga MVL dhe BRD
- Takimet e rregullta dhe bashkëpunimi me Koordinatorin e Programit
- Zbatimin e të gjitha aktivitetëve nga Komponenti 2 dhe pjesërisht nga Komponenti 1
- Përgatitja e raporteve mujore mbi progresin në procesin e zbatimit të Programit
- Përgatitja e kontratave për angazhimin e ekspertëve të jashtëm për programin
- Monitorimi i zbatimit të kontratave të lidhura me ekspertë të jashtëm
- Mbështetja, bashkëpunim dhe shërbime këshillimore për MVL dhe BRD
- Organizimi dhe realizimi i takimeve të rregullta koordinuese me Qendrat për zhvillimin e rajoneve të planifikimit.
- Shërbime këshillimore për qendrat për zhvillimin e rajoneve planifikuese dhe Këshillat për zhvillimin e rajoneve planifikuese
- Shërbime për MVL për përgatitjen e evolucionit final për Strategjinë për zhvillim rajonal 2009-2019
- Ndryshime dhe plotësime të ligjeve tjera dhe akteve nënligjore të përgatitura nga ministrinë tjera relevante për zhvillim rajonal
- Mbështetja për MVL në procesin e përgatitjes të planit të Veprimit integruar për implementimin të Strategjisë për zhvillim rajonal 2019-2020 dhe Strategjisë për zhvillim rajonal 2020 -2030
- Organizimi i panairit tregtar në Shkup për promovimin e të gjithë 8 rajoneve
- Organizimi i ngjarjeve vjetore për promovimin dhe dhënien e shpërblimeve të praktikave më të mira
- Mbështetja për përgatitjen e materialeve promovuese për zhvillimin rajonal për MVL-së
- Zbatimin e aktivitetëve për përgatitjen e Protokollit për përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile, sektorit privat dhe sektorit akademik në sesionet e Këshillit për zhvillim rajonal
- Sigurimi i mbështetjes profesionale për Qendrat për mobilizim të fondeve (buxheti kombëtar, fondet e BE-së) dhe lobim politik

- Zbatimin e aktivitetëve për të forcuar kapacitetet e Qendrave dhe Këshillave për vendimarrje transparente
- Shërbime këshillimore në Qendrat e zhvillimit në përgatitjen e Programeve për zhvillimin e rajoneve të planifikimit (2020-2024) përmes forumeve rajonale
- Mbështetja e Këshillave / Qendrave për përdorimin e forumeve të komunitetit në procesin e identifikimit të projekt ideve për skemën e granteve dhe thirrjeve të tjera
- Mbështetja për Qendrat për përdorimin e buxhetit gjinor dhe prioritetin i aktivitetëve në mënyrë pjesëmarrëse
- Zbatimin e aktivitetëve për forcimin e kapaciteteve për përfshirjen sociale për zhvillimin rajonal (në të gjitha nivelet)
- Zhvillimi i mjeteve për Qendrat për zhvillimin të plan rajoneve për të marrë reagime nga qytetarët mbi kërkesat e tyre
- Mbështetja e MVL-së në veprimtarinë financiare në kuadër të projektit
- Të gjitha aktivitetet e tjera nga Komponenti 3 në përputhje me planin e punës për zbatimin e aktivitetëve të projektit

1. Aktivitetet: Koordinator 2 - përgjegjës për zbatimin e Komponentit 3 dhe pjesërisht Komponentit 1 (70% angazhim pune)

- Bashkëpunimi dhe koordinimi me personat përgjegjës nga MVL dhe BRD
- Zbatimin e aktivitetëve nga Komponenti 1 dhe nga Komponenti 3
- Takime të rregullta dhe bashkëpunimi me Koordinatorin e Programit
- Bashkëpunimi dhe koordinimi me Zyrtin e zëvendësryemistrit përgjegjës për çështjet ekonomike
- Bashkëpunimi me ministrinë tjera të linjës
- Përgatitja të raporteve mujore për progresin në procesin e implementimit të Programit
- Përgatitja e kontratave për angazhimin e ekspertëve të jashtëm për programin
- Monitorimi i zbatimit të kontratave të lidhura me ekspertë të jashtëm
- Mbështetja, bashkëpunim dhe shërbime këshillimore për MVL dhe BRD
- Organizimi dhe zbatimin e takimeve të rregullta koordinuese me Qendrat për zhvillimin rajonal (minimum një herë në muaj)
- Shërbime këshillimore për Qendrat për zhvillimin e rajoneve planifikuese dhe Këshillat për zhvillimin e rajoneve planifikuese
- Mbështetja për MVL në ndryshimin e Ligjit për Zhvillimin Rajonal dhe akteve nënligjore dhe mbështetjen e linjës së ministrive programet e të cilëve kanë ndikim në zhvillimin rajonal në ndryshimin e ligjeve dhe rregulloreve në juridiksionin e tyre
- Zhvillimi i Strategjisë së zhvillimit rajonal 2019-2029 në mënyrë pjesëmarrëse
- Organizimi i evenimenteve për dialog politik në mes Kabinetit të Zëvendësryemistrit për Çështje Ekonomike dhe koordinimi me ministrinë të linjës, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, ministrinë tjera përkatëse, Qendrave për zhvillim rajonal dhe Këshilla zhvillimit të plan rajoneve
- Vlerësimi i projekteve rajonale të financuara nga MVL dhe BRD dhe mbështetja për shkëmbimin e përvojave (praktikat më të mira)
- Trajnimi i Qendrave të zhvillimit të rajonit të planifikimit për aplikim të ri dhe dokumente të tjera për projektet rajonale
- Sesionet e monitorimit / trajnimit për MVL dhe BRD, bazuar në nevojat e identifikuar
- Organizimi i ndërtimit të ekipit të MVL dhe BRD
- Trajnimi për tema specifike bazuar në vlerësimin e nevojave
- Koordinimi (punëtorit të përbashkët) në mes të MVL, BRD, RDC dhe RS për zbatimin e suksesshëm të Programit për zhvillim rajonal
- Organizimi i konferencës ndërkombëtare për shkëmbimin e praktikave të mira në fushën e zhvillimit të balancuar rajonal
- Organizimi i konferencave për shkëmbimin e praktikave të mira në fushën e zhvillimit të balancuar rajonal në të 8 rajonet
- Udhëtimin studimor për të shkëmbyer praktikat e mira
- Sigurimi i mbështetjes financiare dhe shërbimeve këshillimore për zbatimin e projekteve nga strategjitë Rajonale të Inovacionit
- Sigurimi i mbështetjes për përmirësimin e shërbimeve këshillimore të qendrave të biznesit
- Zbatimin e skemës së grantit të parashikuar nga projekti
- Mbështetja e MVL-së gjatë veprimtarisë financiare në kuadër të projektit
- Të gjitha aktivitetet e tjera nga Komponenti 3 në përputhje me planin e punës për zbatimin e aktivitetëve të projektit

2. Kualifikimet profesionale / eksperiencia

- Koordinatori 1 - përgjegjës për zbatimin e Komponentit 2 dhe pjesërisht Komponentit 1 (70% angazhim pune)
- Minimum 3 vjet përvojë pune në fushën e zhvillimit lokal dhe rajonal
- Master i shkencave në politikën rajonale ose shkencat e shoqërore
- Bashkëpunimi i mëparshëm me komunat, këshillat për zhvillimin e rajoneve planifikuese dhe qendrat për zhvillimin e rajoneve planifikuese
- Përvojë në përgatitjen e dokumenteve strategjike dhe planore në fushën e zhvillimit rajonal
- Përvojë në vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet sektorit qeveritar, autoriteteve lokale, sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve akademike
- Rekomandimet e hartuesve të politikave kryesore (MVL-së, BRD, Qendrat, etj)
- Koordinator 2 - përgjegjës për zbatimin e Komponentit 3 dhe pjesërisht Komponentit 1 (70% angazhim në punë)
- Minimum 3 vjet përvojë pune në fushën e zhvillimit lokal dhe rajonal
- Master në fushën e shkencave të politikës rajonale ose shkencat shoqërore
- Bashkëpunimi i mëparshëm me komunat, këshillat për zhvillimin e rajoneve planifikuese dhe qendrat për zhvillimin e rajoneve planifikuese
- Përvojë në vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet sektorit qeveritar, autoriteteve lokale, sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve akademike
- Përvojë në monitorimin e projekteve për zhvillim të balancuar rajonal
- Përvojë në përgatitjen e dokumenteve strategjike planore nga fusha e zhvillimit rajonal
- Rekomandimet nga zyrtarët kryesor të politikave regionale (MVL, BRD, Qendrat, etj)

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Dëshmi me shkrim për të gjitha kriteret e specifikuar në kualifikimet për fushën përkatëse, përkatësisht: CV-në profesionale (CV) dhe Letër-Interesi,
- Diploma e arsimit, master studime
- Certifikatë me minimum 3 vjet përvojë pune në fushën e zhvillimit lokal dhe rajonal
- Të paktën 3 certifikata për bashkëpunim me komunat, këshillat për zhvillimin e rajoneve planifikuese dhe qendrat për zhvillimin e rajoneve planifikuese
- Të paktën 1 certifikata për përvojën në përgatitjen e dokumenteve strategjike dhe planore në fushën e zhvillimit rajonal

Kandidatët kanë të drejtë të dorëzojnë dokumentet nga pika 3, alineja 3,4 dhe 5 të dorëzojnë edhe më shumë vërtetime nga minimumi i kërkuar, të cilat do të merren parasysh gjatë vlerësimit ose gjatë vlerësimit të pranimit të kandidatëve.

Përveç përvojës relevante të cekur në kriteret, kandidati i përzgjedhur duhet të ketë këto kompetenca: Diplomë universitare në një fushë përkatëse, njohja e plotë e punës me kompjuter, shprehje e shkëlqyer (me shkrim dhe me gojë) kryesisht në gjuhën maqedonase, por edhe në gjuhën angleze , aftësi të ngurta në hulumtime dhe analiza, aftësi për të negociuar të ngurta, sjellje dhe trajnimin e prezantimit, aftësi përkatëse për menaxhimin me njerëz, informacion, kohë dhe burime, aftësi për të punuar në afate të ngjeshura dhe komplekse, dhe mbi të gjitha përkushtimin dhe entuziazëm për ndryshimet në shoqëri që do të kontribuojnë për një zhvillim më të mirë të të gjitha pjesëve të Maqedonisë ..

Me secilin prej kandidatëve që do të kenë dokumentacion të plotë, do të bëhet Intervistë për vlerësimin e shkathëtisë të komunikimit dhe prezantimit, gatishmërisë, etj. e cila do të vlerësohen në mënyrë adekuate. Dokumentacioni i paplotë nuk do të merret në konsideratë.

4. Dorëzimi i raportimit

Në çdo 6 muaj raport financiar me dëshmi për të gjitha shpenzimet që lidhen me aktivitetet e financuara në kuadër të Projektit, do të dërgohen nga ana e Koordinatorëve e komponentëve deri te ambasada e Zvicrës / SDC dhe MVL-së.

5. Aplikimi

Kushtet e deklaruara në shpallje, kandidatët duhet të përmblin në kohën e paraqitjes. Adresa e dorëzimit të aplikacionit: Arkiva e Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale Rr.Shën,Kiril dhe Metodi nr.54, 1000 Shkup me shënim: "MOS E HAPNI" dhe "Për shpallje publike" Projektin Zhvillimi rajonal i qëndrueshëm i barabartë dhe gjithëpërfshirës - Numri (1 ose 2 në pozicionin e punës).

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 12 prill 2018.

Ministria e Vetëqeverisjes Lokale
MINISTRI
Suheji Fazliu



REPUBLIKA E MAQEDONISË



Çerdhja publike për fëmijë Srnica e Komunës së Aerodromit në Qytetin e Shkupit

Në bazë të nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2014; 199/2014 dhe 27/2016), nenit 22 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015 – tekst i pastruar; 199/2014, 27/2016), nenit 143 paragrafi 3 pika 1 e Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/2013; 12/2014; 44/2014; 144/2014; 10/2015; 25/2015; 150/2015; 192/2015; 27/2016) dhe Rregulloren për elementet e domosdoshme të shpalljes publike për plotësimin e vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe formës, përmbajtjes dhe mënyrës së udhëheqjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të pavërteta gjatë punësimit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 34/2015), ÇPFKA SRNIČKA – Shkup publikon:

SHPALLJE PUBLIKE NR. 01/2018

Për punësim për kohë të pacaktuar të 9 (nëntë) personave – ofruar të shërbimeve dhe 4 (katër) personave teknik-ndihmës për vendet e punës në vijim:

1. DE3 0303 G01 001 – Përkëdhelës niveli I – 6 (gjashtë) realizues

- Kushtet e përgjithshme
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i aftë fizikisht dhe psikikisht;
- Të njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Të mos i jetë shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave penale kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese.

- Kushtet e posaçme
- Të mbaruar arsim të mesëm katër vjeçar dhe licencë valide për përkëdhelës

- Përvojë pune: me ose pa përvojë pune

- Orari i punës
- Ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orë të punës në javë 40 orë
- Orari i punës prej ora 07:00 -15:00

Neto shuma e pagesës në të holla: 14.772,00 denarë

2. DE3 0303 V01 001 – Edukator për fëmijë prej moshës 2-6 vjeçare niveli I – 1 (një) realizues

- Kushtet e përgjithshme
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i aftë fizikisht dhe psikikisht;
- Të njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Të mos i jetë shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave penale kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese.
- Kushtet e posaçme
- edukator për fëmijë mbi moshën dy vjeçare deri në moshën gjashtë vjeçare, gjegjësisht deri në nisjen për në shkollë fillore – profesor i diplomuar për edukim parashkollor, edukator i diplomuar për fëmijë deri në moshën parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor – me 240 kredi të arritura sipas SETK ose arsim sipëror të mbaruar të shkallës së VII/1 ose arsim të lartë të mbaruar përkatës për edukator dhe licencë valide për edukator

- Përvojë pune: me ose pa përvojë pune

- Orari i punës
- Ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orë të punës në javë 40 orë
- Orari i punës prej ora 07:00 -15:00

Neto shuma e pagesës në të holla: 19.581,00 denarë me arsim sipëror / 18.514,00 denarë me arsim të lartë

3. DE3 0401 A01 004 – Mirëmbajtës të higjienës niveli I – 3 (tre) realizues

- Kushtet e përgjithshme
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i aftë fizikisht dhe psikikisht;
- Të njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Të mos i jetë shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave penale kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese.
- Kushtet e posaçme
- Arsim fillor/të mesëm të mbaruar
- Përvojë pune: me ose pa përvojë pune

- Orari i punës
- Ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orë të punës në javë 40 orë
- Orari i punës prej ora 07:00 -15:00

Neto shuma e pagesës në të holla: 12.000,00 denarë

4. DE3 03 03 V01 005 – Motër e lartë medicinale niveli I – 1 (një) realizues

- Kushtet e përgjithshme
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i aftë fizikisht dhe psikikisht;
- Të njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Të mos i jetë shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave penale kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese.
- Kushtet e posaçme
- Për nivelin B1 bashkëpunëtor profesional të nivelit të parë – Motër e lartë medicinale: motër e lartë medicinale, motër e diplomuar e përgjithshme medicinale/teknik medicinal – me 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VI/1 dhe licencë valide për bashkëpunëtor profesional

- Përvojë pune: me ose pa përvojë pune

- Orari i punës
- Ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orë të punës në javë 40 orë
- Orari i punës prej ora 07:00 -15:00

Neto shuma e pagesës në të holla: 17.980,00 denarë

5. DE3 04 01 A01 005 – Kopshtar niveli I – 1 (një) realizues

- Kushtet e përgjithshme
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i aftë fizikisht dhe psikikisht;

- Të njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Të mos i jetë shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave penale kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese.

- Kushtet e posaçme
- Arsim fillor/të mesëm të mbaruar
- Përvojë pune: me ose pa përvojë pune

- Orari i punës
- Ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orë të punës në javë 40 orë
- Orari i punës prej ora 07:00 -15:00

Neto shuma e pagesës në të holla: 12.000,00 denarë

6. DE3 03 03 A01 004 – Defektolog (edukator special dhe rehabilitator) niveli I – 1 (një) realizues

- Kushtet e përgjithshme
- da e државјанин/на Република Македонија;
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i aftë fizikisht dhe psikikisht;
- Të njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Të mos i jetë shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave penale kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese.
- Kushtet e posaçme
- Për nivelin A1 bashkëpunëtor profesional të nivelit të parë – defektolog i diplomuar/edukator special dhe rehabilitator, me 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të arsimit dhe licencë valide për punëtor profesional

- Përvojë pune: me ose pa përvojë pune

- Orari i punës
- Ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orë të punës në javë 40 orë
- Orari i punës prej ora 07:00 -15:00

Neto shuma e pagesës në të holla: 20.056,00 denarë

VËREJTJE: Në pajtim me planin vjetor për punësim të ÇPFKA SRNIČKA – Shkup për vitin 2018, punësimet parashihen për gjithsej 4 maqedonas/e për persona ndihmës teknik.

Afati për paraqitje është 5 ditë pune, duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve të punës pas kalimit të afatit për paraqitje.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë Fletëparaqitje për punësim me bashkëngjitje të dokumentacionit në nevojshëm në vijim:

- diplomë/dëftesa për arsimin e mbaruar përkatës – origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;
- certifikatë të shtetësisë;
- certifikatë të mjekut;
- deklaratë të shkruar me dorë nga kandidati se njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik;
- dëshmi nga gjykata kompetente se kandidati nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

- dëshmi nga gjykata kompetente se kandidati nuk i është shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave penale kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese;
- licencë valide për përkëdhelës – origjinal ose kopje të vërtetuar në noter (vlen vetëm për kandidatët të cilët konkurojnë për vendin e punës nga pika 1 – Përkëdhelës niveli I);
- licencë valide për edukator - origjinal ose kopje të vërtetuar në noter (vlen vetëm për kandidatët të cilët konkurojnë për vendin e punës nga pika 2 - Edukator për fëmijë prej moshës 2-6 vjeçare niveli I);

- licencë valide për bashkëpunëtor profesional – origjinal ose kopje të vërtetuar në noter (vlen vetëm për kandidatët të cilët konkurojnë për vendin e punës nga pika 4– Motër e lartë medicinale niveli I);
- licencë valide për bashkëpunëtor profesional – origjinal ose kopje të vërtetuar në noter (vlen vetëm për kandidatët të cilët konkurojnë për vendin e punës nga pika 6 – Defektolog (edukator special dhe rehabilitator) niveli I);

Fletëparaqitjen për punësim kandidatët mund ta marrin nga drejtorja e ÇPFKA SRNIČKA – Shkup në adresën në vijim: bul. "Jane Sandanski" nr. 29A – Shkup.

Fletëparaqitjen për punësim me dokumentacionin e nevojshëm kandidatët duhet ta dorëzojnë në formë letër deri në arkivin e ÇPFKA SRNIČKA – Shkup ose përmes postës në adresën në vijim:

ÇPFKA SRNIČKA – Shkup
bul. "Jane Sandanski" nr. 29A – Shkup
(me shënjë: "Për shpallje publike nr. 01/2018")
Personi për kontakt – Janko Ralev tel. 072-247-508.

Kandidatët janë të obliguar që të dorëzojnë të dhëna të precize dhe të sakta.

ÇERDHE E TETOVËS ME NUMËR ENORM TË FËMIJËVE

MBIPOPULLIMI I ÇERDHEVE, ZGJIDHJA TEK OBJEKTI I RI



Çerdhja tek shkolla ekonomike ka kapacitet për 120 fëmijë, ndërsa janë regjistruar 170. Në çerdhen "Teteks" kapaciteti është për 160 fëmijë, kurse janë pranuar 220. Çerdhja e Vjetër gjithsej ka kapacitet për 90 fëmijë, kurse janë regjistruar 130. Edhe në objektin e lagjes "Potok" kapacitetet janë për 120 fëmijë, kurse 165 janë të regjistruar

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 3 prill - Çerdhet e Tetovës janë të mbi populluara dhe nga viti në vit ka më shumë fëmijë se sa ka kapacitete për të pranuar. Kjo situatë tashmë është e pranishme vite me radhë, ngase rritet numri i prindërve që dërgojnë fëmijët në çerdhe. Sipas drejtoreshës së çerdhes "Rinia", Ramije Dauti, zgjidhja është tek ndërtimi i një objekti të ri. "Në vitin 2017 kishim një numër mbi kapacitetet që mund të marrin çerdhet. Gjithashtu, edhe në vitin 2018 kemi numër mbi kapacitete, mirëpo nevojat e prindërve të cilët kanë nevojë të regjistrojnë fëmijët e tyre për përkujdesje në çerdhe rritet, kështu që nga ana jonë dhe nga ana e Komunës së Tetovës bëhen angazhime që të mund të sigurojmë mjete për ndërtimin e një objekti të ri. Janë bërë kërkesat, ka projekt - që të gjitha janë gati dhe presim momentin që të fillojmë ta realizojmë. Bëhet fjalë për një objekt me një kapacitet për rreth 400 fëmijë, që besojmë se atëherë do

të kishim mbuluar tërë Komunën e Tetovës, domethënë kur flasim për tërë Komunën e Tetovës, kemi parasysh edhe fshatrat përreth", deklaroi Dauti. Ajo shprehet se ende ka prindër në listat e pritjes për të sjellë fëmijët në çerdhe. "Tani për tani, nën përkujdesjen tonë vetëm në qytet janë 780 fëmijë, ndërsa në kuadër të çerdhes që e kemi në Komunën e Tetovës, kemi diku rreth 1070 fëmijë të regjistruar për vitin 2018. Kemi ende kërkesa të reja, pra kemi prindër që janë në listën e pritjes dhe që presin momentin kur ç'lajmërohet një fëmijë, menjëherë ftohet fëmija tjetër pasi Komisioni për pranimin e fëmijëve menjëherë thërret prindin tjetër dhe i ofron regjistrim", sqaroi drejtoresha Dauti. Këtë vit pritet të fillohet me renovimet e objekteve që janë në kuadër të çerdhes "Rinia" me çka do të ofrohen edhe kushte më të mira për fëmijët.

"Sa u përket kushteve në çerdhet tona, në këtë drejtim ne mundohemi, punojmë që ushqimim ta kemi sipas standarde-

ve dhe higjienën e kopshteve, mirëpo ne nuk kemi mundësi që ti bëjmë renovimet e mëdha që duhet të bëhen. Presim që në bashkëpunim me Komunën e Tetovës, nga ky vit të fillohet me renovimet e objekteve dhe besojmë që deri vitin e ardhshëm që të gjitha çerdhet do të jenë të rikonstruara dhe të rregulluara sipas standardeve. Është paraparë që të rregullohen edhe brenda edhe jashtë dhe të pajisen me të gjitha ato mjetet për punë për edukatorët, bisedohet për projekte pak më të mëdha, të cilat në bashkëpunim me Komunën e Tetovës, mendojmë që ti realizojmë këtë vit", theksoi ajo. Problem në vete është se në shumë çerdhe - edukatoreve ende nuk u janë vazhduar kontratat e punës për shkak se nuk janë dhënë pëlqime nga ana e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. "Për momentin, nevojat për edukatore të çerdheve i mbulon Komuna e Tetovës pasi nuk kemi pëlqime nga Ministria për Punë dhe Politikë Sociale. Edhe atë personel

që kemi nevojë, e siguron komuna, por presim që në të ardhmen të kemi pëlqime pasi që edhe vet e dini se ministrja Mila Carovska e tha se të gjitha çerdhet do të kenë punësime të reja dhe presim që të jetë ashtu, pasi vite me radhë kemi hapur edhe grupe në hapësira të ndryshme si në Komunën e Bogovinës, Komunën e Tearcës dhe në atë kohë - nuk na është dhënë pëlqim për ato të punësuar atje. Presim që tash të na jepjen dhe ti rregullojmë kuadrot që të gjithë të jenë me vendime të përhershme dhe të punohet normalisht siç i ka hije një çerdheje", sqaroi drejtoresha e çerdhes "Rinia", Ramije Dauti. Sipas informacioneve, çerdhja tek shkolla ekonomike ka kapacitet për 120 fëmijë, ndërsa janë regjistruar 170. Në çerdhen "Teteks" kapaciteti është për 160 fëmijë, kurse janë pranuar 220. Çerdhja e Vjetër gjithsej ka kapacitet për 90 fëmijë, kurse janë regjistruar 130. Në objektin në lagjen "Potok" kapacitetet janë për 120 fëmijë, kurse 165 janë të regjistruar.

KRONIKË

Katër fëmijë braktisin shtëpinë e fëmijëve

Një vajzë 14-të vjeçare në përkujdesje në Shtëpinë "25 Maji" është larguar nga institucioni për shkaqe të panjohura në periudhën prej 31 marsit deri më datën 2 të këtij muaji. Rastin, siç informon MPB-ja, punonjësi social në Shtëpinë "25 Maji" dje rreth orës 11 rastin e ka denoncuar në polici. Ndërmerren masa për gjetjen e personit. Në ndërkohë, edhe tre të mitur të moshës 12, 14 dhe 16 vjeç nga familjet përkujdesëse në Shtëpi ikën dje kanë ikur dhe janë larguar në një drejtim të panjohur. Rastin në polici dje në orën 13:10 e ka denoncuar i punësuar në Qendër për Punës Sociale nga Shtëpi, i cili ka qenë i caktuar si kujdestar i fëmijëve. Po ndërmerren masa për gjetjen e fëmijëve.

Gjendet gruaja e paraqitur si e zhdukur që vjet

Tridhjetë e dyvjeçarja nga Prilepi, e cila ishte e paraqitur si e zhdukur, është gjetur e gjallë mbrëmë në rrugën "Kej Dimitar Vllahov" në Shkup. Gruaja nga Prilepi A.C është paraqitur si e zhdukur më 6 tetor të vitit të kaluar.

Grabitje në barnatore në Kozle

Një autor i panjohur të hënën mbrëmë rreth orës 20:50 ka kryer vjedhje në një barnatore në rrugën "Kozle" në Shkup. Autori duke u kërcënuar me thikë ka marrë qarkullimin ditor dhe ka ikur në drejtim të panjohur. MPB-ja informon se e punësuar në barnatore në ora 21 ka paraqitur grabitësin në Njësinë për informim dhe komandë në Shkup. Janë ndërmarrë masa për gjetjen e autorit dhe zbardhje të tërësishme të rastit.

Prokuroria në Veles heton tentim për vrasje

Prokurori kompetent publik solli urdhër për kryerjen e një procedure hetimi kundër një personi të moshës 26 vjeçare, për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar se ka kryer vepër penale tentim për "vrasje" dhe vepër penale "rrezikim të sigurisë". Për shkak të rrezikut nga ikja, ndikimit mbi dëshmitarët dhe përsëritje të veprës penale, dyshuarit iu shqiptuar caktua 30-ditor. "I dyshuari më datë 1 prill të këtij viti rreth orës 20:30 në një objekt fermë derrash me qëllim ka tentuar të vrasë një person. I dyshuari në gjendje të dehur, me një sasi alkooli në gjak prej dy promilëve, në momentin kur në objekt ka ardhur i dëmtuari, të njëjtit i është drejtuar duke e sharë atë dhe familjen e tij. Më pas i dyshuari ka nxjerr thikë dhe me atë ka goditur disa herë duke i shkaktuar lëndime në trup. Më pas nga objekti ka marrë sëpatë dhe me të njëjtën është nisur drejt personave të pranishëm duke u kërcënuar se do t'i vret, me çka ka rrezikuar sigurinë e të dëmtuarve", thuhet në kumtesën e Prokurorisë publike. Duke konsideruar se ekzistojnë rrethana të cilat tregojnë rrezikun nga ikja, ndikimit mbi dëshmitarët dhe përsëritje të veprës penale, Prokuroria speciale publike në Veles deri te gjykatësi në procedurë paraprake të Gjykatës Themelore Veles ka dorëzuar propozim për përcaktimin e paraburgimit kundër të dyshuarit, i cili është pranuar dhe të dyshuarit iu shqiptua masë paraburgimi prej 30 ditëve.

DY RASTE TË DHUNËS NË TETOVË

Tetovë, 3 prill - Dhuna në familje vazhdon të jetë pjesë e pandarë në rajonin e Tetovës. Në raportin e fundit të policisë së Tetovës bëhet e ditur për dy raste të reja të dhunës. Rasti i parë është denoncuar nga 30 vjeçarja me iniciale L.A nga fshati Jazhincë, e cila të hënën ka denoncuar dhunë fizike familjare nga burri i saj 37-vjeçari me iniciale J.A, i cili rreth orës 7.30 minuta ka hyrë në dhomë dhe e ka ofenduar rëndë, ndërsa më pas e ka rrahur përpara

dy fëmijëve të mitur duke e goditur me grushte dhe shkelma në kokë dhe trup dhe ka kërkuar nga ajo që menjëherë ta lëshojë shtëpinë. "Në ofendimin e L.A-së janë kyçur edhe pjesëtarët tjerë të familjes, ndërsa më pas burri me iniciale J.A e ka futur në veturë dhe gjatë rrugës ka vazhduar që ta godas dhe e ka dërguar tek nëna e saj në fshatin Nerasht. Sipas rrëfimit të saj, burri të cilin e ka denoncuar dhe i cili në ndërkohë është arrestuar, edhe

në të kaluarën e ka dhunuar psikikisht dhe fizikisht. Po ndërmerren masa dhe aktivitete për zbardhjen e plotë të rastit, ndërsa J.A do të ballafaqohet me padi adekuate", njofton policia e Tetovës. Rasti tjetër i dhunës ka ndodhur mbrëmjen e së hënës, në shtëpinë e përbashkët të dy vëllezërve G.I 43-vjeçarë dhe R.I 37-vjeçarë në Tetovë, në të cilën shtëpi vëllezërit kanë jetuar në kate të ndryshme. "Dy vëllezërit fillimisht janë zënë

verbalisht për shkak të faturave të papaguara të rrymës elektrike, pas çka zënka verbale ka eskaluar në dhunë fizike, ku me shuplakë është goditur edhe gruaja e njërit prej vëllezërve, 32-vjeçarja me iniciale SH.SH. Menjëherë dy të përfshirët në këtë dhunë fizike familjare janë arrestuar dhe mbajtur në stacionin policor të Tetovës dhe pas zbardhjes së plotë të rastit, do të pasojë edhe padi adekuate", njofton policia e Tetovës. (U.H)

Asocialiteti i rrjeteve sociale

Nga

Blerim REKA



Historia e komunikimit, mund të ndahet në kohën: para dhe pas Bill Gejtsit. Deri vonë, mendonim se ndarja ishte: para dhe pas Gutenbergut. Por, mbi gjashtë shekuj nga shtypshkronja e ideatorit të "Printing Revolution", bota po sfidohet, sot, nga "Virtual Revolution".

Krijuesi i botës virtuale, revolucionarizoi jetën, mundësoi tregtinë elektronike (e-shopping), votimin elektronik (e-voting), qeverisjen elektronike (e-governance), por edhe de-monopolizoi diskursin tradicional mediatiak.

PERSONALIZIMI I LAJMIT

Mediat klasike, qoftë të shkruara apo audio-vizuale, humbën të drejtën ekskluzive mbi lajmin. Teknologjia e mençur e bëri çdo banorë të planetit tonë, autor të lajmit dhe redaktor të tij. Secili para tastaturës së një tableti, është krijues dhe emetues i lajmit. Lajmi pra u personalizua, e informimi u dekollektivizua. Përgjegjësia, ndërkaq u amnistua. Vetëkuptohet ky revolucion virtual, pati edhe dëme kolaterale. Shpërthyen edhe lajmet e rrejshme. Feak news u bë problem botëror; cyber crime-vepër e re penale; kurse hybrid war, një formë e re e luftës.

Pas sigurisë shtetërore, (national security); sigurisë njerëzore (human security); dhe sigurisë energjetike, (energy security); bota po sfidohet nga siguria on-line, (on-line security). Vjet, "Wanna Cry", sulmoi 230 mijë kompjuterë në 150 shtete. Vetëm nga viti 2016, ishin evidentuar 4 mijë sulme kibernetike në ditë, apo katër here më shumë se një vit më përpara.

NJË LINGUA FRANCA E RE VIRTUELE

Pse kaq terme angleze? Thjeshtë sepse është terminologji e standardizuar që vështirë përkthehet, e aq më pak kuptohet - pasi të përkthehet. Thjeshtë, po flasim në gjuhën Facebook-kçe: "e kish lajkit", ja bona dis-like, "ja bona share", ja bona tag, "ja bona block", etj. Virtualiteti global, pra unifikoi botën brenda një lingua franca të së sotmes. Një tjetër sfidë serioze e këtij revolucioni virtual, është ndërhyrja në jetën private, por edhe në atë publike, sidomos në punët shtetërore.

Skandalet e zbulimit të sekreteve private janë të panumërta. Po aq edhe ndërhyrjet hakeriste në sistemin shtetëror. Afera e fundit e "Cambridge Analitica", me cenimin e privatësisë së 250 milionë profileve të FaceBook-ut, e deri tek ndërhyrjet kibernetike në zgjedhjet perëndimore, dëshmojnë për dimensione shqetësuese të përdorimit pa kontroll të kësaj "arme" të shekullit XXI.

LUFTË PËR HAPËSIRË KIBERNETIKE-JO PËR TERRITORE

Armata e hakerëve zëvendësoi batalionet ushtarake. Lufta më nuk bëhet për territore, por për hapësirën kibernetike. Shtetet gjithnjë e më pak sulmohen konvencionalisht, e gjithnjë e më tepër elektronikisht. James Bondin dhe Mata Harin i zëvendësuan "spionët" anonim virtual, që depërtojnë në dokumentet më sekrete të shteteve dhe në llogaritë e fshehta bankare. "Panama papers" e dëshmoi më së miri këtë të fundit. Ndërkaq, "Weekeliks", e bëri aq të brishtë madje komunikimin më të fshehta-atë diplomatik-sa që ministritë e jashtme të disa shteteve-

pas rrjedhjes së kabllove diplomatike, i ri-kthyen makinat e vjetra të shkrimit dhe faksat e harruar. Keq-përdorimet në jetën on-line janë, evidente sepse "inovacionet" hakeriste, janë më përpara se veprimi ndalues i shteteve. Hakerët, thjeshtë i tejkalojnë programerët. Komisioni European, me 1 mars të këtij viti, nxori rekomandimin, me të cilën kërkoi që "platformat on-line të ndërmarrin masa pro-aktive, për të fshirë të gjitha përmbajtjet joligjore të postuara nga shfrytëzuesit e saj, si informatë që shkel ligjet e shteteve anëtare dhe të drejtën e BE". Mirëpo, aktualisht vetëm gjysma e shteteve anëtare të BE kanë ligje kundër asaj që njihet si "lese majeste", apo ofendim ndaj shefit të shtetit dhe vetëm po aq shtete anëtare, kanë ligje që dënojnë blasfeminë. Britania e Madhe me ligjin e saj për komunikim, ndëshkon mesazhet që përmbajnë ofendimi të rëndë. Edhe Danimarka, me ligjin e vet penal, inkriminon aktet e tilla edhe pse gjykatat daneze ende nuk gjykojnë asnjë rast të vetëm të tillë! Gjermania, ndërkaq me legjislacionin e saj të ri, kërkon nga platformat online, që të fshijnë brenda 24 orë-

Jashtë rrafshit penal, një tjetër dilemë është ajo shoqërore: nëse rrjetet sociale, filluan të shndërrohen në antipodin e vet: në rrjete asociale? Nuk ka nevojë për hulumtim shkencor që të vihet deri tek përgjigja në pyetjen e mësipërme. Vetëm vëzhgoni situatat e përditshmërisë sonë, ku dy a më shumë shokë, miq, kolegë, apo familjarë, komunikojnë në të njëjtën dhomë-jo duke biseduar, por duke këmbyer mesazhe. Pra, komunikojnë asocialisht përmes rrjetit, që quhet "social"!




ve, një përdorues- nëse ai përdor gjuhën e urrejtjes.

Pra, pas qasjes iniciale për derregullimin, (sipas të cilës nuk ka nevojë për rregullimin ligjor të portaleve), shtetet e BE, së voni filluan- nëse jo me ligje për këto platforma-atëherë me ligje të tjera, të ndëshkojnë keq-përdorimin e komunikimit online. Porosia ishte e qartë: nuk mund të lejohet vetëm qasja në treg, pa detyrimet ndaj shoqërisë. Një dialogë midis: biznesit, konsumatorit dhe legjislatorit, është i domosdoshëm. Biznesi duhet të udhëhiqej nga interesi, por duke zbatuar njëkohësisht edhe rregullat për EU Data Protection. Po në Ballkan? A ka kush e ndalë gjuhën e urrejtjes në postimet on-line? Vështirë. Anarkia ka përshkuar rrjetet rajonale on-line.

VIRTUALITETI VS. REALITETIT

Jashtë rrafshit penal, një tjetër dilemë është ajo shoqërore: nëse rrjetet sociale, filluan të shndërrohen në antipodin e vet: në rrjete asociale? Nuk ka nevojë për hulumtim shkencor që të vihet deri tek përgjigja në pyetjen e mësipërme. Vetëm vëzhgoni situatat e

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 3 prill | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

përditshmërisë sonë, ku dy a më shumë shokë, miq, kolegë, apo familjarë, komunikojnë në të njëjtën dhomë - jo duke biseduar, por duke këmbyer mesazhe. Pra, komunikojnë asocialisht përmes rrjetit, që quhet "social"!

Ku është këtu komunikimi social, nëse komunikojnë aparatet dhe jo njerëzit? Ku e gjeni këtu socialitetin e rrjetit që pretendon se lidh socialisht njerëzit?

A i kemi sot, fëmijët në lojërat në oborr, apo në lojërat on-line? Kush i mbron fëmijët tanë nga përmbajtjet e ndaluara të internetit?

A bartet dhuna virtuale në dhunën reale midis fëmijëve? Tragjedinë e "balenës blu" e tejkaluam, por nuk e dimë se çfarë befasie të reja mund të sjell keqpërdorimi i rrjetit social. Aq sa ky rrjet afron globalisht- distancat e largëta gjeografike për ti lidhur njerëzi, po aq ai largon lokalisht- më të afërmit nga komunikimi i thjeshtë social. Nuk je në Facebook- nuk ekziston, kjo është porosia e gurave on-line.

I madhi Umberto Eko, në letrën e tij shkruar nipit të vet, këtë mit virtuel e zhveshi më së miri me krahasimin e: letrës së pergamentit, me dokumentet elektronike. Edhe sot pas mijëra vitesh përmbajtja e shkruar në pergamet është ruajtur në muze dhe mund të lexohet. Ajo e regjistruar në: kasete, disketa apo CD, pas një periudhe u bënë të pa-përdorshme. Virtualja, pra nuk zëvendëson realen. Sikur edhe vet interneti. Sot, ai është i pazëvendësueshëm dhe bota jonë është gati jo-funksionale pa te. Mund vetëm të paramendojmë situatën, nëse vetëm 24 orë do ndërpritej interneti në tërë botën? Toka, për një çast nuk do funksiononte: as shërbimet, as bankat, as administrata.

A po bëhemi kështu robër të internetit dhe njerëzimi po jeton në një botë virtual në vend të asaj reale? A është internet i pazëvendësueshëm? Çdo teknologji e re dhe më e avancuar e zëvendëson paraprakën. Sidomos me depërtimin e inteligjencës artificiale. Çka vjen nesër? Çipat e kodifikuar në kokat e njeriut? Apo një kartelë universale për çdo banor të planetit?

Edhe interneti si edhe shpikjet dhe zbulimet tjera do jetojë, deri sa nuk zbulohet ndonjë formë e re e komunikimit global që do e hidhte atë në histori. Fundja, historia e njerëzimit nuk do të ishte ajo çka është - nëse do të kishte fund. Fukyama, në fund të shekullit të kaluar, proklamoi fundin e historisë, por ajo u rikthye në fillim të këtij shekulli madje tragjikisht. Historia nuk përfundon, pos atëherë kur nuk do ketë kush ta rrëfejë.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

TATIMI PROGRESIV: A është ajo që na duhet tani?

Nga
Bilal KASAMI



Për të sqaruar që në fillim opinionin, jam dakord se për të implementuar politika sociale më dinamike, duhen më shumë mjete buxhetore në dispozicion të kreatorëve të politikave fiskale. Rrjedhimisht, në një shtet si Maqedonia, në mungesë të resurseve natyrore dhe me një nivel jo të kënaqshëm të zhvillimit teknologjik, njëra ndër mundësitë e rritjes së mjeteve buxhetore është edhe rritja e tatimeve. Dhe, krejt natyrshëm për një parti social-demokrate është rikthimi i konceptit të tatimit progresiv. Por, ajo që dua të potencoj në këtë tekst ka të bëjë me momentin e implementimit të tatimit progresiv apo thjeshtë thënë a është e përgatitur qeveria për një hap të tillë. Pra, para se të vijmë deri te momenti i ndryshimit të tërësishëm të konceptit të politikave fiskale, nga ato që bazohen në tatimin e sheshtë drejt atyre të tatimit progresiv, qeveria duhet të ndër marrë një sërë aktivitete paraprake për të përgatitur sektorin real për një ndryshim kaq radikal.

Këtu, më poshtë do të shpalos vetëm disa ide se çka duhet të ndër marrë qeveria për të implementuar me sukses një politikë fiskale që mbështetet në tatimin progresiv në vend të tatimit të sheshtë. E gjithë kjo, në një mënyrë apo tjetër është notuar edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare në vazhdimësi në raportet e tyre për Maqedoninë. Njëherësh këto janë edhe pikat kryesore të programit ekonomik të Lëvizjes BESA si një ofertë ekonomike që mbështetet në politika fiskale që zhvillimin ekonomik e shohin më shumë se sa vetëm një rritje ekonomike.

Do të fillojë me trajtimin e një problematike që lirisht mund ta vlerësojmë se është pika neurologjike e sistemit fiskal të Maqedonisë, administrata tatimore. Pra, para se të ndërmerret çfarëdo hap drejt ndryshimit të sistemit fiskal, qeveria e Maqedonisë duhet që të ngre një administratë profesionale tatimore, e cila sektorin real do ta trajtoj me një respekt të veçantë dhe jo si disa kriminelë që në parim janë të prirë për evazion fiskal. Më shumë se çdo kund tjetër këtu duhet të vlejë parimi kushtetues se nuk je fajtor para se të vërtetohet fajti. Këtë e potencoj sepse sot, administrata fiskale sektorin real e trajton sikur ata janë kriminelë, me qasjen se të gjithë janë fajtorë dhe afaristët janë ata që duhet vërtetuar pafajësinë e tyre. Për të vazhduar më tej me një

problematikë që nuk është më pak e rëndësishme se e para, e që ka të bëjë me evazionin fiskal. Duke e ditur që Maqedonia ka një ekonomi jo shumë të zhvilluar më një praktikë jo të gjatë në drejtim të implementimit të politikave ekonomike që mbështeten në ekonominë e tregut. Nëse kësaj ia shtojmë edhe mungesën e institucioneve kredibile që janë përcjellëse të ekonomisë, që mbështetet në iniciativën private dhe tregun si parametër kryesor i aktivitetit ekonomik, atëherë më prioritet mbi prioritetet bëhet përpilimi i një strategjie shtetërore kundër evazionit fiskal. Gjithqysh që kjo strategji mos të mbetet vetëm një dokument, që do të ruhet në sirtarë të institucioneve shtetërore, në përpilimin e saj duhet të përfshihen të gjitha sektorët e shoqërisë, duke nisur nga ai i ekonomisë reale, akademikë, konsumatorë, ekspertë të jashtëm e të tjerë. E gjithë kjo me një dinamikë racionale kohore të implementimit të saj e që do të mbështetej në qasjen implementimit të saj hap pas hapi. Në çdo hap do të kishte indikatorë të vlerësimit të suksesit dhe mundësi revidimi, gjegjësisht përmirësimi të strategjisë nëse vlerësohet se në një moment ajo nuk i jep rezultatet e parashikuara.

Një çështje tjetër që për nga rëndësia sektori real do ta kishte renditur në vend të parë, ka të bëjë me shlyerjen e rregullt të obligimeve të institucioneve shtetërore, qendrore dhe lokale, ndaj kompanive private. Dhe kur jemi këtu, nuk mund të themi se është një çështje që kërkon që bartësit e politikave ekonomike të lodhen shumë në përpilimin e një strategjie perfekte. Minimumi i nevojshëm është disiplina maksimale e institucioneve publike në drejtim të shlyerjes së rregullt të obligimeve të tyre ndaj sektorit privat. Qasja duhet të jetë po ajo që mbisundon kur është në pyetje sektori privat. Derisa ka një qasje speciale ndaj sektorit publik, nuk mund të ketë disiplinë fiskale të bartësve të këtyre institucioneve. Nëse kësaj ia shtojmë faktin se sot qeveria me gjithë institucionet që janë në vartësi të saj është borxhliu më i madh i sektorit privat, problemi me të vërtetë bëhet serioz. Në një situatë të tillë, qeveria si bartëse e politikave fiskale nga gjeneratori i zhvillimit ekonomik bëhet pengesa kryesore e një zhvillimi që qëndrueshëm dhe më dinamik ekonomik. Një dimension tjetër, që kërkon një trajtim të veçantë sa i përket politikës fiskale si një gjenerator i një zhvillimi ekonomik,

ka të bëjë me rritjen e investimeve kapitale në strukturën e shpenzimeve publike. Pra, njihet mirë nga njohësit e problematikave ekonomike se vlerësimi i një buxheti si i mirë apo i keq për ekonominë e një vendi nuk varet vetëm nga volumi i tij. Jo gjithmonë një buxhet i madh është i dëmshëm për sektorin real ashtu si që një buxhet më i vogël detyrimisht nuk paraqet lehtësim për sektorin në fjalë. Rrjedhimisht më shumë se volumi i një buxheti duhet analizuar struktura e tij. Dhe kur jemi këtu, teoricienët e politikave fiskale pretendojnë se komponenti kapital i buxhetit qëndron në proporcion të drejtë me mundësinë që buxheti të jetë gjenerator i zhvillimit ekonomik.

Para se qeveria të rikthej konceptin e tatimit progresiv, duhet seriozisht të mendojë në drejtim të krijimit të një buxheti të bazuar në performancë, i cili do të mundësojë një prioritet të përmirësuar të shpenzimeve publike dhe përmirësimin e efikasitetit në sigurimin e shërbimeve publike. Një buxhet i bazuar në performancë do të sigurojë një ndërlidhje më të drejtpërdrejtë të politikave, gjegjësisht të planeve të qeverisë, punës së menaxhimit publik dhe administratës, ndarjes së mjeteve buxhetore dhe rezultateve të tyre.

Në situatën kur Maqedonia për këto njëzet e pesë vjet të transformimit të sistemit ekonomik, gati se në çdo dy vjet ballafaqohet me cikle zgjedhore dhe kur e kemi parasysh faktin se në shtete si Maqedonia zgjedhjet në masë të madhe determinojnë edhe përpilimin e politikave fiskale, një qasje e tillë e përpilimit të buxhetit do të ishte më se e nevojshme. Pra, një qasje e përpilimit të buxhetit bazuar në performancë do të mundësonte që votuesit më lehtë të vlerësojnë suksesin, gjegjësisht dështimin e politikave ekonomike dhe në kuadër të tyre edhe politikave fiskale.

Dhe, çështja e fundit që dua të shpalos këtu, edhe pse e fundit në renditje nuk është më pak e rëndësishme, ndërlidhet me problematikën e deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Ruajtja e nivelit të arsyeshëm të deficitit buxhetor dhe borxhit publik, pa pasur rrezik për aftësinë fiskale në servisimin e borxheve duhet të jetë njëra ndër prioritetet e çdo qeverie pa marrë parasysh orientimin e saj ideologjik dhe përcaktimin programor. Edhe kjo problematikë bëhet gjithnjë e më serioze ashtu si rritet borxhi publik në përmasa shqetësuese kohë-

Para se qeveria të rikthej konceptin e tatimit progresiv, duhet seriozisht të mendojë në drejtim të krijimit të një buxheti të bazuar në performancë, i cili do të mundësojë një prioritet të përmirësuar të shpenzimeve publike dhe përmirësimin e efikasitetit në sigurimin e shërbimeve publike...



ve të fundit. Duke e ditur që borxhi publik i Maqedonisë në masë të madhe është akumuluar si rezultat i politikave të dështuara ekonomike ndër vite, volumi i tij nuk mund të trajtohet njëjtë si volumi i borxhit publik të një shteti të zhvilluar ku borxhi publik është akumuluar si rezultat i krijimit të një vlere të re ekonomike.

Këto ishin vetëm disa nga hapat e nevojshëm që duhet të ndërmerren nga qeveria para se të vijmë te nevoja e ndryshimeve kaq serioze në vetë konceptin e tatimit nga tatimi i sheshtë drejtë tatimit progresiv. Hapa këto që në masë të madhe do të lehtësonin edhe implementimin e tatimit progresiv. Por, fatkeqësisht nuk na mbetet gjë tjetër vetëm se të konstatojmë se edhe futja e tatimit progresiv është një masë jo mirë e përpunuar e cila nuk do të ketë efektet e paralajmëruara në funksion të zhvillimit ekonomik, ashtu siç nuk i dha efektet e proklamuar me të madhe nga qeveria paraprake implementimi i tatimit të sheshtë.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

SQARIM

Në numrin e së martës, në faqen 11, në rubrikën "Forum", është përvjedhur një gabim teknik në shkrimin me titull "Republikë apo Vilajet?". Në vend të emrit të autorit Alfred Peza, është përvjedhur gabimisht emri Adelina Marku. Gazeta KOHA i kërkon ndjesë lexuesit si dhe autorit Peza për gabimin e paqëllimët.

AGIM JONUZ, aktivist dhe publicist

ISHIM DHE MBETËM TË URITUR!



Agim Jonuz, ka lindur në Shkup. Është shkolluar në vendlindje dhe Beograd. Njihet si analist, kolumnist, ish këshilltar dhe zëdhënës i ish-kryetarit të Parlamentit, Lubčo Jordanovski dhe ish-kryeministrit Buçkovski. Për momentin, thotë se ndodhet në çajtores dhe pret që dikush ti thotë "më duhesh". I papunë. Kujt i nevojitet një Agim Jonuz, i papunë? "Atyre të cilët shohin rrezik se do t'ua ulë popullaritetin dhe komoditetin politik?", thotë ai

Koha

Delvina KËRLUKU

KOHA: Z. Agim, gjatë kohës së pushtetit të kaluar, ishit mjaft i zëshëm kundër qeverisjes së atëherëshme, ndërsa mbështetet Revolucionin Laraman. Tani që është ndërruar pushteti, mund të na thoni nëse ndryshimet si dhe "jetë për të gjithë" po ndjehen gjithandej?

JONUZ: "Revolucioni Laraman" është një nga filmat që duhet studiuar dhe nga aty duhet të nxirren shumë porosi. Shumë nga pjesëmarrësit në Revolucionin Laraman janë abuzuar si personalitete. Marrë në kontekst, të etiketuar si përfaqësues të një partie e të paguar mirë, si mercenarë të shërbimeve të huaja, si kukulla të sponsorëve të ndryshëm dhe grupeve lobuese... Unë me gjithë përgjegjësi deklaroj se nuk kam librezë anëtarësi nga ndonjë parti, e as dikush të më ketë paguar, e as kam pasur ndonjë dobi, as pas gjithë asaj industrie të filmit nuk kam marrë angazhim, e cila do të më rriste mirëqenien sociale. Unë nuk kam qenë dhe nuk jam një përkrasës i diktaturave dhe totalitarizmit latent, që janë të paketuara në gënjeshtër mediatike! Por, nëse çdo shkollë është paguar, unë këtu tashmë e paguaj këtë shkollë me një dhimbje në shpinën time, sepse të gjithë në fund, përveç që kanë përgjuar nga pas, më thonë "Bravo Agim, shkëlqyeshëm ke thënë", nuk kam pikërisht asgjë! Kjo rrjedh përmasë kokave "Bravo Agim", tek Agim Jonuz.

Çfarë ka Agim Jonuz nga ajo? Po! Ndoshta ka, por ajo që i ka mbetë

është brenda rrugës në të cilën qytetarët e zakonshëm dhe të ndershëm ndonjëherë më ndalojnë në rrugë dhe shprehin respektin tim. Dhe, për 90 përqind të politikanëve janë duke prituri, ndoshta, ndoshta...! Le të kthehemi në arsyet e pjesëmarrjes sime në atë Revolucion. Unë jam shkupjan i motshëm, që kam jetuar bashkë me shumë kultura dhe që çmoj traditën në të cilën njeriu i ndershëm, pavarësisht nga përkatësia etnike, në çfarëdo baze duhet të jetojë në paqe, prosperitet dhe mirëkuptim me njëri-tjetrin.

Unë nuk kam mbrojtur askënd dhe nuk protestova ndaj askujt, përveç vetvetes dhe qëndrimet e tyre do të thonë se duhet çdo 'nijet i pastër dhe i ndershëm', duhet të ketë një të ardhme që është e lirë nga të gjitha instalimet mirë të komercializuara - lojërat nacionale romantike 'tre shkrepse', prapa të cilave qëndron viktima, njeriu i rastësishëm në rrugë. Në Maqedoni ka njerëz të mrekullueshëm që e ardhmja e tyre është paguar shtrenjtë si viktima të disa 'qëltimeve të mëdha', përderisa qytetarët e zakonshëm janë akoma të uritur, të etur, nuk kanë mbrojtje sociale, ndërsa gjatë gjithë kohës duke kërkuar në lajme, se cila nga mediat luan në mënyrë të përsosur rolin e tij - "kështu është për njerëzit tuaj të mirë!"

Kur duhet të ndjekim më seriozisht studimin për t'iu përgjigjur pyetjes tuaj nëse ata ndjehen të ndryshuar, duke instaluar një fuqi të re qeverisëse, gjithë ajo që duhet t'ju them është se do të rezultojë në një parafrazim të fjalorit të rrugës (një

version kulturor) ndërsa zhurmon "është llokum në kuti të tjera"! Në këndvështrimin e modelit politik të funksionimit, Maqedonia ka hyrë nga një në një tjetër totalitarizëm që me aq sukses është maskuar për momentin në nevojën për kontroll të fortë të terrenit për shkak të çështjes historike të ndryshimit të emrit, si kusht për hyrjen në strukturat e integritit evropian. Prolog për të luajtur dramën që thotë se duhet të luash "tre hapa përpara, një mbropa" absolutisht e njëjtë, vetëm se ndryshohen daullet. Njerëzit ishin dhe mbetën të uritur, të dëshpëruar, të zhgënjyer dhe të pashpresë në besimin se do të shohin ndryshime të shpejta dhe të dukshme. Nga ana tjetër, është instaluar një garniturë politike, e cila për fat të keq për të gjithë popullsinë, nuk ka sjellë buzëqeshje tek qytetari i zakonshëm.

KOHA: Mes komunitetit maqedonas dhe atij shqiptarë, si dy komunitete më të mëdha, shihet se nuk ka barazi politike, ekonomike, siç edhe padrejtësitë gjyqësore anojnë në një anë. Dhe, kur flasin politikanët për barazi dhe drejtësi, çfarë shihni ju?

JONUZ: Në Maqedoni nuk ka barazi dhe as nuk do të ekzistojë derisa të dy etnitetet me numër më të madh të fillojnë të punojnë në interes të shtetit dhe jo në kauzat - frustrimet dhe agjendat e tyre. Por, për të punuar në interes të shtetit, duhet të punojnë njëkohësisht në interesin tuaj personal dhe të mbrojnë të drejtat civile. Dhe pas dy dekadave e gjysmë, institucioni politik nuk arri-

ti të sqarojë pyetjen se çfarë është interesi kombëtar dhe çfarë është shteti. Për të pasur një shtet të shëndetshëm, duhet të kemi një popull të shëndetshëm dhe jo të frustruar, të plagosur, të pafavorizuar nga shumë elementë, duhet të kemi një pikë në të cilën arsyeja do të mbizotërojë mbi emocionet. Maqedonia mbijeton si një urë xhami, në të cilën nga njëra anë është emocioni etnik, dhe nga ana tjetër, arsyeja bashkëkohore e shekullit 21-të.

Ne kemi dy grupet kryesore etnike në të njëjtën shtëpi, ndërsa duhet të jetë një shtëpi për të gjithë, dhe në anën tjetër kemi mega manipulime me Platforma politike kombëtare romantike, me të cilën të gjithë janë humbës, përderisa nuk e kuptojnë se modeli i vetëm modern i shtetit funksional është udha e drejtë, e vërtetë. Kjo nënkupton të drejta të barabarta për të gjithë, kudo dhe sa herë që rrezikohet e drejta e qytetarit. Ajo që ende nuk është zgjidhur dhe ne ende kemi të bëjmë me "kush i jep ose i jep diçka dikujt" është një politikë komerciale mega në dy nivele.

E para është se gjeostrategjia për të cilën Maqedonia është "pikërisht kështu duhet", dhe e dyta është ajo politikë lokale, e cili gëzon privilegjet e këngës "kështu kemi nevojë". Dallimet, paragjykimet, konfliktet, përfitimet të ndryshme, frustrimi dhe çfarë shohin çdo ditë si padrejtësi dhe pabarazitë do të pastrohen në momentin kur nga skena politike do të zhidhen të gjitha "profesionet" maqedonas, shqiptarë, serbë..., etj. Për sa kohë që dikujt i nevojitet kjo

gjeostrategji, as nuk do të ketë ekuilibër, as nuk do të ketë balanc, as barazi as edhe kënaqësi të të gjitha palët. Arsyeja është e thjeshtë, në aspektin strategjik, vetëm vendet me paqëndrueshmëri të kontrolluar dhe gjysmë kaos të instaluar janë fitimprurëse për gjeopolitikën. E theksoj: Maqedonia është dhomë e madhe stërvitje për nevojat gjeopolitike për gjysmë kaos kontrolli!

KOHA: Së fundmi, Parlamenti i Maqedonisë miratoi Ligjin e gjuhëve (të shqipes), ndërsa vazhdojnë protestat kundër, me fyerje dhe thirrje antishqiptare, derisa presidenti Gjorgje Ivanov ka paralajmëruar sërish se nuk e dekreton Ligjin në fjalë! Si e komentoni?

JONUZ: Presidenti Gjorgje Ivanov këndon "këngën e mjellmës" së tij, sepse është i vetëdijshëm se kjo është, siç thonë serbët, "e ka luajtur pjesën e tij" në zgjedhjet e ardhshme presidenciale. Ai duhet deri në fund të shlyejë kredinë e tij për VMRO-DPMNE, e cila e bëri president dhe të cilin shumica e popullsisë e quajnë "fikus" për shkak të lëvizjeve të tij njëqind për qind klienteliste ndaj kësaj partie. Ligji për gjuhët është një lojë e madhe e nervave që duhet të mbahet deri sa nuk është instaluar në atë mënyrë që do të funksionojë vërtetë.

Çështje ditësh është kur ai do të jetë zyrtar. POR! Se Ligji siç u përmend më parë është si fushë ideale për ndarjen e komuniteteve, sepse kjo defokuson publikun nga problemet reale të theksuara tashmë, siç edhe i përmendëm: uria, papunësia,

mungesa e shpresës dhe dëshpërimi! Pra, është ushqimi ideal për plotësimin e hapësirës së medias që duhet të tregojë se diçka po ndodh. Në të njëjtën kohë, është një temë ideale e përditshme që mban "zjarr në tigan", ultranaconalistët, megapatriotët, kokat artificiale dhe anal-fabetët e rrugëve, të cilët eventualisht mund të shfrytëzohen nëse diçka nuk shkon siç ka menduar regjisori për një film. Dhe vetë Ligji i gjuhëve është punë e përfunduar! E pra, si do të funksionojë ai në jetën e përditshme, le të mendojnë ekspertët dhe të gjithë ata që kanë ngrënë mish viçi në dreka e darka zyrtare, ku edhe debatonin: "Kush ka të drejtë dhe kush është në gabim"! Kinse dikush do ta pyet popullin?

KOHA: Z.Agim, që nga 2001-shi e kënde, tensionet ndëretnike na përcjellin pothuajse për çdo moment. Maqedonasit janë të bindur se shqiptarët çdo ditë e më tepër kanë kërkesa në kurriz të tyre, ndër-sa shqiptarët mendojnë se gjithmonë e më pak përfitojnë nga institucionet e shtetit! Kur mendoni se këto ndasi do të tejkalohen dhe Maqedonia do të bëhet tamam multietnike dhe demokratike?

JONUZ: Maqedonia ka një demokraci të re që akoma e ushtron, por ky nuk është problemi i vetëm. Populli maqedonas mban komplekset e tyre historike, të cilat nuk mund t'i riparojë. Një popull i pakënaqur për herë të parë mori vendin e tyre që e ktheu atë në drejtimin e gabuar, pra në fillimet e saj. Problemi i saj më i madh është që ka sytë e mbyllura që në këtë zonë jeton bashkë me një popull autokton që kanë nevojë në një farë mënyre që të falënderojnë, për atë se shteti funksionon në përgjithësi. Maqedonia ka qenë gjithmonë një tërësi multietnike, multikulturore, multi-fetare dhe shumëgjuhësore. Ajo që me çdo kusht populli maqedonas insiston në lojën e shtetit kombëtar maqedonas nuk është një problem i shqiptarëve.

Autoktoniteti i popullit shqiptar në këto zona është një "plagë e kancerit" në anën e maqedonasve. Ndoshta tingëllon vrazhdë dhe mizor, por ajo është reale të thuhet se nëse shqiptarët nuk do të donin që ky shtet të qëndronte në fillimet të viteve 90-të, edhe nuk do të ishte tashmë. Tani, fakti që maqedonasit nuk do ta njohin kurrë këtë - është një çështje tjetër. Por, këtu ekziston një mënyrë krejtësisht e ndryshme që vlen për të dyja palët.


As maqedonasit nuk kanë dhënë për shqiptarët më shumë se Kush-tetuta, ligji dhe të gjitha normat kanë të drejtë për të, në anën tjetër janë fajtorë shqiptarët sepse thjeshtë nuk dinë se si të marrin dhe të instalojnë një rrugë drejt cilësisë, të gjithë ata që i ofron sistemi. Të dyja palët - si shqiptarët dhe maqedonasit nuk janë mjaft të pjekur në mënyrë demokratike, pavarësisht se kush është më i zgjuar ose jo. E gjithë çështja në këtë fushë i referohet paaftësisë për të udhëhequr dhe organizuar një shtet modern. Se kur Maqedonia do të jetë tamam multietnike - është e pakuptimtë, sepse ka qenë prej kohësh multietnike, vetëm problemi është në dizajnimin e brendshëm të cilësisë. Dhe nëse do të jetë demokratike moderne, ajo varet nga një fenomen krejtësisht i ndryshëm. Ky fenomen quhet eliminimi i korrupsionit, krimit, ultranacionalizmit dhe të gjitha pengesave që kanë ardhur si rezultat i papjekurisë politike. Gjithçka do të jetë ndryshe kur maqedonasit të kuptojnë se Maqedonia nuk është vetëm vendi i tyre.

KOHA: Maqedonia ka ecur në një rrugë të vështirë që nga ndërtimi i saj si shtet. Aktualisht, pozicioni i Maqedonisë thuhet të jetë rrugëtimi euroatlantik. Pra, vendi nuk ka alternativë tjetër pos kësaj rruge. Cilat mendoni të jenë sfidat me të cilat ballafaqohet Maqedonia drejt anëtarësimit në BE dhe në NATO?

JONUZ: Problemi me të cilin ballafaqohet Republika e Maqedonisë është përmendur më parë. Këto struktura kanë standardet e tyre që duhet të përmbushen. Askush nuk dëshiron të shikojë të vërtetën në sy dhe të lexojë në gjuhën diplomatike porosinë që vijën dhe të cilat kanë vetëm një "selam": "Ose, analizoni vetëm si është shteti ose zgjidh jetën përpara". Sa më shumë që tingëllon mendimi im tmerrshëm ose edhe jo i saktë, çdo person i zgjuar do të pranojë se pas kaq shumë vitesh vrapim në një vend, as NATO as BE nuk ka kohë për të debatuar me dështimin e udhëheqjes së pavarur të pushtetit ekzekutiv, gjyqësor të pavarur dhe mbi të gjitha - pastrimin e krimit si një refleks të pashembullt të instaluar në skenën politike që më së shumti e sheh shtetin si një ndër-marrje të madhe, e jo si shtet në të cilën duhet të bëhet një shtëpi e rehatshme për të gjithë qytetarët. Ky vit do të jetë vendimtar. Unë mendoj se pala shqiptare është shumë më bashkëpunuese, më konstruktive dhe se pozita e saj si subjekt politik e çon atë në një drejtim të mirë.

KOHA: Dikur, në kohën e kryeministrit Vllado Buçkovski, ishit këshilltar në kabinetin e tij. Mund të na flisni pak për këtë kohë dhe qeverisjen e atëhershme? Si arritët të ishit pjesë e kabinetit të ish-kryeministrit Buçkovski?

JONUZ: Askush nuk mund të mohojë faktin se në kohën e kryeministrit Vllado Buçkovski - marrëdhëniet ndëretnike ishin më të qeta. I lumtur jam në qoftë se dikush vë re se unë, si një këshilltar dhe zëdhënës, kam pasur disa ndikime. Kur z.Buçkovski e pranoi mandatin, unë kam qenë këshilltar (i vdekur) personal i kryetarit të Parlamentit, Lubço Jordanovski. Te Buçkovski jam rekomanduar si një ekspert mbi marrëdhëniet ndëretnike dhe si një njeri që në media është pranuar tmerrësisht pozitivisht. Isha shumë i lexuar si kolumnist dhe analist. Jam i lumtur të them se pas shumë vitesh, projekti "Kuvendi i Hapur" është i imi! Me këtë mburrej edhe Qeveria e kaluar! Për herë të parë deklaroi publikisht se me të ndjerin - presidentin e Kuvendit të RM-së, e krijuam idenë simpatike që gjatë pushimeve të deputetëve, të lëshohet muzikë. Së bashku me Lubço Jordanovski, unë jam kreatori i CD-DJ-Presidentit legjendar. Dhe kështu, kryeministrit Buçkovski i duheshin "shqiptarë të pranueshëm", që do të ishin një urë lidhëse mes dy etniteteve... Ndjem i gëzuar nëse dikush vlerëson se ia kam arritur këtij qëllimi. Ajo që ishte zgjidhje nga ana e maqedonasve duhet të pyetet edhe ana shqiptare me vetë faktin kur unë ju ofrova ta ndihmoj dhe këshilloj në kampusin shqiptarë, përveç buzëqeshjeve të nxehta - nuk mora asnjë ftesë. Gënjeshtër më e madhe është se unë kam qenë anëtar i LSDM-së. Asnjëherë, por as tani! Shok i çdo partie - PO! Me të gjithë shok, mirëpo me asnjërin "vëlla"! Ai, i cili që deklaroi me qëllim të keq se unë kam qenë ndonjë loj-



tar partie, publikisht e thërras në një duel televiziv. Pra., në këtëllë sot janë jokomerciale. Gjithmonë kam qenë vetvetja.

KOHA: Z.Agim, si e shihni rolin e shoqërisë civile në demokratizimin e vendit dhe përmirësimin e "gabimeve" të qeverisjes?

JONUZ: Sektori civil gjithmonë ka qenë bartës i korrektësive të pushtetit të karakterit publik. Tani sektori ka humbur pjesën më të madhe të kuptimit me instalimin e pushtetit të kaluar, sepse ishte në një mënyrë pushtet më totalitar i kontrolluar nga qendrat e fuqisë që sektori civil e keqpërdori për makineri propagandistike të saj. Edhe ajo pjesë e sektorit civil që nuk ishte i kontrolluar nga pushteti, kishte vetëm një epitet propagandistik që quhej SOROSOIDËT. Për kuptimin e një sektori civil, edhe një kohë të gjatë qytetarët nuk do ta ndjenjë të plot kuptimin e fjalës, për shkak se përveç një mundësie të angazhimit dhe përfitimit të parave të imëta, askush nuk e kuptonte se vjen si një fuqi e tretë të kuptimit të tij të vërtet "vox populi"!

Sektori civil i kompletuar funksionon në bazë të parimeve të fondeve, granteve, projekteve e kjo njëherë d.m.th. arsyetimin e parave me të cilat financohen. Ç'ka ju tregon kjo? Kjo nënkupton një filozofi të thjeshtë e cila thotë: "Do të ngritish zërin e popullit, por populli do të këndojë ashtu siç e paguaj unë"!

Sektori civil është i devalvur, vlerësoj se është koha që disa elemente që ishin aktive, tani të shuhet. Kemi gjenerata të reja që janë të gatshëm të sjellin një shpirt të ri në "botën e tretë të politikës". Si njohës i mirë i ambientit në shtet, vallë mendoni se pushteti është i gatshëm të financojë armën, e cila në çdo kohë tenton të kritikon ose e rrezon pushtetin?!

Mirë se erdhët në shtetin "Skopsko dhe gjithçka është e mundur"! Sektori civil (ai që është në shërbim të politikës) është GOMAR I NGORDHUR, por le të funksionojë

edhe më tej, sepse duhet edhe atë qindarkë të fituar nga të rinjtë - të shkurtrohet. Le të luajnë "shoqëritë civile"!

KOHA: Cila ishte Maqedonia e fëmijërisë tuaj, pra standardi i jetës, shoqëria, politika?

JONUZ: Nuk dua të flas për Maqedoninë e fëmijërisë sime se ajo është e lidhur ngushtë me një sistem tjetër, të një shteti tjetër. Nëse filloj të ndjem romantik për shumë gjëra që i kalova në rininë time në një jetë shumë më cilësore, menjëherë do të më quajnë Jugonostalgjik, kështu të karakterizojnë pikërisht ata njerëz që kanë fituar benefite të mëdha nga ajo kohë. Nuk dua të futem në kontekstin ndëretnik të atij shteti, por kisha dashur dikush të më demantojë se ishte shteti më social në botë. Ai që nuk do ta vërtetetojë këtë që them, flet me neveri.

KOHA: Me çfarë merret aktualisht Agim Jonuzi?

JONUZ: Agim Jonuz për momentin ndodhet në çajtores dhe pret që dikush ti thotë "më duhesh". I papunë. Kujt i nevojitet një Agim Jonuz, i papunë? Ata të cilët shohin rrezik se do t'ua ulë popullaritetin dhe komoditetin politik? Agim Jonuz mund të shihet çdoherë dhe çdokund, se si lirshëm dhe me krenari i sheh drejtë në sy, sepse nuk frikohet se dikush do t'i thotë "ti je një spiun", "ti je vjedhës", "je tradhëtar", "je jo njeri", "ti na ke shitur"... JO! JO! Prandaj mund të më vërejnë kudo dhe në çdo nivel. Ulem në motorin tim "Honda Pan European", dhe e ndjek erën e rrugëve të Shkupit, ku jam lindur dhe rritur dhe jam gjenerata e katërt. Një gjë është interesante. Kënga ime e preferuar derisa vozis motorin është "THIS IS A ROAD TO HEAL" (Kjo është rruga drejt çlirimit). Koicidencë?! Jo! Kjo është përgjigja e të gjitha pyetjeve që ju mi bëtë! Në një fjali! Dhe në ndërkohë e shëroj shpinën nga të rrahurit me dorë, në stilin "Bravo Agim". Nga bravo, nuk jetohej. Mirëpafshim!



RAPORTET EKONOMIKE KOSOVË-TURQI

POLITIKA NËN HIJEN E BIZNESIT

Vlera e importit të mallrave turke në Kosovë në vitin 2016 ka qenë rreth 300 milionë euro, duke e radhitur në vendin e tretë, pas Serbisë dhe Gjermanisë, përderisa eksporti i produkteve të Kosovës në Turqi ka qenë mbi 8 milionë euro.



Turqia është një prej shteteve me praninë më të madhe të investimeve direkte në Kosovë. Bashkëpunimi besohet se do të vazhdojë në ritmin e njëjtë, edhe pas zhvillimeve që pasuan dëbimin e gjashtë shtetasve turq nga Kosova për në Turqi.

Ky aksion i përbashkët i agjencive të inteligjencës nga Turqia dhe Kosova është lavdëruar nga presidenti turk Recep Tayyip Erdogan, por jo edhe nga kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, për çka më pas Erdogan e ka kritikuar ashpër kryeministrin kosovar, raporton REL.

Mbi 372 milionë euro llogariten investimet e Turqisë në Kosovë që nga viti 2008. Kurse, vetëm në vitin 2017, investimet e shtetit turk në Kosovë, sipas shifrave zyrtare, kanë qenë mbi 28 milionë euro, të dhëna këto që Turqinë e radhisin si shtetin e katërt me vlerën e investimeve, pas Gjermanisë, Zvicrës dhe Britanisë së Madhe. Edhe sa u përket shkëmbimeve tregtare, Turqia pozicionohet mirë në tregun e Kosovës. Vlera e importit të mallrave turke në Kosovë në vitin 2016 ka qenë rreth 300 mi-

lionë euro, duke e radhitur në vendin e tretë, pas Serbisë dhe Gjermanisë, përderisa eksporti i produkteve të Kosovës në Turqi ka qenë mbi 8 milionë euro. Arian Zeka, drejtor ekzekutiv në Odën Ekonomike Amerikane në Prishtinë, në një bisedë për Radion Evropa e Lirë thotë se mospajtimet aktuale politike duhet të zgjidhen përmes dialogut. Interesat ekonomikë, nënvizon ai, janë të ndërsjellë për të dyja shtetet. "Duke marrë parasysh rëndësinë që investimet turke kanë pasur në normën e përgjithshme të investimeve të huaja direkte në vendin tonë, pashmangshëm se kjo mund të ketë efekt. Megjithatë, në aspektin e shkëmbimeve tregtare, shteti i Turqisë duhet të ketë parasysh se tregu i Kosovës është një treg i rëndësishëm për të. Ndikime në rend të parë do të ketë për mallrat turke, të cilat plasohen në tregun e Kosovës. Kosova shumë pak eksporton në Turqi, kështu që ndikimi mund të jetë i papërfillshëm", thotë Zeka.

Javën e kaluar, autoritetet e Kosovës kanë dëbuar gjashtë shtetas turq nga Kosova për në Turqi, pesë

nga ta punonjës të institucionit arsimor Gulistan "Mehmet Akif", si dhe një mjek. Krerët e shtetit të Kosovës kanë thënë se kanë qenë të paimformuar për aksionin. Pas kësaj, presidenti turk, Recep Tayyip Erdogan, ka kritikuar kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, për shkak të qëndrimit të tij kundër dëbimit të shtetasve turq, kurse ka falënderuar presidentin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, për arrestimin dhe dëbimin e tyre. Agim Shahini, kryetar në Aleancën Kosovare të Biznesit, beson se këto zhvillime nuk do bien nën ndikim të "pazareve" politike. "Në aspektin politik, kjo nuk mund të ketë ndonjë ndikim, për shkak se bizneset tashmë, edhe të Kosovës, edhe të Turqisë, janë të vetëdijshme se këto janë lojëra politike, pazare dhe biznese politike për përfitimet e veta, qoftë politike apo personale të politikanëve të të dyja shteteve", thotë Shahini.

Ndër sektorët primarë që kanë tërhequr investimet nga Turqia hyn

edhe ai i aviaconit, pastaj ai i shëndetësisë, energjetikës, industrisë dhe sektori i ndërtimitarisë.

Numri i përgjithshëm i bizneseve turke të regjistruara në Kosovë, sipas Odës Tregtare Kosovare-Turke, është rreth 800, por vetëm 200 biznese thuhet se aktualisht janë aktive. Prania e kompanive turke në Kosovë ka nisur nga infrastruktura rrugore. Bechtel-Enka, konsorcium amerikano-turk, ka bërë ndërtimin e autostradës që lidh Kosovën me Shqipërinë, kurse tashmë është duke ndërtuar edhe autostradën Prishtinë – Shkup. Një konsorcium tjetër, ai turko-francez, Limak-Aeroport de Lyon, në vitin 2010 ka marrë me koncesion për njëzet vjet Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Në vitin 2012, konsorciumi turk Limak-Çalik privatizoi rrjetin kosovar të shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.

Që prej vitit 2004, në Kosovë vepron edhe Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim [TIKA]. Nga ajo periudhë, kjo organizatë ka realizuar qindra projekte të ndryshme, si dhe ka restauruar një numër të madh të xhamive, por edhe ka bërë investime në ndërtimin e xhamive të reja në gjithë Kosovën. Nga investimet turke në Kosovë, ndërkaq, funksionon edhe një numër i institucioneve arsimore.

Qytetarët e Kosovës, përveç bashkëpunimit tregtar, Turqinë e konsiderojnë si një vend atraktiv turistik, sidomos gjatë sezonit veror. Sipas të dhënave, edhe pse jo shumë të freskëta të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2016, mbi 6,500 qytetarë të Turqisë e kanë vizituar Kosovën.



Majko viziton Ankarën

Zëvendëskryeministri i Turqisë, Hakan Çavushoglu, ka pritur të martën në një takim ministrin e Diasporës të Shqipërisë, Pandeli Majko. Takimi vazhdoi i mbyllur për media pas marrjes së pamjeve dhe fotografive. Ndërkaq gjatë ditës së hënë, në Qendrën e Kulturës Shqiptare në Ankara, përfaqësuesit e komunitetit shqiptar në Turqi, i uruan mirëseardhjen Ministrit Majko. Të pranishëm në qendrën ku organizohen kurse e aktivitete të shumta kulturore, ishin përfaqësues të shoqatave shqiptare të tilla si, "Vatra" e "Çamëria", studentët e profesionistë që kishin mbërritur edhe nga qytete të tjera të Turqisë, si Stambolli dhe Izmiri.

Në Qendrën e Kulturës Shqiptare në Ankara, kurset për mësimin e gjuhës zhvillohen dy herë në javë. Struktura frekuentohet edhe nga studentët, të cilët kane krijuar Unionin e Studentëve Shqiptarë në Ankara. Të dhënat sugjerojnë se mbi 1000 studentë shqiptarë gjenden në Turqi, njofton koha.net.

Përfaqësuesit e komunitetit u shprehën të nderuar nga vizita e ministrit Majko, duke e cilësuar atë si pikënisjen e një bashkëpunimi të frytshëm me autoritetet shqiptare.

Ndërsa i falënderoi për miqpritjen e ngrohtë, Majko përgëzoi diasporën në Turqi për punën e bërë deri më tani, në mbrojtje të gjuhës dhe identitetit shqiptar. Ai i informoi të pranishmit mbi bashkëpunimin me qeverinë e Kosovës për ta trajtuar diasporën si një të tërë dhe marrëveshjet e arritura për arsimin dhe ngritjen e qendrave kulturore shqiptare nëpër botë. Ministri përmendi gjithashtu hapat e ndërmarrë deri më tani për krijimin e strukturave mbështetëse për diasporën, të tilla si Agjencia për Diasporën e Këshilli Koordinues, që do të ketë përfaqësues nga shtete të ndryshme. Majko u ndal edhe tek përpjekjet që po bëhen në bashkëpunim me autoritetet e Kosovës, për krijimin e rrjeteve të profesionistëve dhe nxitjen e bashkëpunimeve mes tyre. Në vizitën e zhvilluar në Qendrën e Kulturës Shqiptare në Ankara, Majko u shoqërua nga Ambasadorët e Shqipërisë dhe Kosovës në Turqi, Genti Gazheli dhe Avni Spahiu.



Të arrestuarit do të transferohen në Kukës

Policia e Tiranës dhe gjashtë komisarariatet e saj kanë kaluar në shërbim të përforcuar për shkak të protestave që vijojnë përballë drejtorisë së policisë së kryeqytetit, raportojnë mediat e Tiranës. Krahas komisariateve në gatishmëri të plotë kalojnë dhe forcat "Shqiponja". Që prej të dielës kur një pjesë e të arrestuarve të protestës në rrugën e Kombit u sollën në Tiranë, edhe në kryeqytet po zhvillohen protesta për lirin e tyre. Ndërkaq, mësohet se sot ata do të transportohen drejt Kukësit ku dhe do të njihen të mërkurën në orën 9.00 me masat e sigurisë. Mësohet se të arrestuarit do të shoqërohen nga Forcat Speciale Renea për të shmangur kështu incidente të mundshme.

PROJEKTET E RICIKLIMIT DHE ENERGJISË NË KOSOVË

Amerikanët të interesuar të investojnë

Përfaqësues të kompanisë Ekobase Global, u pritën në një takim nga zv. kryeministri/ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, të cilin e njoftuan me planet për projekte konkrete në fushën e riciklimit të gomave të vjetra dhe energjisë së ripërtrishme. Ekobase Global Inc. është kompani nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me degë në disa shtete të Bashkimit Evropian, raporton KosovaLive

"Ekobase Global Inc. është duke implementuar projekte të ngjashme edhe në Slloveni, Spanjë ndërsa kemi dëshirë që të përfshijnë edhe Kosovën në këtë iniciativë që është duke marrë përmasa globale", tha Tomaz Groff, drejtori i kompanisë për Evropë, duke shtuar se në Kosovë kanë ardhur për të shikuar edhe mundësi të tjera të investimit në fushën e energjisë së ripërtrishme.

Në anën tjetër, ministri Gashi, duke i falënderuar për vizitën, i informoi përfaqësuesit e kësaj kompanie lidhur me mundësitë të cilat ofrohen sipas Ligjit për Investimeve Strategjike.

"Ne momentalisht konsiderohemi si shteti



më liberal për sa i përket mundësive të cilat u ofrojmë investitorëve që potencialisht kualifikohen si investitorë strategjik në fushën e minierave, energjisë dhe turizmit. Deri tani kemi marrë aplikacionin e parë në fushën e energjisë solare nga një kompani shqiptare – gjermane, ndërsa presim së paku edhe 4 aplikacione në fushën e minierave", tha ministri Gashi.

Në fund u dakorduan që në vizitën e ardhshme në Kosovë të diskutohen edhe modalitetet konkrete të projektit në fjalë.

DIE WELT: "TURQIA DHE GREQIA DREJT NJË LUFTE SHKATËRRIMTARE!"

"Marrëdhëniet e vështira mes dy partnerëve të NATO-s kanë mbërritur në pikën më kritike që kur presidenti turk ka rinisur rindërtimin e Turqisë si në një shtetet autoritarin duke ushtruar një politikë të jashtme agresive dhe ekspansive", shkruan e përditshmja gjermane "Die Welt" në një raport të marrëdhënies me Athinës dhe Ankarasë.

Gazeta e madhe evropiane nënvizon faktin se nuk përfshihet as një konflikt ushtarak mes dy vendeve dhe përmend shtimin e provokimeve të Erdoganit me shkelje kufijsh dhe retorikë agresive ndaj fqinjit.

"Kjo strategji agresive e shkeljes sistematike të kufijve është shtuar shumë pas tentativës për grusht shteti në vitin 2016. Në të njëjtën kohë, forca ushtarake detare dhe ajrore turke në veçanti ka humbur shumë nga aftësitë e saj pas spastrimeve politike që nisën në vitin 2011 dhe oficerë jocompetentë kanë urdhëruar zbatimin e një politike të rrezikshme kon-



Si forcë ushtarake, dy ushtritë greke dhe turke kanë thajse me të njëjtin arsenal armësh. Të dyja së bashku ato kanë më shumë fuqi ushtarake se gjithë pjesa tjetër e Europës. Dy flotat ajrore kanë në total 450 avionë luftarakë dhe në një rast lufte, ky arsenal në kohë shumë të shkurtër shkakton shkatërrime fatale

fliktuale që mund t'i fundosë ata".

"Në të njëjtën kohë mund të kemi një ndërhyrje të fuqive të mëdha nëse situata përshkallëzohet ashtu si incidentit të vitit 1996 në ishullin e Imias, kur SHBA ndërhyri për të ndarë palët. Por nuk është e sigurt që administrata Trump do të veprojë njëloj".

Si forcë ushtarake, dy ushtritë

greke dhe turke kanë thajse me të njëjtin arsenal armësh. Të dyja së bashku ato kanë më shumë fuqi ushtarake se gjithë pjesa tjetër e Europës. 830 mjete të blinduara, 2500 mjete të tjera luftarake. Dy flotat ajrore kanë në total 450 avionë luftarakë dhe në një rast lufte, ky arsenal në kohë shumë të shkurtër, shkakton shkatërrime fatale", përfundon shkrimi i "Die Welt".



Cilat vende do të dominojnë ekonomikisht planetin në vitin 2050

Deri në vitin 2050, bota do të ketë ndryshuar në mënyrë drastike nga ajo që njohim tani, dhe peizazhi ekonomik dhe financiar i planetit nuk do të bëjë përjashtim. Një raport nga gjiganti i shërbimeve profesionale "PwC" tregon se cilat ekonomi në mbarë botën do të jenë më të fuqishmet pas 33 vitesh.

Raporti, i titulluar "Pamja e plotë: si do të ndryshojë rendi ekonomik global deri në vitin 2050?" renditi 32 vende nga prodhimi i tyre i brendshëm global bruto i parashikuar nga barazia e fuqisë blerëse.

Me përjashtim të Shteteve të Bashkuara, shumë prej ekonomive aktuale të fuqishme në botë si Japonia dhe Gjermania do të kenë rënë poshtë në renditjen globale, të zëvendësuar nga vende të tilla si India dhe Indonezia, të cilat aktualisht janë tregje në zhvillim.

RENDITJA MË POSHTË JU NJEH ME VENDET ME EKONOMITË MË TË FORTA TË BOTËS NË 2050 SIPAS "PWC":

1. Kina — 58.499 trilionë \$.
2. India — 44.128 trilionë\$.
3. SHBA — 34.102 trilionë\$.
4. Indonezia — 10.502 trilionë\$.
5. Brazili — 7.540 trilionë\$.
6. Rusia — 7.131 trilionë\$.
7. Meksika — 6.863 trilionë\$.
8. Japonia — 6.779 trilionë\$.
9. Gjermania — 6.138 trilionë\$.
10. Mb. e Bashkuar — 5.369 trilionë\$.
11. Turqia — 5.184 trilionë\$.
12. Franca — 4.705 trilionë\$.
13. Arabia Saudite — 4.694 trilionë\$.
14. Nigeria — 4.348 trilionë\$.
15. Egjipti — 4.333 trilionë\$.
16. Pakistani — 4.236 trilionë\$.
17. Irani — 3.900 trilionë\$.
18. Korea e Jugut — 3.539 trilionë\$.
19. Filipinet — 3.334 trilionë\$.
20. Vietnamit — 3.176 trilionë\$.
21. Itali — 3.115 trilionë\$.
22. Kanada — 3.1 trilionë\$.
23. Bangladeshi — 3.064 trilionë\$.
24. Malajzia — 2.815 trilionë\$.
25. Tailanda — 2.782 trilionë\$.
26. Spanja — 2.732 trilionë\$.
27. Afrika e Jugut — 2.570 trilionë\$.
28. Australia — 2.564 trilionë\$.
29. Argjentina — 2.365 trilionë\$.
30. Poloni — 2.103 trilionë\$.
31. Kolumbia — 2.074 trilionë\$.
32. Holanda — 1.496 trilionë\$.

Shtetet baltike kërkojnë më shumë mbrojtje nga Trumpi

Presidentët e tre shteteve të Baltikut priten të kërkojnë nga presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, të bëjë më shumë për të penguar kërcënimin rus kundër tyre.

Presidentja e Lituaniës, Dalia Grybauskaitė, presidenti i Estonisë, Kersti Kaljulaid, dhe presidenti i Letonisë, Raimonds Vejonis, do të takojnë sot Trumpin në Shtëpinë e Bardhë. Ata janë në mesin e kritikëve më të fuqishëm të Rusisë në Bashkimin Evropian dhe po vizitojnë Trump-in në kohën e sinjaleve të përziera për qëllimet e tij ndaj Kremlinit. Derisa Uashingtoni ka ndërmarë sanksione të reja kundër individëve rusë, kompanive dhe agjencive ruse të inteligjencës, si dhe ka dëbuar 60 diplomatë rusë në përgjigje të helmimit të dyshuar nga Moskë të një ish-agjenti rus në Britani, Trump personalisht ka sugjeruar se do të mbajë një takim me presidentin rus, Vladimir Putin.

Një zyrtar i lartë i Lituaniës i tha agjencisë AFP se tre udhëheqësit baltikë do të kërkojnë nga Trump të dërgojë më shpesh raketa me rreze të gjatë veprimi Patriot për lojëra luftarake në shtetet baltike.

Zyrtari lituanëz tha, po ashtu, se ata duan të bëhen pjesë e mburojës raketore të NATO-s në Evropë. "Shpresoj se Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tjerë do të kuptojnë se hapësira ajrore e shteteve baltike duhet të mbrohet më mirë", tha presidentja e Lituaniës, Grybauskaitė, për transmetuesin publik të vendit të saj LRT përpara vizitës në Uashington. Shtetet baltike, me një popullsi të kombinuar prej vetëm gjashtë milionë banorësh, janë pushtuar dhe aneksuar nga Moskë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Ato janë pavarësuar pas rënies së Bashkimit Sovjetik më 1991 dhe i janë bashkuar Bashkimit Evropian dhe NATO-s më 2004.



ISIS për Botërorin rus: "Do vrasim futbollistë dhe tifozë"

ISIS thuhet se planifikon të lëshojë bomba mbi lojtarët dhe tifozët në Kupën e Botës në Rusi duke përdorur dronët, shkruan "The Sun". Parlajmërimi është dhënë përmes videove dhe fotografive në aplikacionin "Telegram", ku janë dhënë edhe detaje për sulmet e mundshme. Për sulme ndaj lojtarëve dhe simpatizantëve do të përdoren dronët, në të cilët do të jenë të instaluar bomba. Ky paralajmërim i tmerrshëm vjen pasi shërbimet e sigurisë kanë pranuar se kampionati botëror i futbollit është kërcënim i mundshëm i ISIS-it. Sipas "The Sun" organizata terroriste ISIS po planifikon një sulm me bomba me dron ndaj tifozëve anglez. Ndërsa në një tjetër foto tregon një dron që mban një raketë anti-tank. Gjithsesi, vëmendja e autoriteteve do të jetë në maksimum për të shmangur çdo incident të padëshiruar.


FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË
SH P A L L J E

PASQYRË E AKSIONEVE NË PRONË TË FONDIT QË DO TË OFROHEN PËR SHITJE NË BURSËN E MAQEDONISË PËRMES ANKANDIT PUBLIK BURSAR NË TRE DITË RRESHT TË TREGËTIMIT, DUKE FILLUAR NGA 19.04.2018

SHITJA E AKSIONEVE PRIORITARE

Numër rend.	Shoqëria aksionare	Vendi	Numri i aksioneve për shitje	Vlera nominale e shoqërisë në EURO	Vlera nominale e kapitalit për shitje (EURO)	Pjesëmarrja e kapitalit për shitje në vlerën e shoqërisë në %	Çmimi fillestar shitës i një aksioni në EURO
1	SHA JAKA 80	Shkup	96,124	3,430,225	480,620	14.01%	1.025
2	SHA TOPOLA	Shkup	116	42,728	506	1.18%	0.04
3	AGD GRADBA PRILEP	Prilep	14	136,771	3,579	2.62%	2.00
4	POLET SHA	Shkup	6,442	219,579	32,937	15.00%	0.04
5	MAKEDONSKA KNIGA SHA	Shkup	1,373	611,454	70,200	11.48%	0.40
6	ZUS SHA	Shkup	17,488	2,822,740	357,659	12.67%	0.16
7	MEBEL SHA SHTIP	Shtip	18,100	345,122	46,272	13.41%	0.02
8	SHA 29 NOEMVRI	Shkup	213	817,991	50,095	6.12%	24.39
9	FERMA E DERRAVE MAK MESO SHA	f.Tarinci	1,757	1,539,530	89,818	5.83%	0.40
10	ZHIVINO KOMERC SHA	Shtip	24,623	3,201,976	125,895	3.93%	0.04
11	ADONEKS SHA	Shkup	478	496,857	15,878	3.20%	0.26
12	SHA OTEKS	Ohër	14,320	15,423,731	451,916	2.93%	0.25
13	SHA PESHNA	Makedonski Brod	98	234,632	5,011	2.14%	0.40
14	METROPOLITEN SHA	Shkup	679	386,296	3,472	0.90%	0.04
15	SHA KARBO NOVA	Kriva Pallankë	5,029	2,634,985	257,133	9.76%	0.40
16	ARCELORMITTAL SHKUP (HRM) SHA	Shkup	1,197,373	61,011,862	6,118,576	10.03%	0.41

Aksionet do të ofrohen për shitje përmes Bursës së Maqedonisë në tre ditë rresht të tregëtimit duke filluar nga 19.04.2018. Shitja e aksioneve do të bëhet sipas modelit "në pjesë" nëpërmjet më shumë transaksioneve. Pajsa do të bëhet në para të gatshme dhe në denarë.

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË

www.piom.com.mk

Komisioni për grumbullimin e ofertave për realizimin e ekskursionit për nxënësit për nxënësit e vitit të tretë pranë Shkollës së mesme të Qytetit të Shkupit "Cvetan Dimov" Shkup publikon

SHPLLJE

Për grumbullimin e ofertave për organizim të ekskursionit për nxënësit

- OFERTUES:** Çdo subjekt juridik i regjistruar për kryerje të veprimtarisë në pajtim me lëndën e shpalljes
- LËNDA:** Organizim të ekskursionit përfundimtar për nxënësit e vitit të tretë në pajtim me Programin për ekskursione të shkollës për vitin shkollor 2017/2018.

3. EKSURSIONI PËR REALIZIM:
Ekskursion përfundimtar për nxënësit e vitit të tretë të cilët në vitin shkollor 2018/2019 do të jenë viti i katërt me kohëzgjatje prej 4 (katër) ditë, me 3 (tre) bujtje në Durrës, në bazë të pansionit të plotë (mëngjes, drekë dhe darkë) në relacionin Shkup-Durrës-Berat-Fier-Vlorë-Tiranë-Krujë-Prizren- Shkup me realizim në muajin maj 2018.

4. KRITERET MINIMALE DHE DËSHMITË PËR VËRTETIM TË AFTËSIVE TË SUBJEKTEVE JURIDIKE
Kriteri nr. 1 Subjekti juridik të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në republikën e Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike

Dëshmi për kriterin nr. 1 Licencë valide (A) për kryerje të veprimtarisë turistike në emër të ofertuesit dhe Dokument për veprimtaritë të regjistruar (jo më të vjetër se gjashtë muaj) dokumentet të jenë të vërtetuar me vull dhe nënshkrim të ofertuesit dhe të shkruajë (të besueshme me originalin).

Kriteri nr. 2 Subjekti juridik të ketë të realizuar në mënyrë të suksesshme së paku 3 (tre) ekskursione për nxënësit dhe aktivitetet tjera të lira gjatë 3 (tre) viteve të fundit

Dëshmi për kriterin nr. 2 Vërtetime të dhëna nga shkollat për realizim të suksesshëm të së paku 3 (tre) ekskursione për nxënësit ose aktivitetet tjera të lira gjatë 3 (tre) viteve të fundit.

Kriteri nr. 3 Subjekti juridik të plotësojë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike me të cilat transportohen grupet e fëmijëve.

Dëshmi për kriterin nr. 3 Deklaratë në formë origjinale nën përgjegjësi të plotë penale dhe materiale se subjekti juridik i cili do të paraqitet si ofertues ka mundësinë të sigurojë shërbim për transport në pajtim me kushtet për transport të grupeve të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve, gjatë së cilave makinat me të cilat realizohet udhëtimi i fëmijëve të mos jenë më të vjetër se 10 vjet gjegjësisht jo më të vjetër se të vitit 2008 dhe Deklaratë në original se nën përgjegjësi të plotë penale dhe materiale se në rast të zgjedhjes si ofertues më të volitshëm do të sigurojë dëshmi për rregullshmeri teknike të makinës në pajtim me ligjet valide ekzistuese në Republikën e Maqedonisë dhe procesverbal për kontroll të realizuar të jashtëzakonshëm teknik të autobusëve jo më të vjetër se 1 muaj si dhe për vozitësit e autobusëve do të sigurojë vërtetime të mjekut jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj. Gjithashtu duhet të dorëzohet edhe Marrëveshje për angazhim të transportuesve me të cilët do të realizohet ekskursioni me shjocë të lejeve për qarkullim për minimum pesë (5) autobusë në fotokopje me vërtetim me vull dhe nënshkrim të ofertuesit dhe të shkruajë "E besueshme me originalin".

5. TË DHËNA DHE DËSHMI PËR KËRKESAT TEKNIKE DHE FINANCIARE:
Ofertuesi në dorëzimin e ofertës së tij dhe formimin e çmimit të tij duhet të sigurojë:

- akomodim në hotel me minimum 4***
- transportim me autobusë të lartë turistik
- ushqim në gjysmë-pansion (mëngjes dhe darkë) në Durrës
- sigurim rrugor dhe shëndetësor të nxënësit pa franshizë
- organizim të udhëtimit me guidë
- organizim të udhëtimit me person mjekësor – doktor
- përfshirje të shpenzimeve për vizita në pajtim me Programin
- mënyra e pagesës në kesh ose maksimum 3 (tre) këste
- aranzhmane falas për çdo 15 nxënësit një falas

Ofertuesin duhet të shprehë çmimin individual (akomodim, transport dhe ushqim) dhe çmimin e përgjithshëm për nxënësit me TVSH të përfshirë. Ofertuesi çmimin e tij të ofertës duhet ta formojë vetëm në pajtim me kërkesat e programit për realizim të ekskursionit. Të gjithë ofertuesit të cilët do të ofrojnë shërbime të ndryshme do të jenë të përjashtuar nga procedura për zgjedhje për shkak të qasjes së ndryshme në përplimin e ofertës së tyre dhe mos krahasimit me ofertat e tjera.

6. Garancia bankare për realizim kualitativ të ekskursionit është 5% nga vlera e përgjithshme e marrëveshjes. Garancinë bankare ofertuesi i zgjedhur e dorëzon në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes.

7. KRITERET PËR ZGJEDHJE TË OFERTËS MË TË VOLITSHME ËSHTË: ÇMIMI MË I ULËT

Për ofertues më të volitshëm do të zgjidhet ai ofertuesi i cili do të ofrojë çmimin më të ulët ndërsa pastaj do të plotësojë kriteret minimale për aftësi dhe do të ketë ofertë të pranueshme teknike dhe financiare.

8. AFATI PËR DORËZIMIN E OFERTAVE: 5 (pesë) ditë pune duke mos llogaritur ditën e publikimit të shpalljes.

Programi për realizimin e ekskursionit për nxënësit pajtëtar duhet të merret në ditët derisa zgjatë shpallja në periudhë prej ora 9 deri në ora 14 nga ndihmës drejtori i SHMQSH Cvetan Dimov në rr. Xhon Kenedi nr. 16.

Marrja e Programit për realizim të ekskursionit është kusht për pjesëmarrje në procedurën për grumbullimin e ofertave.

9. MËNYRA DHE VENDI I PARASHTRIMIT TË OFERTAVE:

Ofertat së bashku me dokumentet e nevojshme në zarf të mbyllur me shenjë të vetme: Deri tek komisioni për grumbullimin e ofertave për realizim të ekskursionit për nxënësit të vitit të tretë pranë SHMQSH Cvetan Dimov – Shkup dorëzohen në arkivin e SHMQSH Cvetan Dimov – Shkup me seli në rr. Xhon Kenedi nr. 16, Shkup ose përmes postës së dërgesë e posaçme ose përmes postës së shpejtë.

Çdo ofertë e aritur pas afatit përfundimtar do të llogaritet si e vonuar dhe nuk do të jetë lëndë shqyrtimi.

Hapja dhe vlerësimi i ofertave nuk do të jetë publike, gjegjësisht do të bëhet pa praninë e ofertuesve dhe do të realizohet në lokalet e Shkollës së Mesme të Qytetit të Shkupit "Cvetan Dimov" – Shkup

Ekskursioni do të realizohet vetëm nëse ka numër të mjaftueshëm të nxënësit.

Komisioni për grumbullimin e ofertave për realizim të ekskursioneve për nxënësit pranë SHMQSH "Cvetan Dimov" – Shkup



QYTETI I SHKUPIT
KRYETARI I QYTETIT

Bul. Ilinden nr.82
1000 Shkup
www.skopje.gov.mk.

tel: 02/3 297 204

Numri ynë: 08-
_____.2018
Shkup

Në bazë të nenit 50, paragrafi 1, pika 9, të Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e RM nr. 05/02), dhe në lidhje me nenin 29 paragrafi 3 të Ligjit për kulturë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 31/1998; 49/2003; 82/2005; 24/2007; 116/2010; 47/2011; 51/2011; 136/2012; 23/2013; 187/2013; 44/2014; 61/2015; 154/2015, 39/2016 dhe 11/2018) dhe nenit 30 të Statutit të Institucionit publik Qendra e kongreseve "Aleksandri i Maqedonisë" – Shkup, Kryetari i Qytetit të Shkupit publikon

SHPLLJE PUBLIKE

për zgjedhjen e drejtorit të Institucionit publik

Qendra e kongreseve "Aleksandri i Maqedonisë" – Shkup

1. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

-të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;

-në momentin e zgjedhjes me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar dënim ose kundërvajtje, ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës;

-të ketë fituar më së paku 240 kredi sipas EKTS ose të ketë përfunduar shkallën VII/1të arsimit të lartë të përcaktuar me statutin e institucionit;

-ka minimum pesë vjet stazh pune në fushën e kulturës ose pesë vjet eksperiencë pune në punë ose projekte në fushën e kulturës në kontratave për punë;

-ka një nga certifikatat e mëposhtme të njohura ndërkombëtarisht ose vërtetime për njohjen aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

-TOEFEL IBT – më së paku 74 pikë,

-IELTS (IELTS) – më së paku 6 pikë,

-ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - më së paku nivel B2 (B2),

-FCE (FCE) (Cambridge English: First) – të përfunduar

-BULATS (BULATS) - më së paku 60 pikë ose

-APTIS (APTIS) - më së paku nivel B2 (B2)

2. Kandidatët janë të obliguar përveç dëshmitë për plotësimin e kushteve të lartpërmendura të deponojnë edhe dokumentet e mëposhtme:

-Fletëparaqitje me biografi të shkurtër

-Dëshmi për stazh pune

-Propozim-Program për punën dhe zhvillimin e institucionit

3. Dokumentacionin e nevojshëm kandidatët janë të obliguar ta deponojnë në original ose kopje të vërtetuar te noteri.

4. Afati për deponimin e dokumentacionit të nevojshëm është 10 ditë pune, nga dita e publikimit të Shpalljes publike në shtypin e ditës.

5. Dokumentacioni i dorëzuar me vonesë, i paplotë dhe i parregullt nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit. Fletëparaqitjet e Shpalljen publike deponohen në adresën e mëposhtme:

Institucioni publik Qendra e kongreseve "Aleksandri i Maqedonisë" – Shkup

- Këshilli drejtues

(për konkurs)

Adresa e institucionit: bul. „Partizanski odredi“ nr. 45

1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

Kryetari i Qytetit të Shkupit

Petre Shilegov


**REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E BOGOVINËS**

nr. 11-2395/12
03.04.2018

Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16), dhe Vendimit nr. 11-2395/11 nga 02.04.2018, Kryetari komunës së Bogovinës lëshon këtë:

KOMUNIKATË

Për organizimin e prezantimit publik dhe anketës publike për propozim planin për PUJVB në PK nr. 249, 250/1, 250/2, 251/1, 252, 253, 254, 254, 255, 256 DHE 257, KK Kamjan jashtë r.n. KOMUNA E BOGOVINËS

-Njoftohen qytetarët dhe personat juridik të komunës së Bogovinës që Kryetari i komunës së Bogovinës ka sjell Vendim për organizimin e prezantimit publik dhe anketës publike për propozim PUJVB në PK nr. 249, 250/1, 250/2, 251/1, 252, 253, 254, 254, 255, 256 DHE 257, KK Kamjan jashtë r.n. KOMUNA E BOGOVINËS me nr. Teknik 9-1/16 të përpunuar nga URBANPLAN SHPK –Tetovë me sip. 2.47 ha.

-Anketa publike dhe prezantimi publik për propozim PUJVB në PK nr. 249, 250/1, 250/2, 251/1, 252, 253, 254, 254, 255, 256 DHE 257, KK Kamjan jashtë r.n. KOMUNA E BOGOVINËS, do të realizohet me komunikatë në sistemin informativ e-urbanizëm dhe në dy gazeta ditore dhe me paraqitje të propozim planit në hapësirat e Komunës së Bogovinës.

-Anketa publike do të zgjasë 9 ditë pune dhe atë prej 10.04.2018 deri në 20.04.2018

-Prezantimi publik me prezantim profesional të planit do të mbahet në datë 16.04.2018 në ora 12:00 në hapësirat e Komunës së Bogovinës.


-Në afatin e përmendur personat e interesuar fizik dhe juridik nga territori i përfshirë me projektin arkitektonik urbanistik mund të dorëzojnë vërejtje, propozime dhe mendime në fletën anketuese në formë elektronike përmes sistemit informativ e-urbanizëm ose në formë të shkruar.

KOMUNA E BOGOVINËS
Kryetari
Albon Xhemalli

“GENXHINE-I RAZ” (VISARE TË FSHEHTA)

Autor i vargjeve të mësipërme është Jahja bej Dukagjini, pasardhës i trungut të thellë të familjes së mirënjohur princërore shqiptare të Dukagjinëve të shek. XIV-XV. Ai hyri në korpusin e jeniçerëve, pastaj, duke kaluar të punojë në qendrën e vakufëve udhëheqës i pasurisë së tyre, që i shtrënguar të kënaqej me një timar të madh. Ai, siç pohon Sami Frashëri, “ishite njeri i shpatës (luftëtar) dhe i penës (shkrimtar)”, kishite marrë pjesë në disa fushata ushtarake nga vetë Sulltan Sulejman Kanuniu. Ishte krenar për prejardhjen e tij, dhe këtë krenari e pohoi me plot gojë, madje në një turqishte të bukur të Stambollit, në vjershën e tij “Genxhine-i Raz”. (“VISARE TË FSHEHTA”)

Jahja beu ishte me origjinë nga Principata e madhe e Dukagjinave. Në historinë turke njihet si: Dukagjin-Zade Jahja Bej, apo Tashlixhali Jahja. Është ndër personalitetet e pakta të kohës, i cili jo vetëm që nuk kishte mohuar origjinën e vetë, por me mburrje kishte shkruar për atë origjinë “spartane”, që ka jetuar dhe rron me shpatë, gjithnjë i kërcënuar, por gjithnjë e mbijetuar, nga shekulli në shekull. Ishte në mesin e dijetarëve dhe personaliteteve më të mëdha të kohës, si: Iskender Çelebiu, Ibrahim Pashë Parga, Kadri



*Raca shqiptare është raca ime,
Mbarë populli im mban shpatën pranë,
Ata trima si petrita nuk e kanë për gjë
Të ngrenë shtëpitë mes shkëmbinjve,
Kjo është dhunti e racës shqiptare,
Ata njerëz janë gurë të çmuar mes shkëmbinjsh.
Farefisi im rrjedh nga paria shqiptare
Sojin e kam prej princërve të Dukagjinit
Sado që u bëra rob i osmanëve
Nuk e fshef dot
Lumturinë time që gëzoj
Krenohem duke luftuar në fushëbeteja
Me flamur të kuq në dorë...*

Efendiu, Xhafer Çelebiu, pastaj shkrimtari më i madh i kohës, Lutfi pasha, po ashtu me origjinë shqiptar nga rrethi i Vlorës e shumë të tjerë. Ishte në mesin e dijetarëve dhe personaliteteve më të mëdha të kohës, si: Iskender Çelebiu, Ibrahim Pashë Parga, Kadri Efendiu, Xhafer Çelebiu, pastaj shkrimtari më i madh i kohës, Lutfi pasha, po ashtu me origjinë shqiptar nga rrethi i Vlorës e shumë të tjerë.

Jahja bej Dukagjini, pavarësi-


sht se ishte poet i oborrit mbretëror ai ishte edhe një burrë trim dhe shumë i mirëpritur edhe nga vetë Sulltan Sulejmani, e sidomos nga Ibrahim Pashë Pargaliu. Në anën tjetër ishte shoku më i ngushtë dhe më i dashur i djalit të Sulltanit, shehzade Mustafasë. Edhe ky si shumë e shumë shqiptarë të tjerë ishte rrëmbyer që në fëmijëri, me ligjin e Devshirmesë, që lejonte turqit të merrnin fëmijë të krishterë, qoftë edhe në mënyrë të dhunsh-

me, me qëllim për t'i arsimuar fetarisht dhe ushtarakisht dhe për t'i bërë pjesë të Perandorisë. Jahja beu ishte vëlla i Vezirit të njohur Ahmet Bej Dukagjini.

Është ndër të vetmit shqiptarë të mirënjohur të cilit iu kursye koka dhe jo vetëm sepse ishte shok i ngushtë dhe shoqëruar besnik i djalit të Sulltanit, por për faktin se ishte dijetar e mbi të gjitha poet, të cilët i çmonte shumë Sulltan Sulejmani.



Isak Guta, autori që ia kushtoi një jetë të tërë Aleksandër Moisiut



Para 139 vjetësh u lind aktori më i madh shqiptar me përmasa botërore, Aleksandër Moisiu, i cili nga shumë kritikë cilësohet si aktori më i madh i të gjitha kohërave në teatër. Max Brod një herë kishte shkruar se “Hamleti është shkruar për Moisiun dhe Moisiu ka lindur për ta interpretuar Hamletin”, pasi kishte parë performancën e Moisiut.

Por, jetën dhe veprën e kolosit shqiptar pak kush e njeh më mirë se shkrimtari Isak Guta. Guta që kishte kryer në Pragë për Teknologjinë e Filmit dhe Regjinë e Filmit, ka shkruar plotë shtatë libra për Moisiun. Detaje që pak, ose aspak njerëz i dinë mund t'i gjeni në librat e Gutës. Një nga këta libra është edhe “Moisiu dhe Bëma e Librit” që doli si libërth nga një punim më i madh i Gutës i titulluar “Emblema”. Promovimi i këtij libri u bë të premtën e kaluar në Ferizaj, ku morën pjesë profesorë, shkrimtarë e personalitet tjera të rëndësishme të artit shqiptar, njofton Klan Kosova.

Radio zvicerane promovon albumin e Elina Dunit

Këngëtarja dhe kompozitorja e njohur shqiptare, Elina Duni, po rikthehet me një album të ri muzikor. Albumi i saj i ri solo titullohet “Partir”, bën të ditur atsh. Radio Kombëtare Zvicerane ka përgatitur një event të veçantë transmetimi për promovimin e këngëtares me rastin e lancimit të këngëve të saj më të reja. Për këtë projekt ri të muzikantes shqiptare është kujdesur ga-

zetari i njohur zviceran Arnaud Robertin, për të cilin vetë Elina Duni ka shprehur mirënjohje.

Albumi “Partir”, ka këngë në gjuhën shqipe, melodi të cilat janë dhe duke u transmetuar në radio kombëtare të Zvicrës.

“Partir” do të dalë në treg nga 13 prilli në Zvicër, ndërsa në pjesën tjetër të Europës dhe SHBA-së nga 27 prilli.



SHQIPJA, PJESË E PROJEKTIT ARTISTIK ZVICËR-KOSOVË

Grupi i autorëve «Bern ist überall (Berna është kudo) po i thyen kufinj të dhe barrierat gjuhësore. Së fundi është bashkuar me poetë dhe muzicentë nga Kosova.

Grupi i poetëve dhe instrumentistëve zviceranë nga Berna «Bern ist überall» është “shndërruar” përkohësisht në «Kosovë is everywhere», pasi që në kuadër të një projekti i janë bashkuar edhe poetë instrumentistë nga Kosova. Pika fillestare e bashkëpunimit ka qenë shpërblimi për kulturë i Bashkisë së qytetit të Bernës 2015. Një pjesë të shpërblimit, grupi i autorëve i përbërë edhe nga Pedro Lenz dhe Guy Krneta, i ka investuar në

këtë projekt. Me dekada të tëra, marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Zvicrës janë përafuar, në ndërkohë që në Zvicër jetojnë një çerek milion banorë me prejardhje nga Kosova. Gjuha shqipe llogaritet pothuajse si gjuha e pestë zyrtare në Zvicër, shkruan “Der Bund”, përcjellë Albinfo.ch.

Në kryeqendër kosovare, në Prishtinë ishte huazuar një banesë dhe në pranverë të vitit të kaluar kanë filluar takimet dhe provat e para. Partner prodhuesi në Kosovë ka qenë Qendra-Multimedia, e cila menaxhohet nga dramaturgu, Jeton Neziraj. Në rolin e trajnerit të kombëtares, Jetoni ka bërë

përzgjedhjen e artistëve, në mesin e të cilëve emra prominentë të radios dhe teatrit. Vjeshtën e kaluar, ata shfaqën disa paraqitje të përbashkëta në qytetet të ndryshëm të Kosovës.

Tani, projekti është nëpër turne zvicerane në forma dhe përbërje të ndryshme; në muajin maj do të dalë në dritë një audio CD. «Paraqitjet tona në Kosovë kanë funksionuar shumë mirë», ka pohuar dramaturgu zviceran Gerhard Meister, “gjithkund kishim një auditorium të vëmendshëm”. Kontributet e dialekteve ishin secila me titull në shqip, me shfaqjet në Zvicër do të jetë anasjelltas. “Por, në skenë janë gjith-



sej katër gjuhë,” thotë Meister. «Përveç dialektit do të interpretohen edhe në shqip, anglisht dhe frëngjisht”. Gjatë paraqitjeve formohet një duet prej një muzicenti shqiptar dhe një zvicerani. “Kjo formë sjellë

momente magjepsë”, nënvizon Meister, duke theksuar se në këto eksperimente nuk ka pasur vështirësi. Humori i përbashkët ka mundësuar që të tejkalohen barrierat e projektit.

Janë të shumtë lojtarët shqiptarë që po shkëlqejnë në kampionatet e ndryshme dhe sidomos të rinjtë janë ata që tërheqin gjithmonë vëmendje të madhe, edhe për faktin se shihen si e ardhmja dhe sportdashësit janë më të sigurt kur shohin që ekipi i tyre është i mbushur me talente. Për këtë arsye, për ti ardhur në ndihmë trajnerit të kombëtares, në 2013 u hartua një listë me lojtarë, që në atë kohë konsideroheshin si e ardhmja e futbollit shqiptar. Disa kanë zhvilluar një karrierë të suksesshme, por disa janë zhdukur nga radarët e futbollit profesionist.

ELVIS KABASHI

Një ndër lojtarët më të përfolur, është Elvis Kabashi. I rritur në Itali, Kabashi në atë periudhë shfaqej si heroi i ardhshëm i kombëtares sonë. Performancat e mira dhe fakti që luante me Juventusin, bënë që të binte në sy. Në deklaratat e tij ai shprehej: "Kam lindur në Itali dhe kam filluar të luaj me ekipe të grupmoshave të zonave, më kërkonte trajneri i ekipit të moshave të Italisë, por nuk pranova, jam shqiptar, kam gjak kuqezi. Nuk luaj për lekë, dua të bëhem i famshëm. Shpresoj të arrij kombëtaren e madhe" Një deklaratë tepër e zjarrtë nga ana lojtarit, por vetëm pak ditë pasi u grumbullua nga kombëtarja U-21, ai do ti dërgonte një letër FSHF-së ku i kërkonte të mos grumbullohej më, pasi ndihej Italian, duke sjellë zemërimin e tifozerisë kuqeze. Pasi u largua nga Juventus, karrierën e zhvilloi me ekipe që militonin në kategoritë e treta, dhe në Janar të këtij viti firmosi me Livornon.

FRANÇESKO TAHIRAJ

Në moshën 11-vjeçare, kur luante për CBS Milan, ish-lojtar i

DIKUR ISHIN E ARDHMJA, JA KU JANË SOT DISA NGA TALENTËT KUQEZI

Për këtë arsye, për ti ardhur në ndihmë trajnerit të kombëtares, në 2013 u hartua një listë me lojtarë, që në atë kohë konsideroheshin si e ardhmja e futbollit shqiptar. Disa kanë zhvilluar një karrierë të suksesshme, por disa janë zhdukur nga radarët e futbollit profesionist



Juventusit, Xhanluka Pesoto, pasi e vëzhgoi vendosi ta kontaktonte. Pasi kaloi provën, ai firmosi një kontratë me Juventusin.

Pasi u largua nga Juventus karrierën e vazhdoi tek Torino, Karpi dhe në vitin 2018 transferohet tek Aluminij, në kampionatin sloven. Ka zhvilluar edhe dy ndeshje me U-17.

BERSANT CELINA

Një tjetër lojtar që po shkëlqente në Angli ishte Bersant Celina. Në atë kohë aktivizohej tek Manchester Siti.

Lojtari kishte shprehur dëshirën për të qenë pjesë e kombëtares shqiptare, por në fund zgjodhi Kosovën. Aktualisht luan për Ipsviç, i huazuar nga Manchester Siti.

ALDO BREGASI

Aldo Bregasi aktivizohej në Greqi me ekipin e Panionios U-17, duke luajtur si mbrojtës qendror dhe në atë kohë premtonte shumë për të ardhmen. Ka qenë pjesë e kombëtares U-17 të Shqipërisë, ku në ndeshjen miqësore përballë Kosovës, ishte edhe kapiten i ekipit. Aktualisht është pa ekip.

BLENDI MEMAJ

Blendi Memaj në 2013 u transferua tek gjiganti turk Beshiktash. Futbollisti kosovar që shpresonte të ishte e ardhmja e klubit nga Stambolli, dështoi të tregonte aftësitë, dhe në 2015 u transferua tek Rabotnički në Maqedoni, por edhe aty nuk shkëlqeu dot. Që prej 2016 nuk ka asnjë informacion për këtë lojtar.

ERGYS KAÇE

Nuk kishte si të mungonte në këtë listë edhe Kaçe. Lojtari që u ra në sy gjatë një ndeshje me Paok ku shënoi një super-gol. Aftësitë e treguara bënë që të fillonte beteja se kujt do t'i përkiste talenti shqiptar helenëve apo vendlindjes. Pas shumë përpjekjesh nga federata jonë dhe insistimi nga tekniku De Biazi, korçari zgjodhi të përfaqësojë ngjyrat kuqeze. Ishte pjesë e atij brezi që përfaqësoi për herë të parë Shqipërinë në një kompeticion madhor. Pas disa problemeve në aspektin personal, aktualisht ka rigjetur formën tek Panatinaikos.

ADNAN JANUZAJ

Lojtari të cilit i janë bërë lutje, këngë dhe deklarata që të luante

me Kombëtaren kuqezi, duke krijuar kështu një rast unik. Ylli i Manchester Junajtedit në ato vite, duke u krahasuar me Giggs, kishte bërë të gjithë të çmendeshin pas tij. Titullar tek Manchester dhe autor i disa golave, u duk se do të ishte e ardhmja e futbollit botëror dhe shqiptar. Përpos lutjeve të tifozerisë vendosi të përfaqësojë Belgjikën. Aktualisht pasi zhgënjeu tek Manchester dhe Borussia, aktivizohet në Spanjë me Real Sociedad.

FREDERIK VESELI

I rritur tek Akademitë e Manchester Junajtedit dhe Siti, kosovari premtonte shumë. Kampion bote me U-17 të Zvicrës, por dëmtimet e shumta e penalizuan, ku për disa vite nuk u dëgjua më për të.

Duhej të vinte viti 2016, ku përfaqësoi Shqipërinë në Euro 2016, që Veseli të rikthehej në qendër të vëmendjes, duke u transferuar tek Empoli.

ISMAIL ZELI

Lindur në Kukës, por me një karrierë të zhvilluar në Angli, mediat angleze flisnin me superlativa për këtë lojtar në ato vite. Aftësitë e treguara tek ekipi i Vulverhemp-ton, bënë që shqiptari të grumbullohej edhe nga U-18 e Anglisë. Por pikërisht kur dukej se fati po i buzëqeshte, për Zelin fillon kalvar-i i transferimeve. Në 4 vjet ka ndryshuar 8 ekipe, dhe tani luan për Bury, ekip që militon në kategorinë e tretë.

Çurlinov nuk e fton Azemin, reagon trajneri Haruni



Naser Kshkupi is with Ardiyan Azemi. 14 hrs · 25. Talenti i KB Shkupit ARDIJAN AZEMI 80+ kg u la anesh nga seleksionuesi i Maqedonis per turneun nderkombetar te boksit EMIL ZHECHEV per Kadet qe do te mbahet ne Sofi Bulgari Arsyja esht nuk e njeh , po normal si do ta njeh kur nuk ka kundershitar ne Maqedoni krejt luftat Ardijani i ka jasht Maqedonis dhe gjitha i ka fitore

Shkup, 3 prill - Trajneri i përfaqësues së Maqedonisë në boks Petar Çurlinov ka bërë publike listën e boksierëve (kadet) të cilët do të marrin pjesë në turneun ndërkombëtar "Emil Zheçev". Trajneri Çurlinov, për këtë turne nuk ka ftuar boksierin e KB Shkupi, Ardiyan Azemi, i cili është kampion shtetëror në kategorinë e tij +80 kg. Me këtë rast ka reaguuar trajneri i KB Shkupi Naser Haruni. "Talenti i KB Shkupit Ardiyan Azemi 80+ kg. u la anesh nga seleksionuesi i Maqedonisë, për turneun ndërkombëtar të boksit 'Emil Zheçev' për Kadet që do të mbahet në Sofje Bullgari. Arsyja është nuk e njeh, po normal si do ta njeh kur nuk ka kundërshtar në Maqedoni, krejt luftërat Ardijani i ka jashtë Maqedonisë dhe gjitha i ka fitore", ka shkruar Haruni në profilin e tij në "Facebook". Ndryshe në ekipin përfaqësues të Maqedonisë, trajneri Çurlinov ka ftuar tre boksier—Eles Asanov (-52 kg. Bargalla), Gjoshe Gjoshev (-54 kg. Pink Panther) dhe Alpaj Demirov (-60 kg. Bargalla).



FC Shkupi rikthehet në Çair

Shkup, 3 prill - Skuadra e FC Shkupi që nga muaji nëntor ishte në pamundësi që të luajë në stadiumin e Çairit në Shkup, pasi që terreni ishte i suspenduar nga ana e FFM-s, shkak i mos plotësimit të kushteve. Por pas një pune intensive, dje Komisioni i për gara pranë Federatës Futbollistike të Maqedonisë, ka dhënë dritë jeshile se stadiumi i përbush kushtet dhe pikërisht ndeshjen e javës së 26-të, kundër Pelisterit, Shkupi do të luajë në terrenin e vet dhe publiku do të ketë mundësi që të kthehet në follenë e tyre. Në anën tjetër, kryesia e klubit ka vendosur që pikërisht në këtë ndeshje të ofrojë të gjithë

shikuesve që do të jenë të pranishëm në këtë ndeshje, me blerjen e ofrojë të gjithë shikuesve që do të jenë të pranishëm në këtë ndeshje, me blerjen e çdo bilete që do të kushtojë 100 denarë, të marrin nga një shall të skuadrës. Biletat do të shiten në ditën kur do të luhet dhe ndeshja FC Shkupi – KF Pelisteri (07.04.2018), me fillim në orën 16:00, ndeshje kjo që është e një rëndësie të madhe që skuadra të rikthehet te fitorja dhe pikët që mundësojnë garën për pozitë të lartë në tabelë.

DUKA FLET PËR ÇËSHTJET NË FSHF, SKËNDERBEUN DHE KOMBËTAREN

NUK KA ASGJË KAQ TË MADHE SA ËSHTË BËRË



Në një intervistë të dhënë për "Top Channel", kreu i FSHF-së, Armando Duka ka folur për çështjet më të nxehta të aktualitetit futbollistik në Shqipëri. Duka komentoi vendimin e Gjykatës së Tiranës kthyer pas dosjen e njohjes së Asamblesë së FSHF-së, duke thënë se kjo u bë me qëllim plotësimin e dokumentacionit, por që nuk ka asnjë rrezik të mëtejshëm. "Na kanë kërkuar disa dokumente shtesë, që ne po i bëjmë gati. Nuk ka asgjë kaq të madhe sa është bërë, e sigurisht nuk do të ketë asnjë ndryshim. UEFA dhe FIFA kanë pasur një vlerësim maksimal për këto zgjedhje, menjëherë pas përfundimit të tyre. Madje, edhe

bashkëpunimi i tyre vazhdon. Brenda këtij viti do të vijë në Tiranë edhe presidenti i FIFA-s, Xhanni Infantino për të parë projektet tona", u shpreh Duka. Ndryshe, kreu i Federatës Shqiptare të Futbollit foli edhe për situatën e krijuar te Skënderbeu, teksa pranoi për herë të parë se pezullimi i UEFA-s nuk do të shpëtojë me masa në kampionatin shqiptar, pasi sipas tij, FSHF-ja i ka dënuar njëherë korçarët. "Më vjen keq. Ky është një lajm i rëndë për klubin dhe vet futbollin vendas. Nëse këto janë të faktura, atëherë drejtësia të bëjë punën e saj, ndërkohë që nëse jo, klubi duhet të gjëjë rrugën për t'u mbrojtur. Ne e

kemi marrë njëherë vendimin për ta dënuar Skënderbeun. Vendimi i UEFA-s nuk na detyron neve që ta dënojmë sërish", shtoi më tej kreu i FSHF-së. Në përfundim të intervistës, Duka nuk lë pa prekur edhe problematikën e Kombëtares së Shqipërisë, ku mungojnë lojtarët dhe aktivizimi i tyre nëpër klube është minimal. "Më vjen keq, por ky është një moment shumë i vështirë për futbollin tonë. Unë mendoj se, më mirë të luajnë lojtarët që aktivizohen, edhe pse luajnë në kategori më të ulëta, sesa lojtarët që luajnë në kampionate të mëdha, por nuk aktivizohen", përfundoi Armando Duka, kreu i FSHF-së.

Publicitet

Në bazë të nenit 126 të Ligjit për arsim fillor dhe lajmërimin nga Kryetari i Komunës së Velesit 08-1490/5 Këshilli i shkollës së SHFKM "Stefan Gajdov" Veles publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të drejtorit të SHFKM "Stefan Gajdov" Veles

Kandidatët për drejtor të shkollës të përmbushin kushtet në pajtim me Ligjin për arsim fillor

Kandidatët për drejtor të shkollës është e nevojshme të parashtrorin dokumentet në vijim:

- fletëparaqitje
- diplomë për arsim të mbaruar
- vërtetim për përvojë të punës në institucion edukativo-arsimor
- certifikatë për provim të dhënë për drejtor
- certifikatë të shtetësisë

Shpallja publike zgjatë 7 ditë nga dita e publikimit të saj
Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrorin deri te Këshilli i shkollës personalisht ose përmes postës

Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtrorin pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit

Me kandidatët të cilët i përmbushin kushtet do të realizohet intervistë për çka kandidatët do të informohen enkas.

SHFKM "Stefan Gajdov" Veles

Në bazë të nenit 89-a,alineja 5 të Ligjit mbi arsimin e mesëm („Gazeta zyrtare e RM,, nr.44/95,24/96,34/96,35/97,82/99,29/02,40/03,42/03,67/04,55/05,113/05,35/06,30/07,81/08,92/08,33/10,116/10,116/10,156/10,18/11,51/11, 6/12,100/12,24/13,41/14,116/14,135/14,10/15, 98/15,145/15,30/16,127/16, 67/17,në pajtim me Vendimin e Kryetarit të Komunës së Strugës me nr.09-1468 nga data 22.03.2018,Vendimit të Këshillit të shkollës me nr. 02-202/2 nga data 02.04.2018,publikohet:

SHPALLJE PUBLIKE

Për zgjedhjen e Drejtorit të shkollës

Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj,kandidatët duhet t,i plotësojnë edhe kushtet për arsimtar,pedagog ose psikolog në arsimin e mesëm,të ketë kryer arsimin e lartë,pesë vjet përvojë pune në institucionin të verifikuar nga Ministria për Arsim dhe Shkencë dhe duhet të ketë dhënë provimin për drejtor,në momentin e zgjedhjes me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit,detyrës ose veprimtarisë,të ketë certifikatë përkatëse,jo më të vjetër se pesë vjet,për njohje të gjuhës angleze „TOEFEL IBT-së paku 30 pikë, IELTS-së paku 3 pikë, BULATS-së paku 20 pikë ose KET (Cambridge English)-të dhënë, APTIS-së paku niveli A2 dhe të ketë dhënë test psikologjik dhe test për integritet,,

Kandidatët e paraqitur me lutjen dhe biografinë e shkurtër,duhet ti dorëzojnë edhe këto dokumente:

- Diplomën për arsimin e lartë të kryer;
- Vërtetim për përvojën në punë në institucionet edukativo-arsimor të verifikuara nga Ministria e Arsimit dhe shkencës (së paku 5 vjet);
- Vërtetim për dhënien e provimit profesional (për personat të cilët janë të detyruar ta japin);
- Certifikatë për dhënien e provimit për drejtorë;
- Certifikatë e nënshtetësisë;
- Certifikatë përkatëse,jo më të vjetër se pesë vjet,për njohje të gjuhës angleze „TOEFEL IBT-së paku 30 pikë, IELTS-së paku 3 pikë, BULATS-së paku 20 pikë ose KET (Cambridge English)-të dhënë, APTIS-së paku niveli A2;
- Vërtetim për dhënien e testit psikologjik dhe testit për integritet;
- Vërtetim se në momentin e zgjedhjes me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit,detyrës ose veprimtarisë.

Shpallja do të jetë e hapur 8 ditë pune nga dita e publikimit.


Afati bërë të cilit do të bëhet zgjedhja është 45 ditë me ditën e publikimit-më së voni deri më 13.05.2018.

Dokumentet jokomplete dhe të dërguara pas afatit nuk do të shqyrtohen. Lutja me dokumentet përkatëse të dërgohen në adresën SHMK Gjinnazi „Dr.Ibrahim Temo,,Strugë,rruga „Brigada proletare,, nr. 49,ose ne arkivin e shkollës me shenjën „Për shpalljen për drejtor,,


Këshilli i shkollës SHMK Gjinnazi „Dr.Ibrahim Temo,,Strugë

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit ginekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221



REPUBLIKA E MAQEDONISË
UNIVERSITETI "SHËN KIRILI DHE METODI"- SHKUP
INSTITUTI EKONOMIK - SHKUP



Në bazë të nenit 131 dhe nenit 135 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016 dhe 127/16), nenit 34 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup – teksti i pastruar ("Lajmëtarit universitar" nr. 274/13) dhe nenit 41 paragrafi 1 alineja 8, nga Rregullorja për marrëdhëniet e brendshme dhe punën e Institutit ekonomik në Shkup në përbërje të Universitetit "Shën. Kiril dhe Metodi" Shkup (Lajmëtarit universitar nr. 130/2009 dhe 288/2014), drejtori i Institutit ekonomik publikon

KONKURS

Për zgjedhje të një mësimitdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor

1. Publikohet konkurs për zgjedhje të një mësimitdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor, edhe fushën shkencore shoqërore, fusha shkencat ekonomike, sfera ekonomia ndërkombëtare.
2. Kandidatët e paraqitur, krahas kushteve të përgjithshme, duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt arsimor-shkencor, bashkëpunëtorë dhe arsimor –profesionale dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën. Kiril dhe Metodi" Shkup dhe akteve të tjera të Universitetit të cilat kanë të bëjnë me zgjedhjen në titujt arsimor-shkencor.
3. Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit dhe biografi të shkurtë me të dhëna për punën e tyre shkencore profesionale. Dokumentacioni i nevojshëm dorëzohet në arkiv të Institutit ekonomik ose me postë në adresë "Prolet" nr. 1, 1000 Shkup.
4. PAGESA dhe orari i punës janë të përcaktuara në aktet e Institutit ekonomik.
5. Konkursi zgjat 8 ditë nga dita e publikimit.

Informata shtesë mund të merren në telefonin 5220-104 ose në lokalet e Institutit ekonomik.

UNIVERSITETI "SHËN. KIRIL DHE METODI"
INSTITUTI EKONOMIK
SHKUP

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 16/10),nenit 80, 82 dhe 84 të Ligjit për arsim fillor të RM (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17) dhe Pëlqimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me nr. 12-1043/1 të datës 29.01.2018 dhe Vendimit nga u.d Drejtori i SHF "Goce Dellçev" Manastir nr. 02-57/2 të datës 03.04.2018 publikon:

SHPALLJE

Për pranimit të punëtorit për kohë të pacaktuar:

1. Një mirëmbajtës të higjienës me orar të plotë të punës, pagesa 12.000,00 den.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidati duhet të ketë të mbaruar arsimin fillor.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit ndërsa zgjedhja do të realizohet më së voni në afat prej 20 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.

Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrorin në adresën e shkollës.

Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtrorin pas afatit nuk do të shqyrtohen.

SHF "Goce Dellçev" Manastir
Vienska nr. 13

I nr. 1823/2017

SHPALLJE PUBLIKE

(në bazë të nenit 48 paragrafi 2 i Ligjit për përbarim Gazeta Zyrtare nr. 72 e datës 12.04.2016)

Përbaruesi Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në bazë të kërkesës për realizim të përbarimit nga kreditori Univerzalna Investiciona Banka SHA Shkup nga Shkupi me seli në rr. Maksim Gorki nr. 6, bazuar në dokumentin përbarues ODU nr. 1747/13, ODU nr. 1748/13 të datës 15.11.2013 të Noter Sebaudin Dauti – Gostivar, kundër borxhlinjve 1. Xhezmi Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë 2. Gjuzazije Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, 3. Fatime Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë dhe borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai nga Gostivari me seli në rr. Nikolla Parapunov nr. 236, për realizim të përbarimit në vlerë prej 12.064.787,00 den., më datë 29.03.2018:

FTON
Borxhlinjtë Xhezmi Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, Gjuzazije Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, Fatime Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë dhe borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai nga Gostivari me seli në rr. Nikolla Parapunov nr. 236 për shkak të dorëzimit të Konkuzionit për shlyrje të përbarimit në bazë të nenit 91 paragrafi (1) të LP I. nr. 1823/2017 të datës 19.02.2018 të Përbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në mjetet e informimit.
PARALAJMËROHEN borxhlinjtë Xhezmi Emro, Gjuzazije Emro, Fatime Emro dhe borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai, se mënyra e kësaj dhe parashtrimit konsiderohet si e dorëzimit i rregullit dhe se pasojat negative që mund të dalin i bartë vet pala.
KJO PARAQET SHPALLJEN E TRETË.

Përbarues
Aleksandar Kuzmanovski

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar Po + Pr + 2 menjëherë në fillim të Industrisë së lehtë "Momin Potok" – Shkup, me sipërfaqe të përgjithshme prej 890 m2 së bashku me objektet ekzistuese prej 180 m2. Çmimi 178.000 euro. Numri i telefonit: 078 – 201 – 960

NGA LINDJA NË PERËNDIM, E GJITHË BOTA SYTË NGA DERBI I MILANOS

Pas shtyrjes, por edhe një sërë debatesh mbi caktimin e datës dhe kompensimin e tifozëve, më në fund derbi i Madoninës mes Milanit dhe Interit do të luhet të mërkurën në orën 18:30

Për Milanin vlen gjithçka. Pas humbjes me Juventusin ka rrëshqitur 8 pikë pas Interit. Kuqezinjtë u duhet të fitojnë për të mbajtur gjallë ëndrrën Çampions, një fitore do ta çonte Interin në podin e serisë A, në vendin e 3-të me një pikë më shumë se Roma. Siç ndryshojnë vendet ku shihet derbi ndryshon edhe momenti në të cilin vijjnë skuadrat. Një muaj më parë, kur duhej të luhej sipas programit fillestar, zikaltrit ishin kapluar nga një seri barazimesh dhe disfata në Xhenoa. Këtë herë vijnë pas 8 golash në dy ndeshje me Sampdorian dhe Veronën. Milani ka udhëtuar në drejtim të kundërt. Një muaj më parë derbi do të ishte ndeshja e 14-të pas 13 rezultateve pozitive, tani vjen pas eliminimit në "Europa League" dhe disfatës në Torino. Sytë nga derbi, 27 telekamera do të jenë në "San Siro" për të transmetuar gjithçka ndodh në "La Scalan" e futbollit italian.



Në derbin e shkuar për kampionat, vendoste Mauro Icardi, që shënoi 3 herë në portën e Donnarummës dhe i dha zikalterve fitoren 3-2. Por tani gjërat kanë ndryshuar, pasi Milanin e drejton Gattuso dhe skuadra pësoi të shtunën humbjen e parë pas më tepër se 3 muajsh. Gjithsesi, duke folur për "Milan Channel", portieri i ri i Milanit, Donnarumma thekson se është pikërisht kapiteni i Interit, ai që i ngjall më shumë frikë. "Të shohim si do shkojë, por Icardi është një sulmues i jashtëzakonshëm, nga më të fortët në botë. Shpresoj të shkojë mirë për mua", u shpreh Donnarumma, që më tej theksoi se kuqezinjtë synojnë fitoren, për të mbajtur gjallë shpresat për një vend në Çam-

pions. Në anën tjetër, mbrojtësi i Interit, Milan Skriniar i ka siguruar tifozët se do të japin maksimumin. "Ne gjithmonë shikojmë para, ky është edhe qëllimi ynë. Në derbi duhet të japim më të mirë, shpresoj në një fitore. Duhet të japim maksimumin për tifozët tonë, të cilët i falënderojmë për praninë e tyre", deklaroi për "Inter TV", Skriniar.

Ndërkohë, 45 transmetues televizivë do të çojnë derbin në 181 vende të botës. Plot 728 milionë njerëz do të jenë duke e parë nëpërmjet ekranit, përveç 75 mijë fatlumëve që do ta ndjekin spektaklin nga "San Siro". Bota do të lidhet nëpërmjet televizionit me derbin, por do të ketë edhe përfaqësinë e saj në stadium.

"StubHub", platforma botërore më e përdorur për shitjen e biletave online ka bërë të ditur se ka shitur 63 për qind të biletave për tifozë të huaj. Nga Veriu në Jug do ta shikojnë derbin, edhe pse interesi më i madh është në Lindje. Në Hong Kong do të sistemojë antenën Li Jonghong, presidenti i Milanit, ndërkohë që në Nankin, në Kinën Lindore, do ta ndjekë nga televizioni familja e Zhang Jidong, që ka në pronësi Interin. Derbi do të shihet edhe në Perëndim, nga Shtetet e Bashkuara e deri në Amerikën e Jugut, dhe për t'u kthyer në qendër do të transmetohet në Afrikë dhe në thuasje gjithë Evropën, në Shqipëri, natyrisht në "Supersport". Gjithë bota me sytë nga derbi.



NË ANGLIJANË TË SIGURT Allegri do të shkojë te Çellsit

Massimiliano Allegri të hënën ka "zhbllokuar" të ardhmen e tij, duke folur në këto kushte. "Në Itali, unë nuk shoh destinacione të tjera. Pas Juventusit, mendoj se do të shkoj jashtë vendit, ku do të trajnoj edhe 5-6 vite në rang klubi, përpara se të marr përsipër një ekip kombëtar", u shpreh Allegri. Natyrisht, gjuetia për Allegrin ka filluar. Sipas raportit të "The Sun", destinacioni i ardhshëm i trajnerit nga Livorno është zgjedhur dhe lidhet me emrin e Çellsit. Nuk është një mister se Allegri dëshiron të ketë një përvojë në Premier Ligë dhe stoli i "Blues" mund të jetë mundësia më e mirë. Gjithashtu, për shkak se, pas një viti të parë të madh, Antonio Conte nuk e ka ruajtur ritmin me Çellsin, italianin do të largohet në fund të sezonit. Disa ekepe janë në radhë, të gatshëm për ta mirëpritur atë si trajner (përfshirë ekipin kombëtar italian). Allegri në Angli është, gjithashtu, i lidhur me Arsenalin, i cili mund të ndahet nga Arsen Wenger. Destinacionet e tjera në Premier Ligë duken të pamundura, me stendat e dy klubet e Mançesterit dhe Liverpulit të kënaqur me Murinjon, Guardiolan dhe Klopp, respektivisht.

De Gea i ofrohet rinovimi me rritje page

David De Gea është shumë pranë rinovimit me Mançester Junajtedin. Sipas medias britanike, portieri spanjoll do të nënshkruajë kontratën e re me "Djajtë e Kuq" përpara fillimit të Botërorit të Rosisë. Mësohet se kjo kontratë do të shoqërohet edhe me rritje pagë në 350 mijë sterlina në javë për De Gean që do të bëhet futbollisti i dytë më i paguar te Mançester Junajted as Aleksis Sançez që paguhet me 505 mijë sterlina në javë. Gjithnjë sipas medias britanike, bisedimet mes drejtuesve të klubit anglez dhe portierit 27-vjeçar do të nisën gjatë këtij muaji dhe te Junajted janë të bindur se De Gea është gati të qëndrojë edhe për shumë kohë në "Old Trafford", pavarësisht zërave spekulativë për kalimin te Reali i Madridit që po e rrethojnë prej kohësh. Media britanike thekson



se De Gea ndihet mirë tek skuadra e Mançester Junajted pavarësisht sezonit zhgënjës të kësaj skuadre në Premier Ligë. Kontrata aktuale e tij skadon verën e ardhshme por Mançester Junajted ka opsion zgjatjen e saj edhe për një vit tjetër. Por klubi anglez nuk dëshi-

ron të privohet prej tij në asnjë moment dhe për këtë arsye po punon që të mbledhë sa më shumë të ardhura që t'i sigurojë spanjollit rritjen e pagës. aktualisht De Gea që konsiderohet si portieri më i mirë në botë, përfiton një pagë prej 210 mijë sterlina në javë.

Milani dëshiron Vidalin dhe Depajn

Milani është duke shprehur interesim për shërbimet e mesfushorit të Bajern Munihut, Arturo Vidal dhe sulmuesit të Lionit, Memfis Depaj. Por, kjo do të varet nga "Fair-Play" financiar. Kuqezinjtë iu është refuzuar një marrëveshje vullnetare nga UEFA, kështu që mund t'iu ngarkohen sanksione të mundshme në edicionin e ardhshëm. Si pasojë e kësaj, drejtorët e klubit janë vënë pas futbollistëve me parametra zero si Pep Reina, Ivan Striniç apo edhe Ki Sung-Jeung. Së fundmi gazeta italiane "Tuttosport" raporton se Milani planifikon të nënshkruajë edhe me dy emra të mëdha si Depaj dhe Vidal. Repreruesi kilian, i cili është objektivi i parë i gjigandit italian, besohet që do t'i kërkojë largimin drejtuesve të



Bajern Munihut, ndërsa ka kontratë me bavarezët deri në vitin 2019. Ndërkohë, objektivi i dytë, Depaj së fundmi ka dhënë sinjale për një transferim të mundshëm në Milano. Holandezi ka deklaruar se Milani është një klub i madh, me një skuadër dhe histori të madhe.

LIGA E KAMPIONËVE - ÇEREKFINALE

LIVERPUL - MANÇESTER SITI,

BETEJA BRITANIKE NË ÇAMPIONS LIGË



DYSHET:
BARCELONA - ROMA
LIVERPUL - MANÇESTER S.

Pas ndeshjeve të para çerekfinale që u zhvilluan të martën, sonte (e mërkurë) do të luhen dy përballjet tjera çerekfinale. Që të dyja janë derbi, por vëmendja përqendrohet tek përballja mes dy ekipeve angleze Liverpool dhe Mançester Siti, derisa në "Camp Nou" Barcelona do të sfidohet nga skuadra italiane Roma

Liverpuli është skuadra e vetme në Premier Ligë që ka mposhtur Mançester Siten kur në janar në "Anfield" arriti fitore me 4-3, mirëpo në fazën e parë në "Etihad" të kuqtë u shpartalluan me 5-0. Objektivi i të dyja skuadrave është plasmani në gjysmëfinale, por edhe të fitojnë trofeun e Çampions Ligës, derisa futbollistët e të dyja skuadrave janë të vetëdijshëm për kualitetet që i kanë dhe paralajmërojnë fitore. Mbrojtësi i Liverpoolit, Virgil van Dijk është i vetëdijshëm për kualitetet e skuadrës kundërshtarë, por ai beson se me një përqendrim dhe përgatitje maksimale mund të ketë rezultat pozitiv. "Të gjithë e dinin se kushdo që do na binte do të ishte e vështirë. Siti janë një skuadër shumë e mirë dhe e vështirë për të luajtur kundër tyre. Duhet të jemi 100 për qind ose edhe më mirë për t'i mundur ata në dy ndeshje", tha Vank Dijk për ueb faqen zyrtare të klubit. Derisa, mesfushori i Mançester Sinit, Ilkaj Gundogan, thotë se objektivi është që ta fitojnë gjithë Ligën e Kampionëve. Gjermani be-

son te kualitetet e Sinit dhe me formën e mirë që po kalojnë ka pritshmëri të mëdha. "Duhet të luash ndaj më të mirëve për të shkuar në finale dhe natyrisht, ta fitoni. Isha mjaft më fat që të luaja në finalen e Ligës së Kampionëve të 2013 me Borussia Dortmundin, fatkeqësisht kemi humbur (nga Bayern Munihi), pra natyrisht që mezi po pres të shkoj në finale dhe ta fitoj këtë herë. Ky është qëllimi im kryesor. Fatmirësisht kemi fituar 'EFL Cup' dhe jemi të lumtur, kemi arritur trofeun e parë sezonal mjaft herë këtë sezon. Tani është në duart tona dhe askush nuk mund të në marrë. Për ne kjo është vetëm fillimi. Jemi në formë të mirë të përballimi me klubet elitare në Evropë", u shpreh Gundogan. Në përballjen tjetër, Roma do të përballlet me atë Barcelonën në "Camp Nou" dhe "Giallorossët" do të tentojnë të bëjnë gjithçka për të ndalur një nga lojtarët më të mirë në botë. Ndryshe, mbrojtësi i Romës, Kostas Manolas, thotë se "nuk ka mënyrë për ta ndalur" yllin e Barcelonës Lionel

Jurgen Klop

Do të ketë zjarr dhe po të kisha zgjedhjen për të parë një ndeshje në 'Champions League', do të ishte kjo. A na kishte shkuar në mendje përpara ndeshjes së parë se do të humbisnim 5-0? Jo. A na shkoi në mendje se do të fitonim 4-3 në ndeshjen e dytë? Jo. A e dimë që kemi një favoritët. Ka momente që jemi në një nivel. Por ata kanë qenë më të qëndrueshëm, prandaj janë në majë. Nuk e kam problem ta respektoj këtë gjë

Messi. "Guardiola e kishte mirë kur ka thënë se nuk ka mënyrë për ta ndalur atë. Edhe nëse disa e bllokoi, atje janë dhjetë tjerë që mund të të lëndojnë. Natyrisht Barcelona është diçka tjetër pa argjentinasi, por ne duhet të bëjmë më të mirën. E respektojme Barcelonën, por jemi të vetëdijshëm për forcën tonë. E kemi treguar në fazën e grupeve se jemi skuadër e mirë, tani kemi ndeshje të dyfishtë kokë me kokë ndaj një kundërshtari të fortë. Ata janë favorit, por kur luan 11 kundër 11 kurrë nuk i dihet", deklaroi Manolas. Derisa, Edin Xheko beson se Roma do të jetë një kundërshtar i denjë për Barcelonën. "Barcelona është favorite jo vetëm për çerekfinalen, por për të fituar trofeun këtë sezon. Por nëse luajmë si ekip mund të shkaktojmë dëme. Nuk dua të duket si klishe por kualifikimi varet nga e gjithë skuadra dhe jo nga një lojtar i vetëm", tha sulmuesi boshnjak.



El Hadary kërkon të bëjë histori në Kupën e Botës

Portieri i Egjiptit, Essam el-Hadary, që në moshën 45-vjeçare do të bëhet më i vjetri që ka luajtur në Kupën e Botës në futboll, thotë se shpreson që stória e tij të inspirojë të tjerët që të ndjekin ëndrrat e veta. El-Hadary është i vendosur që të jetë në skuadrën e Egjiptit për Botërorin 2018 në Rusi, ku shpreson të bëjë debutimin e vet në Kupën e Botës. "Unë jam shumë i lumtur që të luaj në Kupën e Botës dhe ky është mesazhi për të gjithë futbollistët dhe të tjerët nëpër botë, që duhet të besoni në ëndrrat tuaja dhe të luftoni për t'i realizuar ato", thotë El-Hadary. "Unë jam 45-vjeçar, por për mua ky është vetëm numër në letër. Unë stërvitem fort çdo ditë, nuk e di se çfarë do të thotë fjala e pamundur. Do të luftoj deri te Kupa e Botës për të pasur mundësinë që të luaj dhe të mbroj ngjyrat e vendit tim", deklaroi el-Hadary. Kujtojmë, Faryd Mondragon i Kolumbisë u bë më i vjetri që luajti në Kupën e Botës, kur u paraqit në ndeshje kundër Japonisë në Botërorin 2014 në Brazil në moshën 43 vjet e tri ditë.

Presidenti i Olimpiakosit "shkarkon" të gjithë skuadrën

"Unë dhe tifozët kemi duruar shumë, pushimet tuaja fillojnë sot", këto janë fjalët me të cilat u është drejtuar futbollistëve presidenti i Olimpiakosit në kampionatin grek, Evangelos Marinakis, i cili ka mbetur tepër i zhgënjyer nga rezultatet e fundit, madje ka vendosur ta gjobitë skuadrën me 400 mijë euro. Për pjesën e mbetur të sezonit ka vendosur të hedhë në fushë ekipin e të rinjve. Barazimi i së dielës kundër Levadiakosit ish-

te pika që derdhi gotën. Kur kanë mbetur edhe katër ndeshje nga fundi, bardhekuqtë klasifikohen në vendin e tretë, me 6 pikë më pak se kryesuesit e AEK-ut dhe një më pak se PAOK-u. "Do ta ndërtoj Olimpiakosin nga e para dhe do ta bëj skuadrën që ne ëndërrojmë. Ju interesojnë vetëm paratë dhe makinat e shtrenjta, jo interesat e klubit. Ju paguaj milionat, sepse i keni cilësitë, por për shkakun tuaj kam larguar tre trajnerë. Faji në

këtë rast është vetëm juaji", deklaroi Marinakis. Marinakis, që është pronar edhe i Nottingham Forest në Angli, sqaroi se nga 400 mijë euro gjobë, 200 janë për barazimin me Panatinaikosin, ndërsa 200 mijë të tjera për barazimin e fundit 1-1 kundër Levadiakosit. Sipas tij, kjo shumë do të investohet të futbollistët e U-20, që do së bashku me disa lojtarë që u kanë shpëtuar kritikave, do të mbyllin sezonin.





DASHI 21. mars - 20. prill

Dita nis mirë, planetët e dashurisë duan të lënë shenjë e tyre dhe t'ju mbushin me emocione. Mbrëmje magjike për çiftet. Ndikimet pozitive yjore shpalsin lajme të habitshme edhe për beqarët, po vijjnë takime dhe histori të reja premtuese. Ju keni çdo mundësi për të filluar një karrierë profesionale. Yjet ju mbështesin.



DEMI 21. prill - 21. maj

Pasiguritë në fushën e dashurisë janë shpesh rezultat i imagjinatës suaj dhe ndoshta partneri/ja nuk ka faj. Beqarët do të jenë në gjendje të ndër marrin iniciativën për një njohje të re me një person. Puna është shumë e ngarkuar dhe do t'ju duhet të shkarkoni tensionet të grumbulluara. Merrni një pushim.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Nëse jeni çift dhe keni një situatë të jashtëzakonshme që duhet të ndërmerrni një hap të rëndësishëm që nuk mund të bëni për shkak të pasigurisë, do të keni një ditë të favorshme për paqe. Kush është i vetmuar nuk do të mendohet gjatë për takime, të cilat do jenë interesante dhe të papritura. Situata në punë paraqitet e qetë, nuk ka lajme të mrekullueshme, por një rutinë që nuk ju intereson.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Reja në sektorin privat, sot dashuria ju rezervon disa surpriza të bukura dhe më në fund do të kurorëzoni një ëndërr që keni dëshiruar gjatë. Projektet e dasmës ose një fëmijë janë në vendin e parë! Hëna favorizon beqarët që duan të ndryshojnë status, mos humbisni marrëveshjet e mira. Në punë ju do të keni për të industrializuar veten nëse doni të arrini një buxhet të mirë.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Së fundi një panoramë mjaft e favorshme astrale: sot do të jetë një ditë e veçantë, marrëveshja me të dashurin/en do të jetë në krye dhe do të ndiheni në qiellin e shtatë! Për beqarët, janë parashikuar shumë takime interesante të cilat synojnë ndryshimin e së ardhmes. Sot ju do të ndiheni të ngarkuar, do të vini në punë të gjithë forcën tuaj.



VIRJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Nga sot një valë e re pasioni do të investojë te ju dhe do të jeni në gjendje të tërhiqni me vete edhe partnerin/en tuaj. Kur doni ju me të vërtetë, mund të bëni gjithçka! Zemrat e vetmuara do të synojnë tërheqjen e vëmendjes së dikujt që kohët e fundit ka ngjallur kuriozitetin e tyre. Është ende herët për vendime të rëndësishme në biznes, merrni kohën tuaj.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Dashuria është në qiellin e shtatë për ata që janë në një marrëdhënie. Nëse keni një histori dashurie klandestine, kushtojni vëmendje vështirësive të turpshme. Mbrëmje harmonike për çiftet e testuara mirë tashmë. Beqarët do të jenë të tërhequr për risitë dhe situatat e pazakonta, favorizohen takime me njerëz të rinj. Jini pozitiv dhe përbaltoni të ardhmen me qetësi.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Ujdes nga zilia e disa njerëzve të afërt. Komunikoni më shumë me partnerin/en tuaj për të rikthyer jetën e mirë si çift dhe për të rivendosur harmoninë. Beqarët sot duhet të jenë të kujdesshëm për të mos marrë vendime, mund të bien në situata të paqarta dhe s'do dinë si të veprojnë. Përpuni të bëheni më shumë praktik dhe mos të përqendrohni në projekte të paarrtshme.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Dashuria do të jetë e guximshme, aventureske dhe argëtuese. Do të jeni në harmoni të plotë me partnerin/en, edhe pse ndonjëherë do ndjeheni si të pakënaqur dhe do t'ju duhet të ankojeni. Beqarët do të kërkojnë aventura të reja, por do t'ju duhet të presin për të gjetur shpirtin binjak. Sot do të keni një mijë mundësi për të kërkuar më shumë për veten tuaj dhe për të kultivuar ide.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Jeni akoma në kohë nëse dëshironi të rikuperoni atë që është në zemrën tuaj, ju mund të krijoni strategji më të mira për t'u shfaqur përsëri intrigues në sytë e të dashurit/ës. Beqarët sot mund të organizojnë një takim me miqtë për të shkëputur veten nga rutina. Do të keni shumë kënaqësi dhe do të jeni gati për t'u përballur me një test të ri. Jini të vendosur dhe kujdesuni për çdo detaj.




UJORI 21. janar - 19. shkurt

Sot do të jetë një ditë e mbushur me surpriza të këndshme, marrëdhënia vazhdon me hapa të mëdhenj dhe do të ndjeheni të lumtur më në fund! Beqarët do të jenë në gjendje të mendojnë për fillimin e një historie të re me një person që kanë njohur kohët e fundit. Ofertat e punës nuk do të mungojnë dhe do të keni më shumë se një mundësi për të zgjedhur.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Tensionet dhe disponimi i keq mund të karakterizojnë jetën e një çifti. Jini pajtues nëse doni ta ruani marrëdhënien tuaj, nganjëherë një sqarim i papritur mund të ndryshojë gjithçka. Beqarët sot do të jenë tmerrsisht romantikë dhe do të jenë në gjendje të jetojnë përvoja shumë intensive. Mundësi të mira pune, por jini të kujdesshëm në vendimet që duhet të bëni.



AKTIVISTI I NJOHUR NË FOTO	M	DYLUFTIM	PERSONI NË FOTO ISHTE LIDER I 'LEVIZJES SËTË DREJTJAVE CIVILE ...'	VEGËL NDERTIMTARIE	
KËNGËTARI AMERIKAN, ANT					
POLITIKANI YNË, OSMANI					
JO MBARË (BISED.)					
FUTBOLLISTI KOSOVAR RASHICA					
M					
NORVEGJIA		FLORI			
		NUË METAL (U)			
RRJEDHË UJI (SHQ.)					
URINË				PRODUKTE NGA EMANACIONI	
GJËRAT QË PRANOHEN SI TË VERTETA, SIPAS ISLAMIT					
Mensur Mamuti	FOSFORI	DRU ME ERË TË MIRË (SHQ.)	NJERI PËRULËS, NËNSHTRUES	V	TOKË KOMUNALE (SH. PASHQ.)
			PJESËMARRJE NË FILM		
PËRGATITJE E PLANIT TË PARË, PARASKENËS					
KOHA	SHTET NË AMERIKËN LATINE	LËNDË E PARË PËR BUKE			
QË VUAN NGA MALARIA					PARAFJALË GJERMANE
					TITULL ÇIFLIGARËSH TURQ
99 ROMAK			AUTORJA SHQIPTARE, PAJA		
			DOMENI I FUNKSIONIT		
BAJRAM (ARAB.)				HIDROGJENI	NGACMON, NGUC
JO ALLATURKA				REOMIRI	AZOTI
A					ENERGJIA

ZGJIDHJET: M, ADAM, MILOT, NAR, LUMI, URE, V, ATARE, PARASKENIM, KOSTARIKA, MALARIAK, AN, IC, LEDIANA, EID, H, NGFT, ALLAFRANGA, E.

Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

		7	1	3		8				3		8
	5						1					
8	1				4		7	6	7		8	
1				2						1		3
6			7			5				6	5	
	2			6			4			9		6
7	3			2			6	4	1			
	8						2				5	9
		1		9	3	5				7		4

Shumë i lehtë: 467132859, 359876412, 812954376, 173428695, 694715238, 528369741, 735281964, 986547123, 241693587, Mesatar: 591472368, 684391527, 732856194, 257183649, 816549273, 349267851, 163924785, 428735916, 975618432.

Tualeti publik më i bukur në botë

Në Norvegji është hapur ai që mund të konsiderohet si tualeti publik më i bukur në botë. Ky tualet ndodhet në majë të një kodre në Ureddplassen, përgjatë rrugës piktoreske të Helgelandskysten. Tualeti luksoz pranë qytetit të Gildeskalit ka kushtuar rreth 1.5 milionë euro. Me një pamje nga deti, ky tualet me shumë mundësi do të bëhet një atraksion turistik.



Çifti i famshëm ndahet pas 9 vitesh martesë

Channing Tatum dhe Jenna Dewan kanë bërë të ditur se janë ndarë pas nëntë vitesh martesë. Çifti i 37-vjeçarëve, bën të ditur lajmin nëpërmjet një deklaratë të postuar në profilet e tyre në Instagram, teksa këmbëngulin se "mbeten dy miq të mirë" por pranuan se tani janë "në rrugë të ndryshme". Ata kanë një vajzë të quajtur Everly, e cila më 31 maj do të mbushë 5 vjeç, dhe thonë se "mbeten prindër të përkushtuar", pavarësisht ndarjes. Çifti i aktorëve ka dalë së bashku për herë të fundit në 6 nëntor të vitit të kaluar në premierën në Los Angeles për "War Dog". Channing u takua me Jenna në sheshin e xhirimit të filmit Step Up në 2006 e u martuan pas tre vjetësh në një ceremoni idilike në Malibu. Mesazhi i tyre në Instagram nis me fjalët: "Hej, botë! Pra... kemi diçka për të ndarë me ju".



Gjen vajzën e humbur pas 24 vitesh



Wang Mingqing i palodhur për ta kërkuar kishte nisur punë si taksist me shpresën se mund ta merrte si pasagjerë një ditë të bijën. Por ka qenë e bija që është vënë në kontakt me të, pas një postimi online që kishte bërë i ati. Historia e mrekullueshme ka ndodhur në Kinë, ku të dy u takuan të martën. Vajza e tij, Qifeng, u zhduk kur ishte vetëm tre vjeçe, sipas një interviste që ai ka dhënë për mediat në Kinë. Ai dhe shoqja ishin shitës frutash dhe një ditë teksa kishin mbaruar punën kuptuan se vajza nuk ishte me ta. Ata kaluan vite duke kërkuar për të në zonën përreth, lajmërimi në gazeta, njoftime nëpër shtylla dhe kërkime online. Çifti, të cilët kanë edhe një vajzë tjetër, nuk e lanë kurrë qytetin Chengdu, ku jetojnë, me shpresën se një ditë Qifeng do të kthehej. Në 2015, Wang vendosi të punonte si taksist, me shpresën se do e gjente. Çdo pasagjeri ai i jepte një letër me informacion të vajzës nëse ata kishin të dhëna për vogëlushen e tyre. Ai nuk ka pasur foto të të bijës kur ka qenë e vogël, kështu që përdorte foton e vajzës tjetër pasi ngjanin shumë. Metoda e tij unike mori vëmendjen e medias kineze. "Një ditë, vajza ime mund të



jetë personi që ulet në makinën time", ka thënë ai. Pas vitesh kërkimesh, një skicues e ndihmoi duke i bërë një portret se si mund të ishte Qifeng sot, dhe kjo e ndihmoi mjaft. Mijëra kilometra larg tij, një vajzë e pa skicën e bërë nga artisti dhe u shokua nga ngjashmëria që kishte. Ajo kontaktoi me Wang, të cilit i tha se kishte mjaft ngjashmëri me përshkrimin e vajzës së tij të humbur, përfshi një shenjë në ballë dhe që villte sa herë qante. Ata vendosën të bëjnë testin e ADN-së që doli pozitiv. Raportimet kineze thonë se Kang Ying, kështu quhej tani Qifeng, ishte rritur në një qytet rreth 20 km larg vendlindjes, por nuk dha detaje se si përfundoi e ndarë nga prindërit e saj.

1081 - Aleks i I Komneni okupon fronin bizantin.

1460 - Formohet Universiteti i Bazelit në Zvicër.

1716 - Trupat ruse dhe prusiane okupojnë Uajsmarin.

1818 - Kongresi amerikan vendos që flamuri i SHBA të ketë 13 vija kuq e bardhë dhe 20 yje.

1866 - Aleksandri i II i Rusisë në mënyrë të ngushtë i ik një tentimi për vrasje në qytetin e Kievit.

1912 - Republikë kineze shpallet në Tibet.

1926 - Diktatori grek Teodoros Pangallos zgjidhet president.

1944 - Trupat britanike okupojnë Adis Abeban në Etiopi.

1945 - Hungaria lirohet nga okupimi nazist (Dita kombëtare).

1960 - Senegali shpall pavarësinë nga Spanja.

1979 - Ekzekutohet kryetari i Pakistanit Zulfikar Ali Bhutto.

1992 - Sali Berisha bëhet kryetar/Aleksandër Meksi kryeministër i Shqipërisë



Ka ekzistuar një ngjyrë e përbërë nga mumiet egiptiane. 'Mummy Brown' ishte një nga preferencat e shumë piktorëve evropianë të shekullit të 19-të, por disa njerëz ishin aq të shqetësuar nga përbërësit e saj, sa që i varrosnin tubat e ngjyrave në tokë nga respekti për të vdekurit. Ajo ngjyrë u krijua deri në vitin 1964, kur furnizimi mumiet e lashta të prodhuesit më në fund mbaruan.

LEPURI PIANEC

- Shkon lepur i në kafe të arushës edhe bërtet: biiiiiaa një biiiiiaa! Arusha thotë: birrën po ta bi veç edhe njëherë me bo me bërtit t'gozhdoj me gozhda.

Te nesërmen mbrëma vjen lepur i prapë dhe e thirr arushën, eja këtu: A keni gozhda?

Arusha thotë: jo! Lepuri prapë bërtet biiiiiaa një biiiiiaa.

STACIONI I TRENIT.

Tre persona arrijnë tek stationi i trenit por treni sapo nis.

Vrapojnë dy të parët dhe arrijnë të hipin në ecje e sipër, ndërsa i treti nuk arin të hipë por fillon të qeshë me të madhe.

I thotë një kalimtar:

-Më falni por ju nuk duhet të qeshni se nuk arritët të hipni në tren ndërsa shokët po?!

-E si të mos qesh kur ai që duhet të hipet në tren jam unë, se ato të dy vetëm sa do të më përcillnin mua.



Orientohuni përmes yjeve dhe jo përmes dritave të çdo anije që kalon.

Omar N. Bradley



KALENDARI HISTORIK 4 PRILL



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS